RAPORTI PËRFUNDIMTAR
Mbi
Auditimin Financiar

Tiranë, tetor 2026

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	**PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE**	3-3
1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	3-3
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7-9
II.	**HYRJA**	9
1	Objektivat dhe qëllimi	8
2	Identifikimi i çështjes	8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4	Përgjegjësitë e audituesve	10
5	Kriteret e Vlerësimit	10-11
6	Standartet e auditimit	11
7	Metodat e auditimit	12
8	Dokumentimi i auditimit	13
III.	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	13
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	
2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	14
3.1	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	14-27
3.2	Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	27-32
3.3	Auditim mbi të ardhurat vendore	32-41
3.4	Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025	41-90
IV.	**REKOMANDIME**	90-103

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Bashkia Fushë Arrëz si njësi e vetëqeverisjes vendore organizohet dhe funksioni sipas kuadrit legjislativ dhe operues, ku bazën e të cilave janë ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligji nr.68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë. Bashkia Fushë Arrëz për periudhën e aktivitetit 01.01.2025-31.12.2025 , krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, *(pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi),* qëndron në forcimin e transparencës së veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, si dhe në rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Bashkia Fushë-Arrëz ndodhet në pjesën verilindore të Qarkut Shkodër dhe u krijua pas reformës administrativo-territoriale të vitit 2015. Ajo përbëhet nga pesë njësi administrative: Fushë-Arrëz, Blerim, Fierzë, Iballë dhe Qafë-Mali. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 540 km² dhe kufizohet me bashkitë Pukë, Kukës, Vau i Dejës dhe Mirditë. Qendra administrative është qyteti i Fushë-Arrëzit, i cili përbën qendrën kryesore të shërbimeve administrative, ekonomike dhe sociale të bashkisë. Relievi është kryesisht malor, me lartësi të konsiderueshme mbi nivelin e detit, ndërsa pyjet, kullotat dhe burimet ujore përbëjnë pasuri të rëndësishme natyrore.

Nga pikëpamja historiko-gjeografike, Fushë-Arrëzi është pjesë e krahinës tradicionale të Pukës dhe ka një histori të lidhur ngushtë me jetën malësore, blegtorinë dhe shfrytëzimin e pasurive pyjore e minerare. Zhvillimi më i madh ekonomik i zonës u shënua gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, me hapjen e minierave të bakrit në Qafë-Mali dhe Munellë, si dhe me ngritjen e industrisë së përpunimit të drurit. Pas viteve 1990, mbyllja e një pjese të industrisë minerare dhe emigracioni ndikuan në tkurrjen e popullsisë dhe në ngadalësimin e zhvillimit ekonomik. Megjithatë, zona ruan vlera të rëndësishme natyrore dhe turistike, falë peizazheve malore, pyjeve të dendura dhe traditave të pasura kulturore.

Ekonomia e Bashkisë Fushë-Arrëz mbështetet kryesisht në bujqësi, blegtori, shfrytëzimin e pyjeve, përpunimin e lëndës drusore dhe, në një masë më të kufizuar, në aktivitetin minerar. Kultivohen drithëra, patate dhe kultura foragjere, ndërsa blegtoria përbën një burim të rëndësishëm të ardhurash për familjet rurale. Pasuritë pyjore ofrojnë potencial për industrinë e drurit dhe për zhvillimin e turizmit natyror e malor. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe promovimi i burimeve natyrore konsiderohen faktorë të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të bashkisë në të ardhmen.

Sipas rezultateve përfundimtare të Censit 2023, Bashkia Fushë-Arrëz ka 4,878 banorë, duke qenë një nga bashkitë me popullsinë më të vogël në Shqipëri. Dendësia mesatare e popullsisë është rreth 9 banorë/km², çka pasqyron karakterin e saj kryesisht malor dhe rural. Bashkia vazhdon të përballet me rënie të popullsisë si pasojë e emigracionit dhe migrimit të brendshëm drejt zonave urbane. Sipas të dhënave zyrtare, shtesa natyrore e popullsisë është negative (-6 banorë), ndërsa migrimi i brendshëm neto rezultoi -146 banorë. Në territorin e bashkisë ushtrojnë aktivitet 83 ndërmarrje aktive, të përqendruara kryesisht në tregti, shërbime, përpunimin e drurit dhe aktivitete bujqësore.

Bashkia Fushë Arrëz ushtron funksionet e saj në fushat e shërbimeve publike vendore, menaxhimit financiar, planifikimit dhe zhvillimit të territorit, arsimit parashkollor, mbrojtjes sociale dhe administrimit të pasurive publike, në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*.

Buxheti i Bashkisë Fushë Arrëz për vitin 2025 është planifikuar në shumën 544,764 mijë lekë. Nga këto shpenzime faktike për vitin 2025 janë realizuar 428,191 mijë lekë ose në masën 79 % kundrejt planit vjetor të vitit 2025. Këto shpenzime kanë patur si burime mbulimi fondet e siguruara si vijon: 316,282,298 lekë nga të ardhurat e veta dhe 111,908,401 lekë nga buxheti i shtetit.

b. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimet e auditimit të tij:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2025-31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Fushë Arrëz. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme: Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.*
- *Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.*
-*Auditim mbi burimin e krijimit të të ardhurave.*
-*Auditim mbi pasqyrat financiare të vitit 2025.*

c. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar transaksionet e likuidimeve nëpërmjet bankës dhe ka testuar rregullshmërinë dhe saktësinë e posteve të bilancit.

d.Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar **17** gjetje dhe ka dhënë **20** rekomandime, nga të cilat *17 masa organizative dhe 3 masa për të ardhurat e munguara dhe shpenzimet pa efektivitet.*

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore*:*

Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me proceduat e mbajtjes së sistemit të kontabilitetit, mbledhjen e të ardhurave dhe sistemin e kontrollit të brendshëm. Kështu,

-Nga auditimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Fushë Arrëz për vitin 2025, ky sistem *vlerësohet pjesërisht efektiv* dhe se komponentët e menaxhimit financiar nuk kanë funksionuar në mënyrë të plotë.

- Bashkia Fushë-Arrëz nuk ishte hartuar dhe miratuar Planin e Përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit me afat 5-vjeçar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 32 të ligjit nr. 68/2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar dhe piken 3.4.1 "Sistemet e menaxhimit të informacionit", piken 2.3 "Linjat e Mbrojtjes së Fondeve Publike" dhe Kreun IV Aneksi 1, të Manualit të MFK.

- Kryetari i Bashkisë nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit të Riskut për vitin 2025, është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut por nuk rezultoi i protokolluar. Mungesa e protokollimit të Regjistrit të Riskut dhe të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut cenon gjurmën administrative dhe dokumentimin zyrtar të procesit të menaxhimit të riskut në institucion. Veprime në kundërshtim me pikat 2 dhe 3 të nenit 16, "*Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit",* të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",* i ndryshuar, dhe kërkesat e Nenit 11, pika 1/d dhe pika 3.b, si dhe neni 7, pika 1/c te UMF nr. 16, date 31.12.2024.

-Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz nuk ishte hartuar e miratuar Rregullore *"Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen, konfidencialitetin në Bashkinë Fushë-Arrëz*", në kundërshtim me ligjin nr. 60/2016 *"Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit",* në Nenin 8, pika 8, germa e të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, i ndryshuar si dhe përcaktimet e Kreut 3.3 "Aktivitetet e Kontrollit", pika 3.3.1 "Kërkesat, standardet ligjore për ndërtimin e Aktiviteteve të Kontrollit", të Manualit të MFK.

-Nga auditimi rezultoi se buxhetit vjetor fillestar i miratuar nga Këshilli Bashkiak për vitin 2025 është 481,263 mijë lekë. Totali i buxhetit të rishikuar i vitit 2025 është në vlerën 544,764 mijë lekë, kurse realizimi i buxhetit faktik 2025 prej 428,191 mijë lekë. U konstatua një rritje prej 63,501 mijë lekë ndërmjet planit fillestar dhe buxhetit të rishikuar. Sa më sipër, janë konstatuar devijime të konsiderueshme ndërmjet planifikimit fillestar dhe buxhetit përfundimtar, veçanërisht në zërat e investimeve. Niveli i realizmit të zërave buxhetor në fund të vitit 2025 është 88% kundrejt planit vjetor të miratuar dhe 79 % ndaj buxhetit të rishikuar. Niveli i mosrealizimit të buxhetit faktik ndaj planit fillestar dhe atij të rishikuar është përkatësisht -53,072 mijë lekë dhe -544,764 mijë lekë.

- Nga auditimi në Bashkinë Fushë Arrëz u konstatua se planifikimi i të ardhurave për vitin 2025 nuk është bazuar në kapacitetet reale të gjenerimit të të ardhurave, si dhe mungojnë dokumentet dhe analizat që argumentojnë metodologjinë dhe bazën e përllogaritjes së parashikimeve për secilën taksë dhe tarifë vendore.

- Për vitin 2024, planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 28,555 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 45,553 mijë lekë referuar Akt-Rakordimit me Degën e Thesarit ose në masën 159.5% me një mbirealizim ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 16,998 mije lekë.
- Për vitin 2025, planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 28,555 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 57,474 mijë lekë referuar Akt-Rakordimit me Degën e Thesarit ose në masën 201% me një mbirealizim ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 28,919 mije lekë.

Në këtë mënyrë, planifikimi i të ardhurave për vitin 2025 është bazuar në të njëjtën vlerë me atë të vitit 2024, pavarësisht se gjatë vitit 2024 realizimi i të ardhurave është me tejkalim kundrejt planit me 16,998 mijë lekë.

-Nga auditimi u konstatua se Sektori i Tatim-Taksave në Bashkinë Fushë-Arrëz *nuk administron regjistra fizikë për abonentët familjarë***,** si rrjedhojë nuk disponohet informacion i plotë dhe i dokumentuar mbi ngarkesat fiskale, pagesat e kryera dhe periudhat të cilave u përkasin këto pagesa. Gjithashtu, për këtë kategori abonentësh nuk janë caktuar agjentë tatimorë për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, duke ndikuar negativisht në administrimin, monitorimin dhe ndjekjen e detyrimeve fiskale.

Si rrjedhojë, në kushtet e mungesës së informacionit mbi ngarkesën për tarifat e miratuara në paketën fiskale të vitit 2025, për kategorinë e abonentëve familjarë, përllogaritja e detyrimeve progresiv totale për këtë kategori në fund të vitit 2025 bëhet e pamundur.

-Nga auditimi i llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* rezultoi se gjendja e saj u rrit nga 298,885,945 lekë në fillim të vitit në 302,275,408 lekë në fund të vitit 2025, me një rritje prej 3,389,463 lekë, ose 1.13%. Gjatë vitit ushtrimor 2025 janë regjistruar shtesa në shumën 5,283,711 lekë, ndërsa pakësimet (arkëtimet dhe sistemimet kontabël) kanë qenë 1,894,248 lekë, duke evidencuar një nivel shumë të ulët arkëtimi të të drejtave të konstatuara dhe bërë që gjendja e debitorëve në fund të vitit të mbetet në nivele të larta. Në datën 31.12.2025, debitorët paraqiten në vlerën 302,275,408 lekë, duke përbërë 59.96% të aktiveve afatshkurtra dhe 17.71% të totalit të

aktiveve të Bashkisë. Ky problem mbi nivelin e lartë të detyrimeve debitorë (të drejtat për arkëtim) është trajtuar edhe në raportet e mëparshëm të auditimit të KLSH-së, ku është rekomanduar për gjetjen e origjinës nga ka lindur detyrimi, arkëtimin e këtyre vlerave, deri në ngritjen e padive gjyqësore, por mungojnë veprimet korrigjuese për sa më sipër.
-Nga auditimi u konstatua se, sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 Bashkisë Fushë Arrëz i kanë kaluar 3,571 zëra të listës së inventarit të pronave "*Pyje dhe kullota*" që transferohen për Bashkinë Fushë Arrëz, të cilat nuk janë inventarizuar dhe kontabilizuar në librat e kontabilitetit të kësaj Bashkie. Si rrjedhojë, kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara me VKM nr. 433, dt. 08.06.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive*", pika 3, shtojca me nr.1, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Fushë Arëz
-Nga auditimi i llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezultoi së nuk janë transferuar për llogari të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime (SHRUK) Shkodër nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz, mbi 10 zëra aktivesh, që i përkasin SHRUK Qarku Shkodër sha me koston historike prej 129,509,818 lekë me datë 31.12.2025, që janë pjesë e llogarisë 213, në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022, etj.
- *Në total,* borxhit tatimor progresiv më datë 31.12.2025, për kategorinë biznes i vogël, biznesi i madh dhe institucionet shtetërore, rezultuar në shumën prej **30,041,125 lekë.**

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore*:*
-Kryetari i Bashkisë dhe këshilli bashkiak Fushë Arrëz, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për forcimin e sistemit të planifikimit strategjik, menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke:

- ✓ hartuar, konsultuar dhe paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak Planin Strategjik të Zhvillimit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore me afat 5-vjeçar, në funksion të planifikimit të qëndrueshëm të zhvillimit vendor, përcaktimit të prioriteteve dhe harmonizimit të tyre me Programin Buxhetor Afatmesëm;
- ✓ hartuar, miratuar dhe zbatuar një kuadër të plotë rregullash, procedurash dhe akteve të brendshme për funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në përputhje me komponentët e MFK-së, si dhe duke monitoruar në mënyrë periodike nivelin e zbatimit të tyre për adresimin e mangësive të konstatuara;
- ✓ hartuar dhe zbatuar procedura të brendshme për administrimin dhe sigurinë e sistemeve të teknologjisë së informacionit (IT), administrimin dhe ruajtjen e të dhënave të aktiveve, si dhe duke siguruar ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të rregullt të kopjeve rezervë (back-up).

-Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatime-Taksave, të marrë masa që në hartimin e planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.
-Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave, si dhe me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës me qëllim evidentimin dhe identifikimin e plotë të abonentëve familjarë subjekt i detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore. Gjithashtu, të krijojë dhe të administrojë një regjistër të plotë e të përditësuar të kësaj kategorie abonentësh, i cili të shërbejë si bazë për përcaktimin e saktë të

detyrimeve fiskale dhe për hartimin e parashikimeve realiste të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.
-Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave të marrë masa për pasqyrimin e plotë, të saktë dhe të dokumentuar të detyrimeve debitore në kontabilitet, përmes evidentimin analitik të çdo debitori të mbartur, sistemimin e diferencave të konstatuara prej **5,250,000 lekë,** si dhe zbatimin korrekt të skemës kontabël për llogaritë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" dhe 470 "*Llogari në pritje – të ardhura për t'u marrë",* në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2025 në vlerën progresive **30,041,125 lekë,** ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinion mbi auditimin financiar[1]: *i kualifikuar*

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Fushë Arrëz për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të fluksit të mjeteve monetare *(cash floë),* të ndryshimit të aktiveve neto/flukseve neto dhe shënimet shpjeguese.
Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

Në opinionin tonë, bazuar në *dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit* që kemi marrë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin "Baza për Opinion", pasqyrat financiare të Bashkisë Fushë Arrëz paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni ***të kualifikuar***[2], e shprehur kjo sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm.

Baza për opinionin:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*", pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI- P1,

1 - Mbështetur në ligjin nr. 154/2014 "Për organizmin dhe funksionimin e KLSH-së".

2 - Sipas Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së miratuar me Vendimin nr. 246, datë 19.12.2022 të Kryetarit te KLSH-së, Kapitulli VII, pika 4.2, (fq 54, 60-61): "*Opinioni i modifikuar" do të jepet në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë".*

"Deklarata e Limës", INTOSAI -P10 "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 130 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit të llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së që për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 për Bashkinë Fushë Arrëz është 7,171,801 lekë për shpenzimet dhe 8,711,288 lekë për të ardhurat si dhe mangësitë/ anomalitë e mëposhtme:

- *Pasaktësi në njohjen dhe vlerësimin e aktiveve*: Moskontabilizim i aktiveve të transferuara me VKM dhe mbivlerësim i aktiveve në llog.213 në vlerën 129,509,818 lekë , por që i përkasin Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime (SHRUK) Shkodër sha, si dhe kontabilizuar në llogarinë 212 dy zëra shpenzimesh për investime në shumën prej 6,341,850 lekë, për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, në mbivlerësim të aktiveve në llogarinë "Ndërtesa e riskonstruksione".
- *Mospërputhje në inventarët e aktiveve:* Llogaria 231 "*Shpenzime për investimet e AAGJM"* në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) dhe Regjistrit të Aktiveve në fund të v.2025 rezultoi një moskuardim prej 4,451,590 lekë,. Regjistri i Aktiveve për vitin 2025 nuk përfshin të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale, aktiveve afatgjata jomateriale, pjesëmarrjet në kapital dhe aktivet afatshkurtra.
- *Mangësi në inventarizimin e aktiveve:* Nga auditimi i procedurave të ndjekura për inventarizimin e pasurisë për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve si dhe përdorimin në mënyrën e duhur e më eficiencë të tyre, u konstatuan mangësi në lidhje me zbatimin e proceseve dhe procedurave të inventarizimit të pasurisë, rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm. Nuk disponohen të dhëna mbi kryerjen e inventarizimit fizik për Aktivet Afatgjata Materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214,
- *Pasaktësi në të drejtat dhe detyrimet:* Evidentohet një nivel i lartë i llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", gjendja e së cilës është rritur nga 298,885,945 lekë në fillim të vitit, në 302,275,408 lekë në fund të vitit 2025, me një rritje prej 3,389,463 lekë, ose 1.13% me një nivel të ulët të arkëtimit të të drejtave të konstatuara, duke sjellë si pasojë nivele të larta të gjendjes së debitorëve në fund të vitit. Në datën 31.12.2025, debitorët përbëjnë 59.96% të aktiveve afatshkurtra dhe 17.71% të totalit të aktiveve të Bashkisë.
-Nuk është bërë çlirimi i garancive për 34 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga në vlerën 7,093,884 lekë (regjistruar në llogarisë 466 "*Kreditorë për mjetet në ruajtje"*), për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Pukë.
- *Mospërputhje në pasqyrat financiare dhe llogaritë kontabël:* Llogaria 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"*, më datë 31.12.2025, nuk kuadron me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit", me një diferencë prej 28,001,087 lekë, duke evidentuar mangësi në regjistrimin dhe ndjekjen e të drejtave me bazë rritëse. Gjithashtu, llogaria 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"* paraqitet me një gjendje prej 298,885,945 lekë në fund të vitit 2024 dhe 302,275,408 lekë në fund të vitit 2025, e cila nuk kuadron me shumën e llogarive 411, 423–429 dhe 468,

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH"*, në zbatim të programit të auditimit nr.733/1 prot., datë 30.06.2026 *"Mbi auditimin Financiar", në Bashkinë Fushë Arrëz"*, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 30.06.2026 – 27.07.2026, në subjektin Bashkia Fushë Arrëz u krye "*Auditim Financiar*" për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2025 - 31.12.2025, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Q.C, *përgjegjës grupi*
2. A.V, *auditues*
3. N.B, *auditues*

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Fushë Arrëz është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

2. Qëllimi i auditimit.

Është dhënia e opinionit dhe hartimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale ose jo dhe në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale **(ISSAI 1315)**[3]**.**

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim opinionin tonë mbi pasqyrat financiare, të shpenzimeve dhe menaxhimit të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

3. Identifikimi i çështjes:

Ky Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Fushë Arrëz si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiare në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Fushë Arrëz janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz

[3]-Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

(Administratori i Përgjithshëm), z.H.C në cilësinë e *Nëpunësit Autorizues* (NA) dhe Drejtori i Financës dhe Buxhetit z.D.L në cilësisë e *Nëpunësit Zbatues* (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Fushë Arrëz , bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3. *Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret ligjore duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kuadrin rregullues mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiar* të llogaridhënies vjetore; ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të të ardhurave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Kuadrin e Praktikave Profesionale dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

d) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

e) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, etj.)

f) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në Bashkinë Fushë Arrëz, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

6. Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

-Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "*Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*".

- Ligji nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore";*
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar*;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;*
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar*;*
- Ligji nr. 152-2013, "*Për nëpunësin civil",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar*;*
- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 *"Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 *"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendor"*
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*;
-VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime*;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore",* i ndryshuar;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar*;*
- Udhëzimin nr.15, datë 30.06.2003 "*Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike"*
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar,
-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.127, datë 19.12.2025 "*Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025"*,
-UMF nr. 2, datë 27.09.2019 "*Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore*".
-Udhëzimi nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", i ndryshuar;
-Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2021 "*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*";
-Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar;
-Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
-Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut, etj.

7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

- INTOSAI P1- Deklarata e Limës me udhëzuesit për kryerjen e auditimit.
- ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*" .
- ISSAI 1300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*";
- ISSAI 200 "*Parimet e auditimit financiar*" dhe
- ISSAI 2000-2200 "Aplikimi i standardeve te auditimit financiar"
- ISSAI 1000-2999 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*";
- INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilisteve IFAC;

- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*".
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Rregullore e brendshme *"Mbi procedurat e auditimit në KLSH"*;
- Rregullore e brendshme "*Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së"*;

7. Metodat e auditimit*:*

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me evidence dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Sa më sipër, audituesit kanë aplikuar auditim *i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje, mbi bazën e riskut të vlerësuar.* Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, janë marrë në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe - Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Nga ana e grupit të auditimit janë kryer vlerësimet mbi procedurat, mbi këto aspekte si më poshtë: *Kontrolli aritmetik*. *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. *Kontrolli i vlerësimit*. *Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi*. Intervista *Raporte dhe Informacione, të trajtuara në aktin e konstatimit mbi auditimin e PFV.*

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

- <u>Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit</u>

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja. Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, me ndryshimet. Gjithashtu, është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", duka administruar dokumentacion të mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit si dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve.
Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

- Sipas shkresës së KLSH-së me nr.733/3 prot., datë 07.08.2026, në subjektin e auditimit Bashkia Fushë Arrëz është dërguar Projekt Raporti i auditimit.
- Bashkia Fushë Arrëz ka përcjellë pranë KLSH-së komente, shpjegime apo observacione *(në formë shkresore)* mbi Projekt-Raportin e Auditimit brenda afatit 1-mujor nga data e marrjes në dorëzim nga personat përgjegjës, me shkresën nr.2614 datë 07.08.2026 (protokolluar në KLSH **me nr. 733/5 datë 13.08.2026**) *në lidhje me pasqyrat financiare* dhe shkresën nr.2647 datë 11.08.2026 (protokolluar në KLSH me **nr. 733/4 datë 13.08.2026**) *në* lidhje me administrimin e taksave dhe tatimeve vendore. Sa më sipër, janë analizuar dhe trajtuar objeksionet që kanë vlerë ligjore në kuadër të hartimit të këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Auditimi Financiar në subjektin "Bashkia Fushë Arrëz", u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t'u audituar. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave. Bashkia Fushë Arrëz është e organizuar dhe funksionon në bazë Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*".

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik 2025.

✓ ***Mbi funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.***

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit te auditimit *(pyetësorët e vetëvlerësimit te MFK, deklarata e cilësisë se SKB, rregulloret dhe dokumentacioni sipas drejtimeve të programit të auditimit etj.),* përveç punës së bërë kane rezultuar mangësi e parregullsi në lidhje me realizimin e komponentëve të MFK-së në Bashkinë Fushë-Arrëz, me hollësisht trajtuar në vijim:

I. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit":

Në lidhje me zbatimin e parimit nr. 1 "Angazhimin për integritet dhe vlerat etike".

-Bashkia Fushë-Arrëz funksionon mbi bazën e Rregullores së Brendshme të Bashkisë Fushë-Arrëz, miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 11, datë 08.04.2025, *"Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës, njësive administrative dhe institucioneve në varësi të Bashkisë Fushë-Arrëz".* Referuar Kreut IV, Aneksi 8, dhe paragrafi 2.3 "Linjat e Mbrojtjes së Fondeve Publike" të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 4, datë 26.01.2024, u konstatua se në rregullore janë reflektuar modelet dhe parimet e përcaktuara në manualin përkatës. Sa më sipër, kanë gjetur zbatim përcaktimet e kërkesave të nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz ka miratuar Kodin e Etikës dhe të Parandalimit të Konfliktit të Interesit me Urdhrin nr. 77, datë 08.04.2025,*"Për miratimin e Kodit të Etikës dhe Konfliktit të Interesit për nëpunësit/ punonjësit e Bashkisë Fushë-Arrëz".*

-Grupit të auditimit ka kryer testime me zgjedhje mbi procesin e vlerësimit te arritjeve dhe rezultateve në punë të punonjësve të bashkisë (u shqyrtuan 6 (gjashtë) dosje dhe praktika vlerësimi periodik dhe rezultoi se.

-Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve të Bashkisë Fushë-Arrëz rezultoi se për vitin 2025 vlerësimi i rezultateve në punë **nuk ishte kryer** në periudha 6-mujore, përkatësisht për periudhat janar–qershor 2025 dhe korrik–dhjetor 2025, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezultoi se janë kryer vetëm vlerësimet vjetore të punës dhe jo vlerësimet periodike 6-mujore. Për pasojë, vlerësimet nuk janë realizuar në përputhje me afatet ligjore dhe procedurat e përcaktuara.-Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, "*Për vlerësimin e rezultateve në punë*", si dhe ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "*Kodi i Punës*", i ndryshuar.

Në lidhje me parimin 2 "Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje".

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e Nëpunësit Autorizues (NA) dhe të stafit menaxherial, janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë dhe zbatohen në përputhje me parashikimet e saj.

-Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për vitin 2025 drejtoritë dhe sektorët kanë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës. Megjithatë, **nuk** rezultoi të jenë hartuar raporte vjetore të analizës së veprimtarisë, të cilat duhet t'i paraqiten Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak mbi realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit, Kreu III, pika 3.1, aspekti "Profesionalizmi i stafit" të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e MF nr. 4, datë 26.01.2024.

-Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim - Taksave janë hartuar raporte periodike monitorimi për zbatimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA). Gjithashtu, janë administruar procesverbale të mbledhjeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), në të cilat janë trajtuar çështje që lidhen me performancën dhe nivelin e realizimit të shërbimeve.
-Titullari i institucionit merr opinione mbi performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, nëpërmjet veprimtarisë audituese të saj.
-Këshilli Bashkiak, në ushtrimin e kompetencave të tij, nëpërmjet procesit të vendimmarrjes, ushtron funksionet e mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi veprimtarinë e Bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 "Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë"

- Për vitin 2025, Bashkia Fushë-Arrëz ka funksionuar mbi bazën e strukturës organizative dhe organikës së miratuar me Urdhrin nr. 724, me nr. 4598 prot., datë 13.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, "*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz, njësive administrative dhe institucioneve buxhetore në varësi të Bashkisë* Fushë-Arrëz për vitin 2025", si dhe në bazë të Rregullores së Brendshme të vitit 2025, *"Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës, njësive administrative dhe institucioneve në varësi të Bashkisë Fushë-Arrëz".*

Sipas strukturës së miratuar, Bashkia Fushë-Arrëz ka gjithsej 320 pozicione pune, të përbëra nga kategoritë: nëpunës civilë, punonjës të marrëdhënieve të punës të rregulluara sipas Kodit të Punës, si dhe pozicione vakante.

Pozicionet e shërbimit civil janë të organizuara si më poshtë:

-Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese: 6 pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit "Drejtor Drejtorie";

-Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese: 17 pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit "Përgjegjës Sektori";

-Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive: 20 pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve "Specialist", "Inspektor", "Inxhinier" dhe "Arkitekt".

- Për vitin 2025, me shkresën nr. 34 prot., datë 07.01.2025, "*Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil për vitin 2025 në institucionet e Bashkisë Fushë-Arrëz",* është miratuar plani vjetor i pranimeve, në bazë të të cilit janë parashikuar të zhvillohen procedura konkurrimi për plotësimin e 10 pozicioneve të lira. Këto pozicione janë ndarë sipas kategorive si më poshtë: 2 pozicione pune për nëpunës të kategorisë së ulët drejtuese, 3 pozicione pune për nëpunës të kategorisë së mesme drejtuese dhe 5 pozicione pune për nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive.

Në zbatim të planit vjetor të pranimeve për vitin 2025, Drejtoria Juridike, e Prokurimeve Publike dhe e Burimeve Njerëzore ka shpallur procedurat konkurruese për plotësimin e këtyre pozicioneve të lira: 1 Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore; 1 Drejtor në Drejtorinë e Urbanistikës dhe Kontrollit të Territorit; 1 Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave; 1 Përgjegjës Sektori në Sektorin e Çështjeve Sociale; 1 Përgjegjës Sektori në Sektorin e Diasporës, Migracionit, Integrimit Evropian dhe Çështjeve Sociale; 1 Specialist i Turizmit; 1 Specialist i Kontabilitetit; 1 Specialist për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Çështjet Sociale; 1 Specialist i Burimeve Njerëzore; 1 Specialist i Tatim-Taksave.

Për vitin ushtrimor 2025 janë rekrutuar 30 punonjës (5 nëpunës civilë dhe 25 me kod pune) dhe 24 punonjës janë larguar (11 për shkak pensioni, 1 për shkak ristrukturimi, 1 KMCAP, 1 largim për mosparaqitje në punë dhe 10 me dorëheqje).

-Nga auditimi i 10 dosjeve të punonjësve u konstatua se dosjet nuk përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në kundërshtim me Lidhjen 1 "Të *dhënat dhe dokumentacioni i dosjes së personelit"* të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", ku në asnjë rast nuk rezultoi të jenë: a) Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar sipas lidhjes nr. 2; b) Fleta e inventarit të dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes, sipas lidhjes nr. 2; c) Libreza e punës.

***Në lidhje me parimin 4** "Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave".*

-Drejtoria Juridike, e Prokurimeve Publike dhe e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Fushë-Arrëz ka hartuar planin e trajnimeve për personelin e institucionit për vitin 2025.

-Për Bashkinë Fushë-Arrëz, funksionin e Nëpunësit Autorizues e ushtron Kryetari i Bashkisë, z. H.C. Për vitin 2025, funksionin e Nëpunësit Zbatues e ka ushtruar Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave, z. D.L.

-Me Urdhrin e Brendshëm nr. 205 prot., datë 14.12.2016, është parashikuar funksioni i Koordinatorit të Riskut, por në urdhër nuk është përcaktuar punonjësi që do të ushtrojë këtë funksion. Gjithashtu, gjatë periudhës objekt auditimi **nuk** u vu në dispozicion dokumentacion që të evidentojë ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të Koordinatorit të Riskut.

Në lidhje me parimin 5 - Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

-Nga auditimi i kryer rezultoi se në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Fushë-Arrëz nuk janë përcaktuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë dhe përgjegjshmëria menaxheriale, sipas kërkesave të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Gjithashtu, u konstatua se njësia publike ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë, ndërsa gjatë periudhës objekt auditimi nuk u konstatuan autorizime për delegimin e detyrave.

Për periudhën objekt auditimi, referuar Urdhrit nr. 15, me nr. 70 prot., datë 09.01.2024, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) vetëm për aspektet që lidhen me hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027". Sa më sipër nuk ka gjetur zbatim Kapitulli II, pika 2.4.2 e MMFK që ka përcaktuar se: GMS luan një rol kyç përsa i takon *integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike*. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. Sipas këtij urdhri, GMS përbëhet nga Kryetari i Bashkisë (kryetar), Zëvendëskryetari (koordinator), Drejtori i Shërbimeve, Përgjegjësi i Financës, Përgjegjësi i Urbanistikës, Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore, Përgjegjësi i Shërbimeve Publike, Përgjegjësi i Auditimit të Brendshëm, Sekretari i Këshillit Bashkiak, Drejtori i Migracionit dhe Integrimit, administratorët e njësive administrative, Përgjegjësi për Arsimin dhe Shëndetësinë, Drejtori i Shërbimeve Pyjore, Përgjegjësi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Përgjegjësi i Rrugëve Rurale. U konstatua se roli i NJAB si anëtar i *GMS pa të drejtë vote*, nuk është përcaktuar, në kundërshtim me parashikimet e paragrafit 2.3.3 "Auditimi i Brendshëm" i MMFK, 2024.

-Krijimi i ekipit të menaxhimit të programeve (EMP). Për vitin 2025, Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz ka ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programeve (EMP), në përputhje me pikën 29, të Udhëzimit të MF nr. 23, datë 30.07.2018, "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"*, sipas të cilit Grupi i Menaxhimit Strategjik ngrihet me vendim të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe kryetari i GMS-së, me propozim të anëtarëve të tij, miraton anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programeve. Krijimi i këtij ekipi mbështetet gjithashtu në pikat 2.5 dhe 2.6 të Udhëzimit të MF nr. 7, datë 28.02.2018, *"Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm".*

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Fushë-Arrëz ka hartuar dhe miratuar Regjistrin e Riskut për vitin 2025, por dokumenti nuk është protokolluar.

-Gjithashtu, rezultoi se është hartuar dhe miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut, por ky dokument nuk është protokolluar dhe shpërndarë për njësitë administrative dhe drejtoritë e bashkisë për njohje dhe zbatim. Mungesa e protokollimit të Regjistrit të Riskut dhe të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut cenon gjurmën administrative dhe dokumentimin zyrtar të procesit të menaxhimit të riskut në institucion.

-Sa më sipër, në mosrespektim të kërkesave të nenit 11, pika 2, nenit 21, si dhe nenit 8, pika 8, shkronja "a", të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",* të ndryshuar, si dhe të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 16, datë 31.12.2024, "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike"*, Kreu IV, neni 11.

Në lidhje me parimin 7: "Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave".

-Për vitin 2025, Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz ka ngritur Grupin e Menaxhimit të Riskut, në përputhje me pikën 2.4.4 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, sipas së cilës "*Grupi i Menaxhimit të Riskut të njësisë miratohet nga Titullari si një organ i rëndësishëm monitorimi dhe koordinimi ndërmjet linjës së parë dhe të dytë të mbrojtjes".* Megjithatë, akti përkatës **nuk** rezultoi i protokolluar, duke cenuar gjurmueshmërinë administrative të dokumentacionit.

-Në Bashkinë Fushë-Arrëz, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave e realizon mbajtjen e kontabilitetit në programin *Microsoft Excel* dhe jo në një program të dedikuar kontabiliteti. Si pasojë, procesi i regjistrimit, përpunimit dhe raportimit të të dhënave financiare mbart një nivel më të lartë risku për gabime, pasaktësi ose humbje të të dhënave, krahasuar me përdorimin e sistemeve të specializuara të kontabilitetit.

-Nga auditimi rezultoi se Bashkia Fushë-Arrëz ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit, por dokumenti **nuk** është protokolluar dhe nuk është shpërndarë për njohje dhe zbatim tek Drejtoritë e Bashkisë dhe NJA-të e saj. Mungesa e protokollimit cenon administrimin dhe gjurmueshmërinë zyrtare të këtij dokumenti. Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 16, "*Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit",* të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",* i ndryshuar, dhe kërkesat e Nenit 11, pika 1/d dhe pika 3.b, si dhe neni 7, pika 1/c te UMF nr. 16, date 31.12.2024 të cilit titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për veprimtaritë kryesore të njësisë dhe sigurojnë dokumentimin e operacioneve në mënyrë të tillë që audituesit e brendshëm, audituesit e jashtëm dhe autoritetet mbikëqyrëse të mund të kuptojnë dhe verifikojnë mjedisin e kontrollit dhe proceset e kryera. Gjurma e auditimit duhet të ruhet dhe arkivohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me parimin 8: "Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime".

-Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz **nuk ishte hartuar** e miratuar Rregullore *"Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen, konfidencialitetin në Bashkinë Fushë-Arrëz*", në kundërshtim me ligjin nr. 60/2016 *"Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit",* në Nenin 8, pika 8, germa e të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, i ndryshuar si dhe përcaktimet e Kreut 3.3 "Aktivitetet e Kontrollit", pika 3.3.1 "Kërkesat, standardet ligjore për ndërtimin e Aktiviteteve të Kontrollit", të MMFK .

Në lidhje me parimin 9: "Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm".

-Bashkia Fushë-Arrëz, në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave të veprimtarisë së saj, ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm që rrjedhin nga ristrukturimi ose riorganizimi institucional. Në këtë kuadër, me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 724, me nr. 4598 prot., datë 13.12.2024, është miratuar struktura organizative e Bashkisë Fushë-Arrëz, e njësive administrative dhe e institucioneve buxhetore në varësi të saj për vitin 2025.

-Nga auditimi u konstatua se Bashkia Fushë-Arrëz ka rishikuar dhe përditësuar Rregulloren e Brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore, duke miratuar një rregullore të re për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës. Në këtë rregullore janë përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm, struktura organizative, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave organizative, procedurat e rekrutimit, trajnimet, masat disiplinore, orari dhe koha e punës, si dhe procedurat e vlerësimit të performancës së punonjësve, në përputhje me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Kreu III, pika 3.3.

-U konstatua se Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Burimeve Njerëzore nuk administron të dhënat e personelit nëpërmjet sistemit HRMIS, por në mënyrë manuale, duke përdorur programet *Microsoft Excel dhe Microsoft Word*. Si pasojë, procesi i administrimit, përditësimit dhe raportimit të të dhënave të personelit mbart një nivel më të lartë risku për gabime, pasaktësi ose mospërditësim të informacionit.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se titullari i bashkisë ka miratuar planet vjetore të punës në nivel drejtorie. Megjithatë, gjatë auditimit u konstatua se Bashkia Fushë-Arrëz **nuk ishte hartuar** dhe miratuar Planin e Përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit me afat 5-vjeçar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 32 të ligjit nr. 68/2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore"* dhe piken 3.4.1 "Sistemet e menaxhimit të informacionit", piken 2.3 "Linjat e Mbrojtjes së Fondeve Publike" dhe Kreun IV Aneksi 1, te MMFK.

III.Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

Në lidhje me parimin 10: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli".

-Bashkia Fushë-Arrëz disponon regjistër prokurimesh për vitin 2025. Ky regjistër është elektronik dhe përditësohet sipas ndryshimeve që ndodhin gjatë vitit.

-Bashkia Fushë-Arrëz ka rregullore të miratuar me VKB nr.11, datë 08.04.2025, *"Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës, njësive administrative dhe institucioneve në varësi të Bashkisë Fushë-Arrëz"* në zbatim të arkivave për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, ku Bashkia Fushë-Arrëz disponon një regjistër për aktivet e njësisë, por nuk konsolidon edhe AAGJJM dhe pjesëmarrjet në kapital.

- Nga auditimi rezultoi se Bashkia Fushë-Arrëz ka ngritur vetëm Komisionin e Inventarizimit me Urdhrin nr. 169, datë 08.04.2025, "*Për krijimin e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale*", por, nuk rezultoi të jenë vijuar procedurat e vlerësimit dhe të nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve, nëpërmjet ngritjes së komisioneve përkatëse, sipas kërkesave ligjore në fuqi. Gjithashtu, nuk rezultoi të jetë miratuar zgjatja e afatit të inventarizimit, pavarësisht mosfinalizimit të të gjitha fazave të procesit, duke sjellë mangësi në administrimin dhe pasqyrimin e plotë të aktiveve të institucionit.

-Bashkia Fushë-Arrëz në bashkëpunim me Degën e Thesarit Pukë, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, si dhe verifikimin e angazhimeve financiare në përputhje me fondet e

miratuara dhe kufijtë buxhetorë të përcaktuar, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Në lidhje me parimin 11: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë".

-Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë *(back-up).* Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT. Nuk ka procedura të veçanta të shkruara, mbi sistemet IT, të cilat përdoren në Bashkinë Fushë-Arrëz, të cilat i janë bërë me dije stafit. Aktualisht nuk ka një manual të shkruar për sigurinë e IT, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3.1. *"Mjedisi i kontrollit",* pikën 3.2.1 "Vendosja e objektivave", (çështja:" Rregullat që lidhen me të drejtën e hyrjes (aksesin) tek aktivet dhe informacionit), dhe Parimi 11 -Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrolli mbi teknologjinë e informacionit", të Manualit të MFK-së, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 26.01.2024 e Ministrit te Financave

Në lidhje me parimin 12: "Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave".

-Bazuar në rregullores së brendshme, çdo menaxher kryen detyrat, që janë të ndara për çdo fazë. Procedurat e brendshme janë të bazuara në kriteret rregullatorë në fuqi për funksionimin e MFK-së dhe AB. Për çdo rast që del e nevojshme, hartohet një plan veprimi operativ për menaxhimin e risqeve të dala gjatë vitit ushtrimor. Njësia e Auditimit të Brendshëm vepron e pavarur nga menaxhimi duke kryer aktivitetin në mënyrë të planifikuar. Të gjitha auditimet janë të planifikuara në bazë risku.

IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi"

Në lidhje me parimin 13: "Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor".

-Bashkia Fushë-Arrëz ka faqen e saj zyrtare në Web me adresë https: www.bashkiafushëarrëz. gov.al/ dhe përdor sistemin informatik SIFQ. Nga auditimi i kryer u konstatua se faqja zyrtare nuk është përditësuar në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme. Konkretisht, u evidentuan mungesa të informacionit dhe dokumentacionit në rubrika të caktuara, përfshirë publikimin e konsultimeve me publikun, akteve të bazës ligjore dhe informacioneve të tjera me interes për qytetarët, duke kufizuar transparencën dhe aksesin e publikut në informacion.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor.

-Drejtuesit e drejtorive të Bashkisë si dhe drejtuesit e NJA-ve kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Ky konstatim vjen edhe si rrjedhojë e mungesës së trajnimeve të brendshme për punonjësit e niveleve të ndryshme të këtij institucioni.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

-Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejt me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email. Bashkia Fushë-Arrëz kryen konsultime me publikun sipas programit të PBA. Mbahen protokolle sipas njësive të Bashkisë.

V. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi"

Në lidhje me parimin 16: "Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme".

-Nga auditimi rezultoi se Bashkia Fushë-Arrëz ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit për procedurat e brendshme periodike të raportimit, që lidhen me zbatimin dhe monitorimin e objektivave të institucionit. Megjithatë, dokumenti nuk rezultoi i protokolluar. Gjurma e auditimit është hartuar në përputhje me modelet standarde të përcaktuara në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

-Bashkia Fushë-Arrëz, në lidhje me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar pranë Ministrisë së Financave për vlerësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2025, me shkresën nr. 363 prot., datë 09.02.2026. Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm përmban një analizë të problematikave të evidentuara në pesë komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, duke përcaktuar masat e parashikuara për përmirësim dhe strukturat përgjegjëse për adresimin e tyre.

-Kryetari i Bashkisë ka miratuar planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Auditimi i Brendshëm dhe auditimet e jashtme. Planet e veprimit janë hartuar në përputhje me afatet e përcaktuara pas pranimit të rekomandimeve dhe përmbajnë masat konkrete, afatet e realizimit dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Në lidhje me parimin 17:"Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë". "Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë".

-Në rastet e konstatimit të parregullsive dhe mangësive në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP), nga auditimet e brendshme dhe të jashtme, si dhe në rastet e dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e situatës apo marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës, Kryetari i Bashkisë, ka miratuar me shkresën nr 3061 datë 01.10.2025, planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve te KLSH-së si dhe adresimin e problematikave të evidentuara.

-Ecuria e zbatimit të masave korrigjuese monitorohet nga Titullari i Bashkisë, i cili informohet periodikisht dhe në mënyrë vjetore nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi progresin e zbatimit të rekomandimeve. Për këtë qëllim, është hartuar raporti i Auditimit të Brendshëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me nr. 361 prot., datë 09.02.2026. Gjithashtu, strukturat menaxhuese përgjegjëse kanë hartuar planet përkatëse të veprimit dhe raportojnë me shkrim pranë Kryetarit të Bashkisë mbi masat e ndërmarra.

Sa më sipër, arrihet në konkluzionin se: Bashkia Fushë-Arrëz ka një ***sistem të vlerësuar pjesërisht efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm***, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Përfundim: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Fushë-Arrëz **nuk ishte hartuar** dhe miratuar Planin e Përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit me afat 5-vjeçar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 32 të ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se është hartuar dhe miratuar regjistri i riskut për vitin 2025 por **nuk** rezultoi i protokolluar, duke cenuar gjurmueshmërinë administrative të dokumentacionit.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Kryetari i Bashkisë nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit të Riskut për vitin 2025, është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut por nuk rezultoi i protokolluar. Mungesa e protokollimit të Regjistrit të Riskut dhe të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut cenon gjurmën administrative dhe dokumentimin zyrtar të procesit të menaxhimit të riskut në institucion.

-Nga auditimi rezultoi se Bashkia Fushë-Arrëz ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit, por dokumenti **nuk** është protokolluar. Mungesa e protokollimit cenon administrimin dhe gjurmueshmërinë zyrtare të këtij dokumenti.
-Në Bashkinë Fushë-Arrëz Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Financës dhe Tatim-Taksave për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes së të dhënave, niveli i riskut të gabimeve është i lartë.
-Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistemin HRMIS, por me hedhje manuale në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel ose Word.
-Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up). Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT. Nuk ka procedura të veçanta të shkruara, mbi sistemet IT, të cilat përdoren në Bashkinë Fushë-Arrëz, të cilat i janë bërë me dije stafit. Aktualisht nuk ka një manual të shkruar për sigurinë e IT.
-Nga auditimi i dosjeve të personelit rezultoi se për vitin 2025 nuk janë kryer në afat vlerësimet periodike 6-mujore të punonjësve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil. Gjithashtu, dosjet e personelit paraqesin mangësi dokumentacioni, pasi mungojnë dokumente të detyrueshme si fleta prezantuese, fleta e inventarit të dosjes dhe libreza e punës, në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi*:* Z. H.C, me detyrë Kryetar i Bashkisë Fushë-Arrëz; Z. D.L, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik Financës dhe Tatim-Taksave.

****

2.1. *"Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit brendshëm".*

Në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*",* i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se, "*Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në germat a-c të kësaj pike"*, është ngritur dhe funksionon Sektori i Auditit të Brendshëm në varësi funksionale nga Titullari i Bashkisë Fushë-Arrëz, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardet Globale të Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.
Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkia Fushë-Arrëz, rezultoi se:

Organizimi dhe Funksionimi: Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016*, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik",* i ndryshuar, është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm (në vijim NJAB), e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm. Sektori e Auditimit të Brendshëm funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Urdhrit nr. 724 dhe nr. 4598 prot., datë 13.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz "*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative dhe institucioneve buxhetore, në varësi të Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2025".*
Njësia e AB e Bashkisë Fushë-Arrëz përgjatë vitit 2025 ka funksionuar me 3 nëpunës konkretisht me Drejtuesen e Auditimit *znj.E.P (e certifikuar),* specialist auditit *znj.L.Ç (e certifikuar),* specialist auditit *znj.D.Gj (e pacertifikuar).*

Tabela nr.1, *Struktura e njësisë AB për vitin 2025*

Nr.	Viti 2025	Funksioni	Arsimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	EP	Drejtues NJAB	I lartë Master Shkencort	14	5	2023	Jo
2	LC	Audituese	I lartë Master Shkencort	7	7	2023	Jo
3	DGj	Audituese	I lartë Bachelor	2	2	E pa certifikuar	Jo

Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Njësia e auditit të brendshëm në Bashkinë Fushë-Arrëz ka funksionuar e plotë për vitin 2025 e në vazhdim, me 3 nëpunës, ku 2/3 e stafit janë certifikuar si ABSP, në përputhje me VKM nr. 83, datë 03.02.2016*,"Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik",* i ndryshuar. Për strukturën e njësisë AB të merren masa për certifikimin e specialistes së auditimit të brendshëm, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe garantimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi.

Trajnimet e NJAB dhe certifikimet : Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, ndonëse ishte planifikuar pjesëmarrja e audituesve të NJAB në trajnimet e organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar, si dhe realizimi i trajnimit të detyrueshëm prej 40 orësh në vit, për vitin 2025 nuk rezultoi të jetë kryer asnjë trajnim nga audituesit e Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Për rrjedhojë, nuk është përmbushur kërkesa për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe realizimin e orëve minimale të trajnimit, ***në kundërshtim*** *me nenin 20, të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".*

Realizimi i Planeve Vjetore: Përgjatë periudhës janar-dhjetor 2025, nga Sektori i Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, është planifikuar të kryejë 5 misione auditimit, konkretisht 2 auditime përputhshmërie, 1 auditim performance dhe 2 auditime të kombinuar, më pas i rishikuar me planifikimin e 4 auditimeve të përputhshmërisë dhe 1 të kombinuar. Realizimi i auditimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Periudha	Të dhëna sipas raportimit						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh.	Financë	Kombinuar	Performancë	Tjera
1	2025	5	4	4	-	1	-	-

Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz, përpunoi grupi i auditimit.

1.Drejtoria e Urbanistikës, Emergjencave Civile dhe Planifikimit të Territorit;
2.Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH);
3.Sektori i Policisë Bashkiake;
4.Qendra Kulturore e Fëmijëve

Konstatim*:* Në lidhje me planet strategjike dhe planifikimet vjetore për vitin 2025, auditimet janë realizuar në masën 80% të numrit të angazhimeve të planifikuara, në kundërshtim me nenin 14, të ligjit nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",* dhe të Kapitullit III, pika 3.5, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 (*i shfuqizuar, në fuqi për periudhën objekt auditimi).*
Në lidhje me angazhimet e realizuara, u konstatua për auditimin e Drejtorisë së Urbanistikës, Emergjencave Civile dhe Planifikimit të Territorit, fushat e parashikuara për t'u audituar janë: Funksionimi i elementëve të kontrollit të brendshëm; Përputhshmëria ligjore në planifikim, zhvillim dhe mbrojtjen e territorit; Zbatimi i procedurave të dhënies lejeve të zhvillimit/ndërtimit dhe të përdorimit; Zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe kontratave të lidhura;

Organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë; Menaxhimi i proceseve gjyqësore; Hartimi i akteve juridike; Veprimtaria e Sektorit të Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve; Organizimi dhe funksionimi i Emergjencave Civile; Veprimtaria e Sektorit të Emergjencave Civile; Të ndryshme.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit nga grupi i auditimit të KLSH rezultoi se **nuk ishte kryer** auditimi i "Prokurimeve Publike", "Zbatimi i procedurave të dhënies lejeve të zhvillimit/ndërtimit dhe të përdorimit", "Përputhshmëria ligjore në planifikim, zhvillim dhe mbrojtjen e territorit" në këtë Bashki, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 134, datë 17.10.2025, të Ministrit të Financave, Kreu VII.3.1, paragrafi 11, ku përcaktohet se: "*Drejtuesi i auditimit të brendshëm përzgjedh aktivitetet dhe proceset me risk të lartë dhe ndikim të madh në arritjen e objektivave institucionale, të cilat konsiderohen prioritare për përfshirje në Planin Vjetor të Auditimit, si më poshtë: • Rëndësi strategjike për institucionin, • Ndikim të lartë në objektivat dhe burimet publike, • Mungesë ose dobësi të kontrolleve të brendshme."*, krahas parashikimit se: *"Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit".*

Raportimi: Për veprimtarinë e NJAB në Bashkinë Fushë-Arrëz, për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr.361 prot, datë 09.02.2026, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Fushë-Arrëz për vitin 2025.

Tabela nr.32 Realizimi i planit vjetor të angazhimeve audituese

Nr.	Subjektet e Audituara	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkes ë të titullari	Angazhime me përfunduara	Angazhime në proces
			A. të përputhshmërisë	*A. të performancë*	*A. financiare*	*A. tek. Informacionit*	*A. të kombinuara*				
1	Drejtoria e Urbanistikës, Emergjencave Civile dhe Planifikimit të Territorit	1	1								
2	Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH)	1	1		1						
3	Sektori i Policisë Bashkiake	1	1								
4	Qendra Kulturore e Fëmijëve	1					1				
5	Zbatimi i Rekomandimeve të lëna	1	1								
	Totali	**5**	**4**				**1**			**4**	

Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz, NJAB, përpunoi grupi i auditimit

Karta e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik: NJAB në mbështetje të Urdhrit nr. 134, datë 17.10.2025, të Ministrisë së Financave "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*", NJAB e Bashkisë Fushë-Arrëz ka hartuar *"Kartën e Auditimit të Brendshëm",* e cila është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 364, datë 10.07.2025.

Planet Strategjike dhe Vjetore: Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:
Për vitin 2025, me shkresën nr. 3239 prot., datë 08.10.2024 është miratuar plani strategjik për vitet 2025 – 2027 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2025. Këto plane janë dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë

Ministrisë së Financave, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar, si dhe Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 134, datë 17.10.2025 *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".*

Gjetje-Rekomandimet: Një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit auditues është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku *për vitin 2025* nga auditimet janë dhënë 25 rekomandime të ndara sipas prioriteteve.

Tabela nr. 3, Niveli i zbatimit të rekomandimeve

PERIUDHA	**Të dhëna sipas raportimit**			
	Rekomandime te shprehura ne numër			
	Gjithsej ne numër	**Zbatuar**	**Ne proces**	**Pazbatuar**
Viti 2025	25	3	8	14
TOTALI	**25**	**3**	**8**	**14**

Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz, përpunoi grupi i auditimit

-Rekomandimet e dhëna në vitin 2025 në total janë 25 dhe konkretisht:
-Rekomandime me nivel të lartë risku janë 7;
-Rekomandime me nivel të mesëm risku janë 15;
-Rekomandime me nivel të ulët të riskut janë 3.

Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të AB. NJAB u ka dërguar shkresa njësive të audituara për informim mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhës çështja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore.

Konstatim: Nga verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, rezultoi se niveli i zbatimit të tyre paraqitet i ulët. Konkretisht, nga rekomandimet e adresuara gjatë periudhës objekt auditimi, vetëm **44%** rezultojnë të zbatuara ose në proces zbatimi, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pazbatuar.

Komiteti i Auditit të Brendshëm: Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Fushë-Arrëz.
Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se nuk ka urdhër të titullarit për ngritjen e Komitetit të Auditimit, dhe për rrjedhojë as rregullore për të, veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar, neni 12, pika b, i cili përcakton se titullari i njësisë publike është përgjegjës për: "*Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike përkatëse sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave,* sipas shkronjës "b" të nenit 23 të këtij ligji" dhe VKM nr. 160, datë 2.3.2016 "*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike".*

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12 dhe 13, të ligjit 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 *"Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.".*

Auditimi i dosjeve të auditimit të kryer nga DAB

Grupi auditimit duke pasur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në periudhën objekt auditimi 2025, përzgjodhi të auditojë dosjet si më poshtë:

1. Drejtoria e Urbanistikës, Emergjencave Civile dhe Planifikimit të Territorit;
2. Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH);
3. Sektori i Policisë Bashkiake;
4. Qendra Kulturore e Fëmijëve

Tabela nr. 4 Dokumentacioni i dosjeve të audituara për NJAB Bashkia Fushë-Arrëz

Nr.	Viti	Objektet e audituara	Përshkrimi i punës së Njësisë së Auditit të Brendshëm
			Përbërja e dosjes
			Njoftim auditimi dokument nr. 1950 prot., datë 04.07.2025
			Takimi fillestar datë 04.07.2025
			Program auditimi nr.1950/1prot., datë 07.07.2025
			Projekt Raport nr. 2795 prot., datë 12.09.2025
		Drejtoria e Urbanistikës, Emergjencave Civile dhe Planifikimit të Territorit	Raport Final nr.2848 prot., datë 17.09.2025
1	**2025**		
			Përbërja e dosjes
			Njoftim auditimi dokumenti nr.1120 prot. datë 16.04.2025
			Takimi fillestar datë 29.04.2025
			Program auditimi nr.1216 prot., datë 29.04.2025
		Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe	Projekt Raport nr. 1513 prot., datë 04.06.2025
2	**2025**	Shpëtimi (MZSH);	Raport Final nr.1562 prot., datë 09.06.2025
			Përbërja e dosjes
			Njoftim auditimi dokumenti nr.2831/1 prot., datë 16.09.2025
			Program auditimi nr. 2838 prot., datë 17.09.20225
			Takimi fillestar datë nr. 2837 prot., datë 17.09.2025
			Takimi përmbyllës datë 06.10.2025
			Projekt Raport nr.1224/4 prot., datë 18.07.2025
			Raport Final nr.3354 prot., datë 24.10.2025
3	**2025**	Sektori i Policisë Bashkiake	Memorandum drejtuar Kryetarit nr.3354/2 prot., datë 24.10.2025
			Përbërja e dosjes
			Njoftimi auditimi dokument nr. 3584/1 prot., datë 12.11.2025
			Takim fillestar datë.25.07.2025
			Program auditimi nr.3619 prot., datë 13.11.2025
			Projekt Raport nr.4103 prot., datë 30.12.2025
			Raport Final nr.165 prot., datë 22.01.2025
			Memorandum drejtuar Kryetarit nr.2360/4 prot., datë 18.12.2025
4	**2025**	Qendra Kulturore e Fëmijëve	

Burimi: NJAB Bashkia Fushë-Arrëz, trajtuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Gjetjet kryesore të Auditit të brendshëm:

-Nuk janë hartuar dhe miratuar procedura për menaxhimin e riskut, që mundësojnë identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e risqeve që ndikojnë në arritjen e objektivave të sektorit. Gjithashtu, mungojnë gjurma e auditimit dhe hartat e proceseve kryesore të punës.

-Nuk është krijuar dhe administruar një regjistër zyrtar për evidentimin dhe ndjekjen e lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga bashkia.

-U konstatua mungesë e trajnimeve për punonjësit për një periudhë të gjatë kohore, si dhe mungesë e një plani ose kalendari vjetor trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve profesionale.

-Në Qendrën Komunitare për Fëmijët (QKF) mungon një rregullore e miratuar që të përcaktojë procedurat dhe standardet për transportin e fëmijëve.

-Në Sektorin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH) mungojnë shërbimet e digjitalizuara dhe një hartë e plotë e territorit ku ushtrohet veprimtaria. Gjithashtu, në shumicën e rasteve, punonjësit nuk janë pajisur me uniformat e punës në përputhje me kërkesat dhe standardet përkatëse.

Konstatim: -Në raportet përfundimtare të auditimit, audituesit **nuk** kanë dhënë opinion të përgjithshëm mbi vlerësimin e sistemeve të audituara, nëse këto sisteme janë efektive dhe nëse funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, e cila duhet të integrohet edhe në kapitullin e përmbledhjes ekzekutive (*e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara)* dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar.
-Raportet e Auditimit **nuk** kanë të përfshirë në përmbledhjen ekzekutive një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, ku përcaktohet se "*Përmbledhja Ekzekutive shpjegon qëllimin e raportit, prezanton në mënyrë sintetike aktivitetet më të rëndësishme të vitit, gjetjet dhe rekomandimet kryesore, si dhe jep një vlerësim të përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut*" (Aneksi 3, Formati Standard nr. 12).

Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm: Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Njësia e Auditimit në Bashkinë Fushë-Arrëz ka funksionuar me tre punonjës për vitin 2025, njëkohësisht drejtuesi i NJAB ka marrë pjesë në grupin e Auditimit në çdo angazhim auditimi. Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Fushë-Arrëz ka hartuar *"Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm"* me shkresën nr.2484/2 prot., datë 26.08.2025, sipas kërkesave të Kreut XI.3.2 "Vetëvlerësime ose vlerësime periodike", të MAB të vitit 2025.

Dosja e përhershme: Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se audituesit e brendshëm **nuk** kanë përditësuar dosjet e përhershme të auditimit, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Auditimit të Brendshëm, ku përcaktohet se: *Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhime auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.*
Nuk është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Fushë-Arrëz, në kundërshtim me Ligjin nr. 60/2016 "*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit".*

Përfundime mbi NJAB:

- Njësia e auditit të brendshëm në Bashkinë Fushë-Arrëz ka funksionuar e plotë për vitin 2025 e në vazhdim, me 3 nëpunës. Drejtuesi i NJAB është i certifikuar kurse një specialiste është e pacertifikuar. Realizimi i trajnimit të detyrueshëm prej 40 orësh në vit, për vitin 2025 nuk rezultoi të jetë kryer nga audituesit e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr.114/2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",* neni 20 "trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm";
-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me nenin 12, pika b, të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";
-Nuk është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, në kundërshtim me Ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit";
-Nuk ishte kryer auditimi i sistemeve/nënsistemeve si të "Prokurimeve Publike", "Zbatimi i procedurave të dhënies lejeve të zhvillimit/ndërtimit dhe të përdorimit", "Përputhshmëria ligjore në planifikim, zhvillim dhe mbrojtjen e territorit" (pjesë e universit të auditimit të brendshëm), në

kundërshtim me përcaktimet pikës 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, (i shfuqizuar, në fuqi në periudhën objekt auditimi)*, "Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit", s*i dhe me përcaktimet në Kreu VII.3.1, paragrafi 11 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.134, datë 17.10.2025 të Ministrit të Financave.

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se audituesit e brendshëm nuk kanë përditësuar dosjet e përhershme të auditimit, kjo në mos përputhje me përcaktimet pikës 6.3 në Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, (i shfuqizuar, në fuqi në periudhën objekt auditimi), ku përcaktohet se: *Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi*:*
-z.H.C, me detyrë Kryetar i Bashkisë Fushë-Arrëz;
-znj. E.P, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Auditit të Brendshëm.

2. Planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua si më poshtë vijon:

Struktura organizative e Drejtoria Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave për vitin 2025 ka qenë si më poshtë vijon:

Tabela nr 5. Struktura organizative e Drejtoria Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave për vitin 2025

Nr	Emërtimi i pozicionit	Emër Mbiemër	Formimi arsimor
1	Drejtor Finance Buxhet	D.L.	I larte Ekonomik
2	Përgjegjës Buxheti	F.B.	I larte Ekonomik
3	Specialist Kontabiliteti	D.Gj.	I larte Ekonomik
4	Specialiste Finance dhe Buxheti	E. E.	I larte Ekonomik
5	Specialist Pagash dhe kontributesh	M. F.	I larte Ekonomik
6	Specialist Finance Njesia Iballe	D. P.	I mesem
7	Specialist Finance Njesia Fierze	P.M.	I mesem
8	Specialist Finance Njesia Blerim	A. V.	I larte Ekonomik

Burimi: Drejtoria Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave

1.1.Programimi PBA-së 2025-2027 dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025:

- Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027, rezultoi se është ngritur Grupi Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin nr.15, datë 09.01.2024 si dhe janë hartuar EMP (Ekipi i Menaxhimit të Programit).
- Sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë të mësipërm është krijuar grupi i punës për hartimin e buxhetit të vitit 2025 ku përfshihen anëtarët e GMS dhe drejtues të NJA dhe institucioneve të varësisë së Bashkisë.
- Grupi i auditimit ka analizuar dokumentacionin e hartimit te PBA-se për tre fazat dhe dokumentimin e hartimit të kërkesave buxhetore nga çdo sektor apo zyrë:
- Tavanet Buxhetore janë miratuar në Këshillin Bashkiak me VKB nr. 12, datë 29.03.2024, *"Për miratimin e Tavaneve të Buxhetit Afatmesëm 2025-2027"*
- Me shkresën nr. 1725 prot., datë 28.05.2024, është dërguar pranë Ministrisë së Financave Draft PBA 2025-2027 për Bashkinë Fush Arrëz.
- Me VKB nr. 34, datë 28.08.2024, është miratuar faza I-rë e PBA 2025-2027.

- Me VKB nr. 64, datë 23.12.2024, "*Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025, shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar, të ardhurave dhe transfertës sektoriale të parashikuar, një pjesë e transfertës së trashëguar, transfertën e kushtëzuar si dhe kalendarin buxhetor për vitin 2025*", janë miratuar PBA 2025-2027 si dhe buxheti 2025 në vlerën 481,263,000 lekë.
- Me VKB nr. 20, datë 09.06.2025, "*Për disa shtesa në VKB nr. 64, datë 23.12.2024, "Për buxhetin e vitit 2025"* janë miratuar shpërndarjet si më poshtë vijon;
1. Trasferta e pakushtëzuar e trashëguar për vitin 2025, në vlerën 30,748,190 lekë.
2. Të ardhura të trashëguara për vitin 2025, në vlerën 23,755,217 lekë.

Për një total prej 54,503,407 lekë
- Me VKB nr. 36, datë 09.10.2025*, "Për një shtesë në VKB nr. 64, datë 23.12.2024, "Për buxhetin e vitit 2025"*, KB ka vendosur të rrisë limitin e të ardhurave në vlerën 14,895,000 lekë, financuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër
- **Nuk** janë miratuar tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm dhe nuk është bërë miratimi i PBA 2025-2027 *(Faza II)* dhe rrjedhimisht nga ana e Bashkisë nuk është dërguar në Ministrinë e Financave faza e dytë e PBA-së, veprime jo në përputhje me Udhëzimi 23, 30.07.2018, Pika 19
- Faza e III dhe Buxheti i Bashkisë Fushë Arrëz për vitin 2025 është miratuar me VKB nr. 64 datë 23.12.2024 , aprovuar nga Prefektura nr. 5/1,date.13.01.2025 "Për Buxhetin 2025

Sipas VKB nr. 64, datë 23.12.2024 është miratuar Buxheti Vjetor 2025 (me të ardhurat gjithsej dhe shpenzimet gjithsej në shumën 481,263,000 lekë dhe të detajuara sipas natyrës, miratuar plani i të ardhurave për periudhën 3 vjeçare të PBA-së dhe detajimi i buxhetit 2025-2027 për grupin e shpenzimeve korente dhe kapitale sipas programit buxhetor afatmesëm 2025-2027).

Buxheti i Bashkisë Fushë Arrëz për vitin 2025 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1725 prot., datë 28.05.2024.

Tabela nr *6* Burimet që përbejnë Buxhetin për vitin 2025:

Nr	**Burimet qe e përbejnë buxhetin 2025**	**Plan Buxhetit fillestar 2025**	**Shtesat**	**Total Planet e Buxhetit 2025**	**Fakti 2025**	**Mbetur**	**Në % te Planit dhe realizimit**
1	Transferta e pakushtëzuar(granti) 2025	137,191,608	6,607,255	143,798,863	84,139,852	59,659,011	58.51%
2	Të trashëguarat viti 2024 nga granti	50,117,000	30,748,190	80,865,190	80,865,190	0	100.00%
3	Transferta specifike 2025	125,429,703	3,533,001	128,962,704	117,079,911	11,882,793	90.79%
4	Të trashëguarat viti 2024 nga transferta specifike	13,818,000		13,818,000	13,818,000	0	100.00%
5	Të ardhurat vendore 2025	28,555,000	27,778,857	56,333,857		56,333,857	0.00%
6	Te ardhura te trashëguara	18,118,200	23,755,217	41,873,417	20,379,345	21,494,072	48.67%
1	**Shuma 1 (Buxheti nga te ardhurat e veta)**	**373,229,511**	**92,422,520**	**465,652,031**	**316,282,298**	**149,369,733**	**67.92%**
	Fondet e kushtëzuara nga Buxheti i Shtetit	108,033,000	12,895,340	120,928,340	111,908,401	9,019,939	92.54%
2	**Shuma 2 (Buxheti i Shtetit)**	**108,033,000**	**12,895,340**	**120,928,340**	**111,908,401**	**9,019,939**	**92.54%**
	TOTAL Shuma1+ Shuma 2	**481,262,511**	**105,317,860**	**586,580,371**	**428,190,699**	**158,389,672**	**73.00%**

Burimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave

Konstatim: Në pasqyrën e mësipërme evidentohet një shtesë në buxhetin nga të ardhurat e veta në vlerën **92,422,520 lekë** dhe një shtesë në Fondet e Kushtëzuara nga Buxheti i Shtetit në vlerën **12,895,340 lekë**.

Buxheti i Bashkisë për vitit **2025** është realizuar në vlerën **428,190,699 lekë,** ose **73%** kundrejt planit vjetor të vitit **2025**. Nga këto **316,282,298 lekë** nga të ardhurat e veta dhe **111,908,401 lekë** nga buxheti i shtetit.

Takimet konsultative me grupet e interesit në komunitet: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Fushë Arrëz për PBA 2025-2027 dhe Projekt buxhetin e vitit 2025, ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit në komunitet, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I, neni 5 pika ç;

Dëgjesa publike PBA 2025-2027

PBA 2025-2027	
	Datat e mbajtjes së tyre
Numri i takimeve	**6**
NjA Administrative Qender,	14.11.2024 ora 11:00
NjA Administrative Qafe Mali	19.11.2024 ora 13:00
NjA Administrative Blerim	31.10.2024 ora 14:00
NjA Administrative Iballe	18.11.2024 ora 13:00
NjA Administrative Fierze	31.10.2024 ora 10:00

Burimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave

Procesi konsultativ me komunitetin është realizuar nëpërmjet njoftimit zyrtar në stenda, ëeb-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave njoftohet komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj., vërtetuar kjo nga proces verbalet e mbajtura në secilin takim, konform kuadrit ligjor në fuqi: Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I neni 5 pika ç; Ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" Kreu IV, neni 11-20; dhe pika 16 e Udhëzimit të MF nr.3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", (shtojca 4).

16.Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore organizon takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-së.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Programi afatmesëm 2025-2027 është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen vendore"*, Ligjin nr. 9936/2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin nr. 9652/2006 "*Për sistemin e taksave vendore"* aktet e tjera nënligjore në fuqi si dhe Udhëzimin e MF nr. 6, datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027" dhe VKB për miratimin e taksave vendore për Bashkinë për vitin 2025.

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2024 dhe 2025paraqitet në tabelën e mëposhtme

lekë

Emërtimi	Viti 2024	Viti 2025
Të ardhurat faktike	561,171,425	544,764,258
Shpenzimet faktike	442,702,653	428,190,699

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave

a. Programimi i PBA 2025-2027 dhe programimi i buxhetit vjetor 2025:

Tabela nr 7, PBA përmbledhëse *000/ lekë*

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2024	Faza e I PBA 2025	Faza e II PBA 2025	Projekt Buxhet 2025
600	Paga	166,776	174,137	253,124	253,124
601	Sigurime Shoqërore	28,067	33,067	42,505	42,505
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	44,837	50,520	55,437	55,437
605	Transferta Korente të Huaja	722,932			
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	93,315	12,279	114,827	114,827
I	**Shpenzime Korrente**	**333,718**	**270,003**	**465,893**	**465,893**

230	Kapitale të Patrupëzuara	4,023		3,700	3,700
231	Kapitale të Trupëzuara	104,961		11,670	11,670
	Shp. Kapitale me financim te brendshëm				
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				
II	**Shpenzime Kapitale**	**108,984**		**15,370**	**15,370**
III	**Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti**				
I+II +III Totali I Shpenzimeve		**442,702**	**270,003**	**481,263**	**481,263**

Burimi: Drejtoria Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2025

- Me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 64, datë 23.12.2024, është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi njësive administrative dhe funksionet e deleguara për vitin 2025.
- Me Vendimin nr. 64, datë 23.12.2024 është miratuar niveli i pagave të Bashkisë Fushë Arrëz.
- Me VKB nr. 64, datë 23.12.2024, "*Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025, shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar, të ardhurave dhe transfertës sektoriale të parashikuar, një pjesë e transfertës së trashëguar, transfertën e kushtëzuar si dhe kalendarin buxhetor për vitin 2025*", janë miratuar PBA 2025-2027 si dhe buxheti 2025 në vlerën **481,263,000 lekë.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se për vitin 2025, totali i planifikuar për të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë në vlerën **28,555 mijë lekë** ndërsa realizimi në vlerën **57,474 mijë lekë** ose në masën **132 .3 %.**
Në tabelën e mëposhtme po paraqesim parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së "të ardhura nga burimet e veta"

Kodi	Lloji	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
1	Të ardhura nga taksat locale	20,705.00	20,705.00	20,705.00
1.4	Të ardhura nga taksat e ndara	6,615.00	6,615.00	6,615.00
2.4	Të ardhura nga tarifa vendore	7,850.00	7,850.00	7,850.00

Burimi: Drejtoria Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave

Buxheti i vitit 2025

Më poshtë paraqitet tabela e realizimit të shpenzimeve për vitin 2025

Tabela nr. 8 Mbi realizimin e shpenzimeve për vitin 2025

Bashkia + Ndërmarrjet/institucionet e vartësisë Viti 2025								
Art.	Emërtimi	Fakti 2024	PBA (Plan 2025)	Buxheti Vjetor		Fakti 2025	Diferenca	%
				Plani Fillestar 2025	Plani Rishikuar 2025			
600	Paga	166,776	253,124	253,124	255,826	213,712	42,114	84
601	Sigurime Shoqërore	28,067	42,505	42,505	43,483	35,701	7,782	82
600+601	**Paga +Sigurime**	**194,843**	**295,629**	**295,629**	**299,309**	**249,413**	**49,896**	**83**
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	44,837	55,437	55,437	70,690	46,079	24,611	65
603	Subvencione	0					0	
604	Transferta Korente të Brendshme	723			3,122	2,691	431	86
605	Transferta Korente të Huaja	0					0	
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	93,315	114,827	114,827	99,166	88,411	10,755	89

602-606	**Shpenzime operative**	**138,875**	**170,264**	**170,264**	**172,978**	**137,181**	**35,797**	**79**
Shpenzime Korrente		**333,718**	**402,343**	**465,893**	**472,287**	**386,594**	**85,693**	**82**
230	Kapitale të Patrupëzuara	4,023	3,700	3,700	18,999	8,419	10,580	44
231	Kapitale të Trupëzuara	104,961	11,670	11,670	53,478	33,178	20,300	62
Totali	**Shpenzime Kapitale**	**108,984**	**15,370**	**15,370**	**72,477**	**41,597**	**30,880**	**57**
Totali (korrente + kapitale)		**442,702**	**417,713**	**481,263**	**544,764**	**428,191**	**116,573**	**79**

Burimi: Drejtoria Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave

- Me VKB nr. 64, datë 23.12.2024, "*Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025, shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar, të ardhurave dhe transfertës sektoriale të parashikuar, një pjesë e transfertës së trashëguar, transfertën e kushtëzuar si dhe kalendarin buxhetor për vitin 2025",* janë miratuar PBA 2025-2027 si dhe buxheti 2025 në vlerën **481,263,000 lekë.** Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2025 kanë vlerën 28,555 mije lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 137,191 mije lekë, transferta specifike në vlerën 125,430 mije lekë. Të trashëguara nga transferta në vlerën 63,935 mijë lekë. Transferta e kushtëzuar në vlerën 108,034 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara në vlerën 18,118 mijë lekë
Në total të ardhurat kanë vlerën 481 263 mijë lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën. vlerën 481 263 mijë lekë.
Në tabelën e mëposhtme pasqyrojmë të ardhurat dhe transfertën sektoriale të parashikuar, një pjesë e transfertës së trashëguar, transfertën e kushtëzuar;

Tabela nr. 9, në 000/lekë

Transfertës së pakushtëzuar	137,191
Transfertës sektoriale	125,430
Transfertës së trashëguar	63,935
Totali 1	**326,556**
Të Ardhura	28,555
Të Ardhura të trashëguara	9,685
Të Ardhura jashtë limiti	8,433
Totali 2	**46,673**
Transferta Kushtëzuar	108,034
Totali 3	**108,034**
Totali 1+2+3	**481,263**

Burimi: Drejtoria Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave

Në total të ardhurat kanë vlerën 481,263 mijë lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë të njëjtën vlerë 481,263 mijë lekë.

<u>Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;</u>

Ndryshimet e buxheteve periudha 01.01.2025-31.12.2025

- Me VKB nr. 20, datë 09.06.2025, "Për disa shtesa në VKB nr. 64, datë 23.12.2024, "Për buxhetin e vitit 2025" u miratua shpërndarja si më poshtë vijon;

1. Transferta e pakushtëzuar e trashëguar për vitin 2025, në vlerën **30,748,190 lekë**.
2. Të ardhura të trashëguara për vitin 2025, në vlerën **23,755,217 lekë**

Për një total prej **54,503,407 lekë**

- Me VKB nr. 36, datë 09.10.2025, "Për një shtesë në VKB nr. 64, datë 23.12.2024, "Për buxhetin e vitit 2025", vendosi të rrisë limitin e të ardhurave në vlerën **14,895,000 lekë**, financuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër

Konstatim: Buxheti fillestar ishte në vlerë 481,263 mijë lekë, ndërsa buxheti i rishikuar: 544,764 mijë lekë. Realizimi faktik është në vlerën 428,191 mijë lekë dhe niveli i niveli i realizimit në

masën 79 %. Realizimi nga të ardhurat e veta është në vlerën 66,532 mijë lekë apo në masën 12 %.

Auditimi mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencës

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se totali i miratuar për emergjencat civile për vitin 2025 është në vlerën **8,140,000 lekë**. Këtij fondi i është shtuar fondi i kushtëzuar për Emergjencat civile në vlerën **2,782,861 lekë**. Nga këto fonde janë përdorur **2,992,920 lekë** për marrjen e masave parandaluese. U konstatua se pjesa më e madhe e fondeve të kushtëzuara të emergjencave është e papërdorur. Planifikimi është bërë në përputhje me kërkesën ligjore 3%, sipas përcaktimeve ligjore të ligjit nr.45/2019 *"Për mbrojtjen civile",* neni 65, "Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej *3 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre,* të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si të ardhurat e veta vendore etj."

Vlera e fondit rezerve dhe të kontigjencës të miratuara dhe të shpenzuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

lekë

Nr.	Burimi i financimit	Vlera e planifikuar	Vlera e shpenzuar	Vlera e pa shpenzuar
1	Fond rezervë	1,000,000	1,000,000	1,000,000
2	Fondet e kontrigjencës	1,000,000	1,000,000	1,000,000
3				
	Total	**2,000,000**	**2,000,000**	**2,000,000**

Burimi: Drejtoria Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave

Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Fushë Arrëz

Për vitin 2025 nuk ka subvencione dhe nuk është marrë kredi nga Bashkia Fushë Arrëz.

Fondet e trashëguara nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz nga vitet e mëparshme janë:

Fondet e trashëguara në 31.12.2024 për përdorim në vitin 2025 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2025 për përdorim në vitin 2026 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)
135,416,607	149,369,733

Burimi: Drejtoria Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave

1.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizmit të të ardhurave (faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE

Bashkia Fushe Arrëz nuk ka detyrime të prapambetura

Nga dokumentacioni vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se Bashkia Fushë Arrëz nuk ka detyrime të prapambetura si dhe nuk ka asnjë proces gjyqësor të hapur nga punonjësit e larguar apo subjektet që ushtrojnë aktivitet nën administrimin e Bashkisë Fushë arrëz.

****

2.1. Mbi auditimin e mbledhjes dhe administrimit të taksave dhe tarifave vendore.

Struktura organizative e Bashkisë Fushë Arrëz për vitin 2025 është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz nr. 04, datë 09.01.2025, "Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Fushë Arrëz".

Tabela nr. 10, Struktura e Sektorit të Tatim Taksave Vendore për vitin 2025.

Sektori i Tatim Taksave Vendore		
NR.	**EMER MBIEMER**	**POZICIONI**
1	V.P.	Përgjegjës Sektori Tatim Taksa
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË TË ARDHURAVE		
2	B.C.	Specialist Sektori Tatim Taksa
3	A.V.	Specialist Finance dhe Tatim Taksa Nj.A. Blerim
4	Z.B.	Specialist Tatim Taksa Nj.A. Blerim
5	A.Z.	Specialist Finance dhe Tatim Taksa Nj.A. Blerim

Burimi: Sektorit të Tatim Taksave

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve: Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Fushë Arrëz për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, është miratuar me Vendimin nr. 61, datë 23.12.2024, "*Për miratimin e paketës Fiskale në Bashkinë Fushë Arrëz për vitin 2025".* Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Fushë Arrëz për vitin 2024 dhe vitin 2025 paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Tabela nr 11, Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitit 2024 dhe vitin 2025

Nr.	Lloji Taksës/Tarifës	Viti 2024			Viti 2025		
		Plan	**Fakt**	**%**	**Plan**	**Fakt**	**%**
1	Tatim i thjesht Fitimi	50,000	124,056	248.1	50,000	-	-
2	Takse mbi token bujqësore	1,625,000	78,620	4.83	1,625,000	71,180	4
3	Takse ndërtese	2,700,000	3,039,517	112.5	2,700,000	1,472,718	55
4	Takse trualli	1,800,000	2,257,947	125.4	1,800,000	1,003,613	58
5	Taksa te tjera te ngjashme (tarife/taksa)	100,000	1,273,334	1273.3	100,000	876,183	876
6	Taksa vjetore e mjeteve te përdorura	3,600,000	3,672,481	102	3,600,000	4,266,848	119
7	Tarife zënie hapësire publike	150,000	150,345	100.2	150,000	119,620	80
8	Takse ndikimi ne infrastrukturë	100,000	130,200	130.2	100,000	124,000	124
9	Takse ndriçimi, tabele	435,000	327,525	75.2	435,000	398,135	92
10	Te ardhura nga shitja e druve te zjarrit	1,600,000	5,820,516	363.7	1,600,000	511,854	32
11	Tarife për leje karburanti	800,000	433,334	54.1	800,000	600,000	75
12	Tarife për leje ndërtimi	700,000	373,940	53.4	700,000	4,853,870	693
13	Te Ardhura nga Qiratë nga toka bujqësore	68,000	67,580	99.3	68,000	67,580	99
14	Te Ardhura nga Qiratë	5,300,000	6,225,428	117.4	5,300,000	10,674,075	201
15	Tarife për leje transporti	450,000	330,610	73.4	450,000	661,815	147
16	Tarife pastrimi	4,000,000	7,993,655	199.8	4,000,000	7,961,875	199
17	Te Ardhura Jo Tatimore	620,000	598,300	96.5	620,000	715,350	115
18	Tarife parkingu	60,000	24,000	40	60,000	24,000	40
19	Te Ardhura nga MZSH	27,000	58,338	216	27,000	20,000	74
20	Te Ardhura nga GJOBA	100,000	382,155	382.1	100,000	285,931	286
21	Tatim mbi te Ardhurat Personale 2%	2,150,000	3,277,464	152.4	2,150,000	3,597,114	167
22	Te Ardhura te tjera (grande + sponsorizime)	100,000	8,913,862	8913.8	100,000	16,275,000	109
23	Takse fjetje ne hotel	20,000	-	0	20,000	-	-
24	Takse nga renta minerare	2,000,000	-	0	2,000,000	2,751,880	138
25	Taksa Vendore Reklame	-	-	0	-	10,000	-
26	Gjoba Sistemi Tatimor	-	-	0	-	131,215	-
27	Taksa për Zyrën e Regjistrimit te Pasurisë	-	-	0	-	-	-
	Totali	**28,555,000**	**45,553,207**	**159.5**	**28,555,000**	**57,473,857**	**201**

Burimi i të dhënave: *Bashkia Fushë Arrëz, Sektori Tatim Taksa*

- Për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **28,555 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **45,553 mijë lekë** referuar Akt-Rakordimit me Degën e Thesarit ose në masën **159.5%** me një mbirealizim ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **16,998 mije lekë.**
- Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **28,555 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **57,474 mijë lekë** referuar Akt-Rakordimit me Degën e Thesarit ose në masën **201%** me një mbirealizim ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **28,919 mije lekë.**

Sikurse shihet edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme, si për vitin 2024, ashtu edhe për vitin 2025 është planifikuar <u>në të njëjtën vlerë</u> **28,555 mijë lekë,** edhe pse realizimi për vitin 2024 ka qenë në masën 159.5%**,** me një mbirealizim ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **16,998 mije lekë.** Pra për vitin 2025 kemi programim jo të saktë dhe të pa bazuar në kapacitetet reale, duke vendosur vlera të pa argumentuara në mungesë të të dhënave se mbi çfarë baze janë bërë përllogaritjet për çdo taksë dhe tarifë. Këtë situatë e tregojnë treguesit e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, ku për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet me diferenca mosrealizimi ndërmjet parashikimit dhe realizimit, ndërsa disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin, kështu:

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

a) "*Takse vjetore mjeteve të përdorura*" është planifikuar në vlerën 3,600 mijë lekë (njëlloj si parashikimi në vitin 2024), ndërsa arkëtimet janë në vlerën 4,267 mijë lekë ose realizuar në masën 119%.

b) "*Taksa Ndikimit Infrastrukturë*" është planifikuar në vlerën 100 mijë lekë (njëlloj si parashikimi në vitin 2024), ndërsa arkëtimet janë në vlerën 124 mijë lekë ose realizuar në masën 124%.

c) "Tarifë për Leje Ndërtimi" është planifikuar në vlerën 700 mijë lekë (njëlloj si parashikimi në vitin 2024), ndërsa arkëtimet janë në vlerën 4,854 mijë lekë ose realizuar në masën 693%.

d) "*Të ardhura nga qiratë*" është planifikuar në vlerën 5,300 mijë lekë (njëlloj si parashikimi në vitin 2024), ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,674 mijë lekë ose realizuar në masën 201%.

Por referuar të dhënave të sipërpërmendura disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

a) "*Tatim i Thjeshtë mbi Fitimin*" është planifikuar në vlerën 50 mijë lekë, (njëlloj si parashikimi në vitin 2024), ndërsa arkëtimet janë në vlerën 0 lekë ose realizuar në masën 0%.

b) "*Takse mbi Tokën Bujqësore*" është planifikuar në vlerën 1,625 mijë lekë, (njëlloj si parashikimi në vitin 2024), ndërsa arkëtimet janë në vlerën 71 mijë lekë ose realizuar në masën 4%.

c) *"Taksë fjetje në hotel"* është planifikuar në vlerën 20 mijë lekë, (njëlloj si parashikimi në vitin 2024), ndërsa arkëtimet janë në vlerën 0 lekë ose realizuar në masën 0%.

d) "*Të ardhura nga shitja druve të zjarrit*" është planifikuar në vlerën 1,600 mijë lekë, (njëlloj si parashikimi në vitin 2024), ndërsa arkëtimet janë në vlerën 512 mijë lekë ose realizuar në masën 32%.

Konkluzion:

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se për vitin 2025 u konstatua programim jo i saktë dhe i pa bazuar në kapacitetet reale, duke vendosur vlera të pa argumentuara se mbi çfarë bazë janë përllogaritur parashikimet për çdo taksë dhe tarifë vendore. Sektori Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz, nuk ka kryer një studim për programimin e parashikimit të të ardhurave mbi taksat dhe Tarifat vendore për vitin 2025, por ka vendosur të njëjtat parashikime sipas vitit paraardhës 2024, për të gjitha Taksat dhe Tarifat Vendore. Sa më sipër, nuk ishte kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë

përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.
-Nga analiza u konstatua se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.
-Në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk ishte kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë viteve paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.
Këto veprime e mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 64, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave"* Kreu IV, pika 200.

Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta: Bashkia Fushë Arrëz vepron mbi bazën e Rregullores së Brendshme miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz nr. 11, datë 08.04.2025 me objekt *"Miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Fushë Arrëz dhe të Njësive Administrative".* Në këtë rregullore nuk është caktuar personi përgjegjës i cili ka për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt-rakordimeve me ta.
Të ardhurat nga agjentët tatimorë *(Drejtoria Rajonale e Tatimeve në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale, DSHTRR në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura)*, derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Fushë Arrëz dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit duke kuadruar me akt-rakordimin e të ardhurave. Të ardhurat e arkëtuara nga agjentët tatimorë për vitin 2025 paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Tabela nr.12 , Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitit 2025 nga agjentët tatimore. *Lekë*

Nr.	Emërtimi	Plani 2025	Realizimi 2025	%
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (DRT)	50,000	0	0
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (DRT)	2,150,000	3,597,114	167
3	Taksa Vjetore Mjeteve Përdorura (DSHTRR)	3,600,000	4,266,848	119
4	Taksa mbi Transaksionet e Pasurive të. Paluajtshme (ASHK)	5,740,117	5,685,544	99
5	Taksa e Rentës Minerale (Dogana)	2,000,000	2,751,880	138
	Totali	**19,997,170**	**93,286,454**	

Burimi i të dhënave: *Bashkia Fushë Arrëz, Sektori Tatim Taksa*

Për vitin 2025 ndërmjet Sektorit Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz dhe agjentëve tatimorë nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore.
Për sa trajtuar më sipër, Bashkia Fushë Arrëz i referohet vetëm vlerave të arkëtuara nga agjentët tatimorë sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit por nuk ka një bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimorë dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Fushë Arrëz, duhet të marrë masa për

evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore",* neni 117, ku përcaktohet që "*Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*". Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, "Për taksat kombëtare".

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Sektori Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz, për abonentë familjarë nuk disponon regjistra fizik dhe nuk ka asnjë informacion për ngarkesat fiskale apo edhe pagesat e abonentëve familjarë si dhe kujt periudhe i përkasin këto pagesa.

Për abonentët familjarë, nuk ka agjentë tatimor për mbledhjen e mbledhja e taksave dhe tarifave vendore.

Mungesa e një regjistri për abonentët familjarë si dhe mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore është gjithashtu detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për Sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: "Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar".

Menaxhimi i borxhit

Abonentët familjarë në Bashkinë Fushë Arrëz dhe në Njësitë Administrative duhet të tarifohen me taksa dhe tarifa vendore në bazë të VKB nr. 61, datë 23.12.2024, "*Për miratimin e paketës Fiskale në Bashkinë Fushë Arrëz për vitin 2025".*Njoftimet për taksat dhe tarifat vendore përgatiten nga *Sektori Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz*, brenda muajit prill të vitit fiskal. Njoftimet dorëzohen dorazi dhe me postë për shkak të volumit të lartë të abonentëve familjarë. Abonentët debitorë paguajnë pranë arkave të zyrave të njësive administrative.

Abonentët debitorë familjarë nuk janë njoftuar me formularin *"Njoftim dhe Kërkesë për të Paguar (aneksi A - Formulari MSh001), kur taksapaguesi nuk ka paguar në afat detyrimet e tij, lidhur me taksat e tarifat vendore", veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin e përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore".*

Gjithashtu, pasi kanë kaluar 10 (dhjetë) ditë pune nga dërgimi i dokumentit të "*Njoftim dhe Kërkesë për të paguar*" nga titullari i NJVV duhet të nxirret urdhri i bllokimit. *Sektori Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz* është vepruar në kundërshtim me *Udhëzimin e përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore" pika 2, urdhri bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesit.*

Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk ka një Regjistër për Abonentët Familjarë dhe as një data baze për debitorët progresiv për këtë kategori. Gjithashtu nga dokumentacioni vënë në dispozicion të grupit

të auditimit u konstatua se nuk gjendet informacion se kujt periudhe i përkasin pagesat e kryera nga Kategoria e Abonentëve Familjarë për detyrimet mbi taksat dhe tarifat vendore.
Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se debia progresive për kategorinë e Abonentëve Familjarë nuk mund të llogaritet pasi nuk ka informacion mbi numrin e familjeve në juridiksionin e Bashkisë Fushë Arrëz.
Duhet theksuar se mungesa e një regjistri për abonentët familjarë sjell një mungesë informacioni për të ardhurat që duhet të sigurohen nga abonentët familjarë si edhe kujt periudhe i përkasin këto pagesa. Si rrjedhojë, në kushtet e mungesës së informacionit mbi ngarkesën për tarifat e miratuara në paketën fiskale të vitit 2025, për kategorinë e abonentëve Familjarë, Grupi i Auditimit e ka të pamundur përllogaritjen e detyrimin progresiv total për këtë kategori në fund të vitit 2025.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Kreu XI "*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara"*, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "*Për financat e qeverisjes vendore".*

<u>Planifikimi dhe arkëtimi i Taksës së Tokës Bujqësore</u>

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar, neni 23, pika 1. Sipas Aneksit 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", Bashkia Fushë Arrëz klasifikohet në kategorinë e IV, ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore sipas bonitetit, paraqitet në tabelën mëposhtme:

Tabela nr.13.

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	1,400
II	1,200
III	1,100
IV	1,000
V	900
VI	800
VII-X	**700**

Burimi i të dhënave: *Bashkia Fushë Arrëz, Sektori Tatim Taksa*

Bashkia Fushë Arrëz për vitin 2025 ka parashikuar të arkëtoi të ardhura nga taksa për tokën bujqësore në vlerën 1,625 mijë lekë ndërkohë që realizimi i kësaj takse për vitin 2025 është në vlerën 71 mijë lekë apo 4% të parashikimit.
Sipas të dhënave që disponon *Sektori Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz,* sipërfaqja totale e tokës bujqësore në administrim të Bashkisë Fushë Arrëz është 11363 ha. Nga kjo sipërfaqe tokë e ndarë me AMTP janë 3310 ha dhe tokë në pronësi shtetërore 8053 ha. Në tabelën e mëposhtme po paraqesim ndarjen e tokës bujqësore në Bashkinë Fushë Arrëz si dhe tarifën e Taksës së Tokës Bujqësore sipas Bonitetit të Tokës.

Në tabelën e mëposhtme nr. 14, paraqitet informacion mbi ndarjes e tokës bujqësore në Bashkinë Fushë Arrëz.[4]

[4]- Duhet theksuar se gjatë fazës së terrenit, mbi planifikimin dhe arkëtimin Taksës së Tokës Bujqësore, përsa I përket sipërfaqeve të tokës bujqësore në juridiksion dhe në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe ndarjes së saj, u është vënë në dispozicion informacion jo i plotë.

Nr.	Njësia Administrative	Toke bujqësore gjithsej/ha	Toke e pandare/ha	Toke e ndarë/ha (Ligji 7501)	Kateg	Lekë/ha	Totali
1	Nj. A. Fushë Arrëz	150	69	81	7	700	**105,000**
2	Nj. A. Blerim	521	346	175	8	700	**364,700**
3	Nj. A. Iballë	652	422	230	7	700	**456,400**
4	Nj. A. Qafë Mali	455	243	212	8	700	**318,500**
5	Nj. A. Fierzë	533	334	199	9	700	**373,100**
Totali		**2311**	**1414**	**897**		**700**	**1,617,700**

Burimi i të dhënave: *Bashkia Fushë Arrëz*

Sikurse shihet edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme totali i të ardhurave që duhet të arkëtojë Bashkia Fushë Arrëz është **628 mijë lekë.** Drejtoria e Urbanistikës dhe Kontrollit të Territorit në Bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz, edhe pse sipas ndarjes dhe kategorive të tokave bujqësore duhet të arkëtojë një total prej **628 mijë lekë,** ka bërë parashikim mbi të ardhurat qo do arkëtohen nga taksa e Tokës Bujqësore për një total prej **1,625 mijë lekë,** parashikim i pabazuar në të dhënat analitike mbi sipërfaqet, kategoritë dhe bonitetin e Tokës bujqësore të ndarë me AMTP, *veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200.*

Sipas akt rakordimit të të ardhurave nga kjo taksë është arkëtuar vlera **71 mijë lekë** për të cilën nuk kemi informacion të analizuar për cilën periudhë fiskale është arkëtuar kjo vlerë.

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Bashkia Fushë Arrëz nuk disponon sistem elektronik për administrimin dhe regjistrimin e taksave dhe tarifave vendore për abonentët private.

Të dhënat e abonentëve privatë janë të regjistruara vetëm në exel dhe nuk disponohet regjistër fizik në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" neni nr. 7: "*Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar*".

Situata e lëvizjes së subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:

Nga informacioni i mësipërm është kërkuar praktika e mbajtur me QKB për bizneset të cilat kanë aplikuar për mbyllje ose pezullim aktivitetit gjatë vitit 2025 si më poshtë:

Mënyra e llogaritjes dhe vlerësimi i të ardhurave sipas paketës fiskale abonentët biznes: Referuar të dhënave të paraqitura nga *Sektori Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz,* janë verifikuar regjistrat elektronike për biznesin e madh. Nga regjistri elektronik u verifikuan të dhënat për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit. Tarifa e pastrimit për biznesin e madh është ngarkuar në përputhje me paketën fiskale të Bashkisë Fushë Arrëz.

Menaxhimi i borxhit nga taksat dhe tarifat vendore: Nga auditimi u konstatua se,

- Deri më datë 31.12.2024, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet si biznes i vogël, biznesi i madh dhe Institucionet Shtetërore në vlerën **27,064,571 lekë.**

- Gjatë vitit 2025, ngarkesa për kategorinë e biznes i vogël, biznesi i madh dhe Institucionet Shtetërore është **14,233,000 lekë.** Nuk janë përllogaritur Kamatëvonesa për debinë e krijuar nga kjo kategori deri në vitit 2025.

Pagesa të kryera gjatë vitit 2025 për taksat dhe tarifat vendore sipas paketës fiskale për kategorinë e biznes i vogël, biznesi i madh dhe Institucionet Shtetërore është për një total **1,111,731 lekë.** Duhet theksuar fakti se nuk është përcaktuar se cilës periudhe i përkasin këto pagesa.

Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2025, për kategorinë biznes i vogël, biznesi i madh dhe Institucionet Shtetërore janë në vlerën 27,064,571 lekë (Detyrimet progresive 31.12.2024) + 4,976,554 lekë (Debia krijuar 2025) - 1,111,731 lekë (pagesa kryer 2025) **= 30,041,125 lekë.** ***Ky detyrim tatimor është i kontabilizuar.***

Në lidhje me këtë situatë *Sektori Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz*, për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, por në asnjë rast nuk është kërkuar kallëzim penal në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 181 "Mos pagimi i taksës dhe tatimeve". Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, ku përcaktohet që: "Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore" si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10.

Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se Drejtoria e Urbanistikës dhe Kontrollit të Territorit si dhe Sektori Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz, në lidhje me legalizimet e ndërtimeve informale nuk kanë asnjë informacion mbi këto legalizime.

Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Kontrollit të Territorit si dhe Sektorit Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz nuk është mbajtur korrespondencë me DRASHK Shkodër për bashkëpunim midis dy institucioneve dhe marrjen e informacionit të nevojshëm për ngarkesat fiskale për legalizimet informale dhe për vjeljen e taksës së infrastrukturës për këto legalizime.

Gjatë vitit 2025, Sektorit Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz, ka bërë parashikim për Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë por duke u bazuar vetëm për objektet e reja, në vlerën **100,000 lekë** dhe ka patur një arkëtim në vlerën **124,000 lekë,** apo një realizim në masën 124%.

Regjistri i subjekteve të hotelerisë me ngarkesat fiskale për çdo detyrim, gjendje 31.12.2025

Sikurse shihet nga tabela mbi parashikimin dhe realizimin e Taksave dhe tarifave vendore të aplikuara në paketën fiskale miratuar me VKB nr. 61, datë 23.12.2024, realizimi i të ardhurave nga taksa fjetjes në hotele është 0%.

Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të liçencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit u konstatua se përgjatë vitit 2025 në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz dhe njësive administrative

është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 4 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.
Në tabelën e mëposhtme paraqesim regjistri i subjekteve që tregtojnë karburante, të shoqëruar dhe me dosjet personale 2025, si dhe pagesa e taksës për autorizim.

Tabela nr 16, Të dhënat për subjektet që tregtojnë hidrokarbure paraqiten si më poshtë:

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca	Marrveshje me bashkinë
			Fillimi	Mbarimi				
1	V T O Sh.p.k	L.....K	01.04.2025	31.03.2026	200,000	200,000	0	Mars 2024
2	N sh.p.k	L.....D	28.08.2025	27.08.2026	200,000	200,000	0	Korrik 2024
3	L sh.p.k	L.....O	05.02.2025	04.02.2026	1,400,000	580,000	820,000	Nentor 2024
4	K O sh.p.k	L.....A			600,000	120,000	480,000	Dhjetor 2025
				Shuma	**2,400,000**	**1,100,000**	**1,300,000**	

Burimi: *Bashkia Fushë Arrëz*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se
- subjekti "*VTO Sh.p.k*" ka bërë marrëveshjen për likuidim detyrimi me këste dhe pajisje me autorizim një vjeçar për stacion shitje karburanti me shkresën nr. 827 prot., datë 25.03.2024.
- subjekti *"N Sh.p.k*" ka bërë marrëveshjen për likuidim detyrimi me këste dhe pajisje me autorizim një vjeçar për stacion shitje karburanti me shkresën nr. 2219 prot., datë 09.07.2024.
- subjekti "*K.O Sh.p.k"* ka bërë marrëveshjen për likuidim detyrimi me këste dhe pajisje me autorizim një vjeçar për stacion shitje karburanti me shkresën nr. 3783 prot., datë 02.12.2025. Ky subjekt është debitor për periudhën 2022-2025 për një total prej 600,000 lekë nga të cilat ka likuiduar 120,000 lekë dhe rezultoi debitor më 31.12.2025 në vlerën 480,000 lekë.
- subjekti "*L. Sh.p.k*" ka bërë marrëveshjen për likuidim detyrimi me këste dhe pajisje me autorizim një vjeçar për stacion shitje karburanti me shkresën nr. 4416 prot., datë 21.11.2024. Ky subjekt rezultoi debitor për një total prej 1,400,000 lekë nga të cilat ka likuiduar 580,000 lekë dhe rezultoi debitor më 31.12.2025 në vlerën 820,000 lekë.
Nga të dhënat e sipër përmendura rezultoi se subjektet që tregtojnë hidrokarbure kane një debi progresive për tarifë për leje karburanti (Leje për Autorizim) për një total prej 1,300,000 lekë.

Përfundime:

1.Sistemi i planifikimit të të ardhurave nuk është ndërtuar mbi analiza reale të bazës tatimore dhe kapaciteteve të arkëtimit, duke sjellë parashikime jo realiste dhe mosmatje të saktë të performancës fiskale.
Edhe pse të ardhurat totale janë realizuar në masën 159.5% në vitin 2024 dhe 201% në vitin 2025, planifikimi është mbajtur i pandryshuar në të dy vitet (28.555 milionë lekë), pa reflektuar rezultatet e vitit paraardhës, ndryshimet në bazën e tatimpaguesve apo potencialin real të arkëtimit. Diferencat shumë të mëdha ndërmjet planit dhe realizimit për disa zëra, si dhe mosrealizimi pothuajse i plotë i disa të tjerëve, tregojnë se procesi i planifikimit nuk mbështetet në analiza ekonomike dhe fiskale të dokumentuara.
2.Administrimi i të ardhurave paraqet dobësi të konsiderueshme në regjistrimin, monitorimin dhe kontrollin e detyrimeve tatimore, duke kufizuar aftësinë e bashkisë për të administruar në mënyrë efektive të ardhurat e veta.
Mungesa e regjistrave të plotë për abonentët familjarë, mungesa e një sistemi elektronik të administrimit fiskal, mosndarja e arkëtimeve sipas vitit të krijimit të detyrimit, mungesa e

rakordimeve me agjentët tatimorë dhe mosadministrimi i plotë i debive fiskale nuk lejojnë evidentimin e saktë të bazës tatimore dhe të detyrimeve të papaguara. Për pasojë, raportimi financiar nuk pasqyron në mënyrë të besueshme gjendjen reale të të ardhurave dhe borxhit fiskal.
3.Dobësitë në ndjekjen e detyrimeve dhe zbatimin e procedurave të mbledhjes së borxhit kanë kufizuar potencialin e bashkisë për të rritur të ardhurat nga burimet e veta.
Auditimi evidenton mosndjekje sistematike të debitorëve, mungesë të procedurave standarde të mbledhjes me forcë, mosaplikim të plotë të masave administrative dhe ligjore ndaj debitorëve dhe agjentëve tatimorë, si dhe mungesë të koordinimit institucional për administrimin e disa burimeve të të ardhurave (legalizimet, taksa mbi tokën bujqësore, subjektet e hotelerisë etj.). Këto mangësi kanë ndikuar në krijimin dhe mbajtjen e një niveli të lartë detyrimesh të prapambetura dhe në mosshfrytëzimin e plotë të potencialit fiskal të bashkisë.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
z.H.C. Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe z. V.P. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve dhe Taksave.

3. Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat *financiare si më poshtë:*

- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci);
- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);
- Formati 3 - Pasqyra e flukseve monetare; (Cash Flow).
- Formati 4 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5 - Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
- Formati 6 - Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7 - Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto; Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati 8 - Pasqyra statistikore e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të Bashkisë Fushë Arrëz për vitin ushtrimor 2025 janë të nënshkruara nga z. H.C. - Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. D.L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.
PFV janë depozituar pranë Degës së Thesarit Pukë me shkresën nr. 927 prot., datë 24.03.2026, dhe konfirmuar (nënshkrim elektronik) nga kjo Degë me datën 26.03.2026.
Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore janë të shoqëruara me inventarin e llogarive, me situacionin e shpenzimeve dhe të ardhurave, si dhe aktet e rakordimit, të hartuara mbi realizimin e buxhetit vjetor, dokumente këto të firmosura/konfirmuara nga Dega e Thesarit.
Sa më sipër, nga auditimi i në lidhje me përgatitjen, paraqitjen dhe depozitimin të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore për vitin kalendarik të mbyllur më 31 dhjetor 2025, evidentohet se janë zbatuar afatet e detyrueshme nga ana e institucionit brenda 31 marsit të vitit pasardhës. *Sa më sipër,* vepruar në përputhje me kërkesat e Kreut V "Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore", Paragrafi nr.118, të UMF nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar.

Nga auditimi rezultoi se, të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara me nr. 927, datë 24.03.2026 janë të njëjta me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ, *(në këto të fundit nuk përfshihet TD e llog. 520 "Disponibilitete në Thesar"),* në përputhje me përcaktimet e Kreut V "Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes së përgjithshme", pika 10 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.127, datë 19.12.2025 "Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025"si dhe paragrafët me nr. 14 dhe 15, të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në UMF nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*

Ditarët e mbajtur për regjistrimin e veprimeve kontabile: Nga verifikimi i pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore rezultoi se, janë mbajtur ditarët për regjistrimin e veprimeve kontabile dhe centralizatori për veprimet përmbledhëse. Llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, kuadrojnë si shumë totale (Aktivet gjithsej = Pasivet + Fondet neto); llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike, *trajtuar më hollësisht në vijim*. Veprimet kontabile janë azhurnuar periodikisht nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, janë pasqyruar veprimet në ditarë, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi.
Sa më sipër, kanë gjetur zbatim përcaktimet e Kreut I, paragrafi 2.2.6, të UMF nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar.
Gjatë auditimit të kryer për periudhën objekt shqyrtimi, u konstatua se mbajtja e llogarive kontabile dhe nxjerrja e bilancit për vitin 2025, është realizuar në mënyrë manuale, duke përdorur programin *"Microsoft Excel".* Ky program i pa certifikuar për mbajtjen e regjistrave financiare, nuk mund të konsiderohet si *"bartës informatik*", sipas përkufizimit të dhënë nga dispozitat e akteve ligjore e nënligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
"Bartës informatik" është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.
Sipas Kreut 2.2 "Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik", pika nr. 6 të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 dhe UMF nr. 30, dt. 27.12.2011, "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", njësitë e qeverisjes vendore kanë për detyrë të evidentojnë në mënyrë kronologjike dhe të dokumentuar çdo transaksion ekonomik. *Çdo transaksion duhet të mbështetet në bartësit e informacionit kontabël përkatës* (mandate, fletë-hyrje/dalje, ditarë, libra kontabël etj.), në përputhje me sistemin e llogarive buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave.
Në këtë kuadër, Bashkia Fushë Arrëz duhet të ndërmarrë masa për përmirësimin e sistemit të kontabilitetit dhe implementimit të programeve financiare, *që garantojnë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.*

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:
Për vitin 2025, nga verifikimi dhe testimi i transaksioneve për çdo muaj, të ditarit kontabël të bankës për shpenzimet sipas natyrës (Klasa 6 dhe Klasa 2) me akt-rakordimin e thesarit mbi bazën e dokumentit të nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj, për shumat në çdo llogari dhe në totalin mujor e vjetor, nuk konstatohen diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës së shpenzimeve, ku janë hedhur autorizimet buxhetore (çeljet) dhe destinacionet e përdorimit të fondeve sipas llojit të shpenzimeve dhe klasave të llogarive.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit është raportuar Degës së Thesarit, si vijon:

- Situacioni i Shpenzimeve Vjetore (me burim nga granti i pakushtëzuar dhe specifik, nga të ardhurat dhe nga granti i kushtëzuar) për vitin 2025, është hartuar dhe ngarkuar në sistem nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz. Ky situacion është nënshkruar rregullisht nga NA dhe NZ i njësisë shpenzuese me nr. 26 prot, datë 02.02.2026, nënshkruar në inspektori përgjegjës i DTH Pukë z.R.K. dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit znj P.V..
- Me datën 02.02.2026 është mbajtur akti i rakordimit midis përfaqësuesve të Bashkisë Fushë Arrëz dhe Degës së Thesarit Pukë, mbi rakordimin e nivelit të realizimit të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore të periudhës Janar-Dhjetor 2025, që është nënshkruar rregullisht nga NA e NZ, ku janë evidentuar dhe shumat e të ardhurave që trashëgohen nga viti 2025 në vitin 2026 në PLTH.
- Me datën 02.02.2026 është mbajtur akti i rakordimit për mjetet në ruajtje (llogaria 4662104 dhe llog.4665100, në trajtë progresive për periudhën Janar-Dhjetor 2025), nënshkruar rregullisht nga NA dhe NZ, Nëpunësi i Degës së Thesarit për 54 objekte investimesh, garanci që fillojnë nga viti 2014 dhe detajohen deri në fund të vitit 2025 në shumën prej 12,728,020 e barabartë me tepricën kreditore të llogarisë 466.

Pra, rezultoi se, për periudhën e audituar, në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat e Bashkisë Fushë Arrëz, janë mbajtur akt rakordimet periodike e vjetore, që janë kundër-firmuar rregullisht për të dhënat nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. *Për sa sipër*, është vepruar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9936, date 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, neni 3, pika 4 dhe 6, Paragrafit nr.88 dhe 221, të Kreut IV, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Paragrafit nr.12, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme".

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar

veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat, etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Fushë Arrëz për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2025, deri më datën 31.12.2025.** Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve të transaksioneve, proceduara anlitike dhe teste thelbësore, ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2025 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.
Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 u konstatua se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike, trajtuar hollësisht në vijim.

Treguesi i precizionit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet vjetore për Bashkinë Fushë Arrëz në auditimin e vitit 2025 është 7,171,801 lekë për shpenzimet dhe 8,711,288 lekë për të ardhurat.

Nga procesi i auditimit dhe verifikimi i vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2025, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e tyre, treguesit e aktiveve dhe aktiveve neto paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 18: Aktivet dhe pasivet e Bashkisë Fushë Arrëz 2025

Lekë

	31.12.2025	**31.12.2024**
Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	**1,363,568,595**	**1,483,703,989**
Aktivet	**1,706,573,110**	**1,815,029,208**
Pasivet	**343,004,515**	**331,325,219**

Lekë

	31.12.2025	**31.12.2024**
Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.	**504,152,066**	**478,826,552**
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues"	**11,777,818**	**12,084,726**
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra"	**330,276,495**	**319,703,083**
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre"	**162,097,753**	**147,038,743**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, PFV 2025.

- ***<u>Mbi rakordimin e PFV të Bashkisë me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë SIFQ;</u>***

U auditua përputhja e të dhënave mbi totalin e aktiveve, pasiveve dhe aktiveve neto sipas PFV të hartuara nga ana e njësisë raportuese Bashkia Fushë Arrëz dhe të dorëzuara zyrtarisht në DTH dhe PF të gjeneruara nga Ministria e Financave në SIFQ.

Viti 2024

Grupi	Emërtimi	Pasqyrat Financiare 2024	SIFQ 2024
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,483,703,989	1,214,565,246
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,483,703,989	873,273,037

Viti 2025

Grupi	Emërtimi	Pasqyrat Financiare 2025	SIFQ 2025
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,363,568,595	1,201,138,194
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,363,568,596	854,208,075

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, PFV 2025., SIFQ nga Dega e Thesarit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSh-së.

Sa më sipër, zërat e SIFQ rakordojnë (me përjashtim të llog.26), me përcaktimet e Kreut V "*Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes së përgjithshme*", pika 10 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.127, datë 19.12.2025 "Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025" si dhe pika 14, Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", e UMF nr.5, datë 21.02.2022.

A. AKTIVET

1.AKTIVE AFATSHKURTRA

Nga auditim rezultoi se në Formatin nr.1 "Pasqyra e Pozicionit Financiar" të Llogaridhënies Vjetore 2025, zëri "*<u>Aktivet Afatshkurtra"</u>* në aktiv të bilancit paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 504,152,066 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 478,826,552 lekë, duke rezultuar me shtesën e tyre prej +25,325,514 lekë.

-Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 162,097,753 lekë, të cilat rakordojnë me *Rubrikën VI " Teprica e likuiditeteve në fund te vitit ushtrimor*" në Formatin nr.3 *"Pasqyra e flukseve monetare/ cash-flow",* sipas metodës direkte".
-Gjendja e llogarisë 520 "Disponibilitete në Thesar", sipas bilancit në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 162,097,753 lekë, gjendje e cila rakordon me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 *"Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2025".*
Llogaria 520 *"Disponibilitete në thesar*", kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 162,097,753 lekë dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 12,728,020 lekë. dhe llogarisë 85 prej 149,369,733 <u>lekë.</u>

		Viti 2025	Viti 2024
520	Disponibilitete në Thesar	162,097,753	147,038,743

466	Kreditore për mjete në ruajtje	12,728,020	11,622,136
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	149,369,733	135,416,607
	Shuma (llog. 466 + 85):	162,097,753	147,038,743

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Llogaria 520 "*Disponibilitete në thesar"* duhet të ketë kundër parti llogarinë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje"* e cila paraqitet në shumën 12,728,020 lekë dhe llogarinë 85 "*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës"* e cila paraqitet në shumën 149,369,733 lekë.
Për sa më sipër, llogaria 520 "*Disponibilitete në thesar*" që është në vlerën 162,097,753 përputhet me totalin e llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje"* + llog. 85 *"Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës"* për vitin 2025 dhe për vitin 2024.
Këto veprime janë në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa "dh", si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, paragrafët 49-50, ku përcaktohet që:

Paragrafi 49. Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.
Paragrafi 50. Tepricat e llogarisë ***520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin****, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).*

-***Në klasën 3 "Gjendja e inventarit qarkullues"*** të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 11,777,818 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 12,084,726 lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej -306,908 lekë pasqyron efektin në shpenzime dhe rakordon me gjendjen e llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjeve të inventarit"* në formatin nr.2 "*Pasqyra e performancës financiare*". Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:
-*Gjendja e* ***llogarisë 32 "Inventari i imët"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 11,328,424 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 10,636,984 lekë me një shtesë prej 691,440 lekë për vitin ushtrimor 2025. Nga ana tjetër, *gjendja e llogarisë 35 "Mallra"* paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 449,394 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,447,742 lekë me një pakësim prej - 998,348 lekë për vitin ushtrimor 2025.

Tabela nr.219 Llogaritë e klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" 2025 (në lekë)

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
31	Materiale			
32	Inventar i imët	11,328,424	10,636,984	+691,440
33	Prodhime, punime e shërbime në proces			
34	Produkte			
35	Mallra	449,394	1,447,742	-998,348
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)			
Totali		**11,777,818**	**12,084,726**	**-306,908**

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz

Gjendja e llogarive të mësipërme materiale është e kuadruar me tepricën e tabelave të inventarizimit fizik të pasurisë. Për kryerjen procedurave të inventarizimit të pasurisë është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. *Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në*

kredi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

-Klasa 4 "Llogari të arkëtueshme" paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 330,276,495 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 319,703,083 lekë, ku rezultoi shtesa prej +10,573,412 lekë krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes se detyrimeve te debitorëve të ndryshëm dhe të llogarisë së operacioneve me shtetin (për të drejtat). Gjatë vitit 2025 janë shtuar detyrimet për 5,283,711 lekë dhe pakësimet janë arkëtimet e vlerës 1,894,248 lekë.

Tabela nr.20.Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra", viti 2025 (në lek)

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal			
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma të tjerë shoqërore			
44	Institucione të tjera publike			
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes			
468	Debitorë te ndryshëm	302,275,408	298,885,945	3,389,463
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	28,001,087	20,817,138	7,183,949
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit			
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)			
Totali				
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime		0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin		0	
477	Diferenca konvertimi aktive		0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime		0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme		0	

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz

*-Gjendja e **llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm",*** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 302,275,408 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 298,885,945 *lekë,* duke rezultuar me një rritje prej 3,389,463 lekë, ose rreth 1.13%**.** Analiza e gjendjes së llog.468 "Debitorë të ndryshëm" dhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme.
Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 302,275,408 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2025	298,885,945
Shtesa (D)	3,389,463
Pakësime (K)	0
Gjendja në 31.12.2025	302,275,408

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz

Tabela nr.21:Ndryshimet e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" gjatë vitit 2025 / në lekë

Debitorë subjekte dhe individë	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Akt kontrolle	246,952,495		1,845,748	245,106,747
Kopshte, Çerdhe	48,500	52,500	48,500	52,500
Tatim taksa	51,884,950	5,231,211		57,116,161
Totali	298,885,945	5,283,711	1,894,248	302,275,408

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz

Vlera e debitorëve në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024 ka pësuar një rritje prej 3,389,463 lekë, e cila i përket debitorëve të likuiduar gjatë vitit 2024 nga taksat dhe tarifat vendore. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të krijuar ndër vite nga mos përputhshmëritë e konstatuara nga auditimet e kryera nga KLSH, në vlerën 240,814,111 lekë dhe debitorët nga taksat dhe tarifat vendore në vlerë progresive prej 51,884,950 lekë. Pjesa tjetër janë detyrime për kopshtin dhe çerdhen në shumën 48,500 lekë dhe detyrime të mbartura nga ish komunat në shumën prej 6,138,384 lekë

Llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*" paraqitet me gjendje në shumën 298,885,945 lekë në fillim të vitit 2025, e cila ka ndryshime gjatë vitit 2025 *(shtesa dhe pakësime)* dhe paraqitet në vlerën 302,275,408 si më poshtë:

Tabela nr.22: Analiza dhe dinamika e gjendjes llog. 468 "Debitorë të ndryshëm" (2011-2025) *Në lekë*

Viti	Akt kontrolle	Kopshte, Çerdhe	Ish-komunat	tatim taksa	Viti
2025	238,968,363	32,600	6,138,384	5,127,002	
2024		19,900		3,038,144	
2023				1,502,456	
2022				1,043,023	
2021				914,052	
2020				25,298,947	
2019				3,547,260	
2018				4,133,294	
2017				2,444,469	
2016				1,017,264	
2015				1,212,310	
2014				1,028,740	
2013				1,880,020	
2012				1,640,180	
2011				3,289,000	
shuma	**238,968,363**	**52,500**	**6,138,384**	**57,116,161**	**302,275,408**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, PF dhe analiza e bilancit 2025.

Nga analiza e llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* rezultoi se gjendja në fund të vitit 2025 është 302,275,408 lekë**,** kundrejt 298,885,945 lekë në fillim të vitit, duke rezultuar me një rritje prej +**3,389,463 lekë**, ose **1.13%**. Gjatë vitit ushtrimor 2025 janë regjistruar shtesa në shumën 5,283,711 lekë, ndërsa pakësimet (arkëtimet dhe sistemimet kontabël) kanë qenë 1,894,248 lekë, duke bërë që gjendja e debitorëve në fund të vitit të mbetet në nivele të larta.

ME shkresën nr.380, datë 10.02.2026 "Dërgim listë debitorësh" Drejtorit DZHEFTT i ka adresuar Zyrës Juridike dhe Zyrës së Tatime-Taksave listën e debitorëve për të procedura me njoftim dhe ndjekje në rrugë gjyqësore, janë hartuar njoftimet administrative (nënshkruar nga zj.R.H, z.V.P dhe z.D.L), por ende të pa konfirmuara nga Kryetari I Bashkisë Fushë Arrëz).

a. Analiza e debitorëve sipas strukturë së detyrimeve

- Analiza sipas kategorive të debitorëve tregon se zëri *"Akt Kontrolle"* zë peshën kryesore të llogarisë, me një vlerë prej 245,106,747 lekë, ose 81 % të totalit të debitorëve. Krahasuar me fillimin e vitit, ky zë është ulur me 1,845,748 lekë, çka tregon se gjatë vitit janë realizuar arkëtime të pjesshme të detyrimeve të konstatuara nga aktet e kontrollit. Megjithatë, niveli i lartë i mbetur i kësaj kategorie tregon se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve vijon të mbetet e parketuar.
- Nga ana tjetër, zëri *"Tatim-Taksa"* është rritur nga 51,884,950 lekë në 57,116,161 lekë**,** ose me 5,231,211 lekë **(**10 %), duke përbërë 19 % të totalit të debitorëve. Kjo rritje ka qenë faktori kryesor që ka ndikuar në rritjen e përgjithshme të llogarisë 468 dhe tregon krijimin e detyrimeve të reja me ritëm më të lartë se arkëtimi i tyre. Për këtë arsye, institucioni duhet të

forcojë ndjekjen e procedurave të arkëtimit, veçanërisht për debitorët me vlera të konsiderueshme dhe për detyrimet e mbartura nga vitet e mëparshme, me qëllim përmirësimin e likuiditetit dhe uljen e nivelit të të drejtave të pa mbledhura.

- Debitorët për zërin "*Kopshte dhe Çerdhe"* paraqiten me një vlerë prej 52,500 lekësh**,** duke zënë një peshë të papërfillshme në totalin e debitorëve.

Nga këndvështrimi i auditimit të KLSH-së, niveli i lartë i debitorëve në fund të vitit përbën një tregues se Bashkia Fushë Arrëz vijon të mbajë të bllokuara fonde të konsiderueshme në formën e të drejtave të paarkëtuara. Në mungesë të një analize të vjetërsisë së debive dhe të informacionit mbi masat e ndërmarra për arkëtimin e tyre, ekziston rreziku që një pjesë e këtyre detyrimeve të mbartura prej disa periudhash të parashkruhen, duke ulur probabilitetin e arkëtimit të tyre dhe duke ndikuar negativisht në nivelin e arkëtimeve dhe administrimin efektiv të të ardhurave.
Në këto kushte, grupi i auditimit të KLSH-së vlerëson se institucioni duhet të intensifikojë ndjekjen administrative dhe ligjore për arkëtimin e debive, të monitorojë periodikisht vjetërsinë e tyre, të analizojë shkaqet e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për minimizimin e krijimit të debive të prapambetura, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e financave publike dhe administrimin e të ardhurave.

b. Analiza e debitorëve sipas strukturë së aktiveve të bilancit kontabël
Grupi i auditimit të KLSH-së, analizoi peshën e llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* në strukturën financiare të Bashkisë Fushë Arrëz, në raport me zërat kryesorë të bilancit.
Në datën 31.12.2025, debitorët paraqiten në vlerën 302,275,408 lekë, duke *përbërë 59.96% të aktiveve afatshkurtra dhe **17.71%** të totalit të aktiveve të Bashkisë*. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e aktiveve qarkulluese përbëhet nga të drejta të paarkëtuara, të cilat nuk janë të disponueshme për financimin e veprimtarisë së institucionit.
Gjithashtu, *raporti ndërmjet debitorëve dhe mjeteve monetare* rezultoi **1.86 : 1**, çka do të thotë se vlera e të drejtave të paarkëtuara është pothuajse dy herë më e lartë se fondet monetare të disponueshme në fund të vitit. Ky tregues evidenton rëndësinë që ka arkëtimi në kohë i debive për përmirësimin e likuiditetit të institucionit.

Konstatime:
I. ***Niveli i detyrimeve debitorë në Bashkinë Fushë Arrëz ka ardhur në rritje çdo vit***, ku në fund të vitit 2025, ka rezultuar me një rritje të të drejtave për arkëtim nga debitorët prej +3,389,463 lekë**,** ose **1.13 %.** Në datën 31.12.2025, debitorët paraqiten në vlerën 302,275,408 lekë, duke përbërë **59.96**% të aktiveve afatshkurtra dhe **17.71%** të totalit të aktiveve të Bashkisë. Ky problem mbi nivelin e lartë të detyrimeve debitorë (të drejtat për arkëtim) është trajtuar edhe në raportet e mëparshëm të auditimit të KLSH-së, ku është rekomanduar për gjetjen e origjinës nga ka lindur detyrimi, arkëtimin e këtyre vlerave, deri në ngritjen e padive gjyqësore, por mungojnë veprimet korrigjuese për sa më sipër. Nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz nuk janë kryer procedurat e kërkimit të detyrimeve në rrugë administrative e gjyqësore, por llogaria "*Debitorët e ndryshëm*" *(llog. 468)* në fund të vitit 2025 paraqitet në shumën prej 302,275,408 lekë. Për periudhën 1-vjeçare (1.1.2025 deri më 31.12.2025), niveli i arkëtimit të debitorëve është 1,894,248 lekë, ose **0.6 %** e tepricës së kësaj llogarie në fund të vitit 2024. Për vjeljen e detyrimeve nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, nuk janë aplikuar masa shtrënguese, në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me dokumentin e paketës fiskale, të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
Sa më sipër, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar; neni 42 pika 1-5 të ligjit nr.67/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e

vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar; Ligjin nr.9632, datë 30,10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar Kapitulli II, pika 6: *"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues…".*

II. Nga auditimi u konstatua një diferencë në shumën **5,250,000 lekë** detyrime të pa konstatuara dhe të pa kontabilizuara, duke sjellë nënvleftësim të kësaj llogari për të njëjtën shumë, që detajohet si më poshtë vijon:

a. nuk janë regjistruar në këtë llogari kategoria *"**Debitorët familjarë për tatime e taksa",*** të Sektorit të tatime Taksave, që për vitin 2024 janë 1,975,000 lekë, si dhe për vitin 2025 janë 1,975,000 lekë, pasi ky zë në analizën e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" ka regjistruar vetëm detyrimet e subjekteve fizik e juridik. Vetëm për vitin 2024 dhe 2025 detyrimi i kategorisë subjekte familjare i pa kontabilizuar është **3,950,000 lekë** .
b. nuk janë pasqyruar në llogarinë e debitorëve, ***detyrimet e 2 (dy) subjekteve të pajisura me autorizim/ licence hidrokarbur***e në llog.468 për **1,300,000 lekë**, pasi detyrimet e licencave për tregtimin e hidrokarbureve gjendje 31.12.2025, janë si në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr.23 , Gjendja e subjekteve të pajisura me autorizim/licencë dhe me ato është lidhur akt marrëveshje për pagesën e detyrimit për autorizimin me këste deri me dt 31.12.2025

Në lekë

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		**Detyrimi për autorizimin**	Pagesat e kryera	Diferenca	Marrveshje me bashkine
			Fillimi	Mbarimi				
1	VTO Sh.p.k	L.....K	01.04.2025	31.03.2026	**200,000**	200,000	0	Mars 2024
2	N. sh.p.k	L.....D	28.08.2025	27.08.2026	**200,000**	200,000	0	Korrik 2024
3	L.sh.p.k	L.....O	05.02.2025	04.02.2026	**1,400,000**	580,000.	**820,000**	Nëntor 2024
4	K.O sh.p.k	L.....A			**600,000**	120,000	**480,000**	Dhjetor 2025
Shuma					**2,400,000**	1,100,000	**1,300,000**	

Burimi: Sektori i Tatim Taksave, Bashkia Fushë Arrëz, (dërguar me email grupit të auditimit të KLSh-së).

Nga 4 (katër) subjekte me autorizim si Stacione të Shitjes së Karburanteve, rezultoi se 2 (dy) prej tyre, (subjektet "***L." SHPK" dhe "K.O" shpk,*** të pajisur me autorizim/licencë), nuk kanë kryer pagesat respektive për autorizimet e marra, dhe me ato është lidhur akt marrëveshje për pagesën e detyrimit për autorizimin me këste, përkatësisht për 820 mijë lekë dhe 480 mijë lekë. ***Në fund të vitit 2025 debia progresive e pa arkëtuar për 2 subjektet e pajisura me autorizim dhe që ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse/në fushën e hidrokarbureve është 1,300 mijë lekë.***

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me - Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, neni 4 "*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*", neni 15 *"…Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji…",* neni 20-Autorizimet pika 2, "*Autorizimet*

për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11[5]*, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë* ***deri në 5 vjet*** ***me të drejtë përsëritjeje***";
- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", Kreu II, pika 3 "*Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore*".
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, kreu "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)".

III. Debitorët e regjistruar nga raportet e auditimit të KSH janë në shumën e njëjtë në fillim dhe fund të vitit prej 246,952,495 lekë, kur detyrimet e kësaj kategorie zënë **82 %** të gjithë shumës së regjistruar në llogarinë 468 (prej shumës gjithsej 298,885,945 lekë) dhe ***nuk është arkëtuar asnjë shumë e tyre gjatë v.2025***. Për debitorët e lidhur me raportet e auditimit të KLSH-së nuk është proceduar duke depozituar padi dhe kërkuar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e detyrimit, ndaj këto detyrime rezultojnë të paarkëtushme, pasi bazuar në periudhën e krijimit të detyrimeve, arkëtimi i tyre ka humbur fuqinë ligjore. Kjo, bazuar në nenin 203, pika 1, të Kodit të Punës së RSH *"Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet",* si dhe neni 115 i Kodit Civil "*Parashkruhen brenda afateve prej:.... dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë".*
Mosarkëtimi në afat i debitorëve sjell riskun e parashkrimit për arkëtimin e të drejtave dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit dhe veprime në jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë "i ndryshuar*; nenet 8, 9, 10, 11, 12 dhe 27 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar e Kontrollit, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 26.01.2024 të Ministrit të Financave, (Kreu II, paragrafët 2.4.4 dhe 2.4.6 dhe aneksi nr. 6); Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "*Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve",* Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 3.12.2024 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike",* neni 7, pika 1/d.

Rezultoi se është pasqyruar në ditarët e kontabilitetit dhe në centralizatorin përmbledhës të llogarive, llogaria 470 "Llogari në pritje - të ardhura për t'u marrë" që shërben si kundërparti e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar. Llogaria 470 "*Llogari në pritje - Te ardhura për tu marre*" paraqitet me gjendje 302,275,408 lekë në fund të vitit 2025 qe lidhet me klasën e debitorëve duke kuadruar midis tyre. Këto veprime janë në pajtueshmëri me pikën 7, të Udhëzimit të MF nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

[5]- Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, neni 11- Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë".

- Pasqyrimi i ***llogarisë* 4342 *"Operacion me shtetin (të drejta)"* dhe 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"*** në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore:

- Gjendja e llogarisë ***4342 "Operacion me shtetin (të drejta)***" *(financim i pritshëm nga buxheti),* sipas PFV të depozituara në Degën e Thesarit, paraqitet në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar më datën 01.01.2025 në vlerën 20,817,138 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 28,001,087 lekë, ose me një shtesë në vlerën 7,183,949 lekë ndaj vitit të mëparshëm.

4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	28,001,087	20,817,138

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)	
Çelje e vitit 2025	20,817,138
Shtesa (K)	28,001,087
Pakësime (D)	20,817,138
Gjendja në 31.12.2025	28,001,087

Lekë

Operacion me shtetin (të drejta)	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Paga Dhjetor	14,622,874	15,958,329	14,622,874	15,958,329
Tatime Dhjetor	949,397	1,037,209	949,397	1,037,209
Sigurime shoqërore Dhjetor	4,345,648	4,638,703	4,345,648	4,638,703
Sig shëndetësore dhjetor	588,906	639,753	588,906	639,753
Fature Ujësjellësi Dhjetor	34,752		34,752	
Fature Poste dhjetor	8,110	6,240	8,110	6,240
Fature nr.24. date 3.12.2025 Çati pallatesh		1920067		1920067
Fature nr.25. date 12.12.2025 Çati pallatesh		1264785		1264785
Fature nr.27. date 29.12.2025 Blerje fadrome emergjencash		2536001		2536001
Totali	**20,817,138**	**28,001,087**	**20,817,138**	**28,001,087**

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz

Referuar Planit Kontabël dhe udhëzimeve të MF, kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401, 421, 431, 435, 436, 437 dhe 467 dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit të bashkisë për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara *(grantet korrente a kapitale që merren nga buxheti i shtetit).*
Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, llogaria 4342, *"Operacione me shtetin (të drejta)"* është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për *shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara* (*grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit*). Raste specifike të tilla janë zëra si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo detyrimet për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

- Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, "Shpenzime sipas natyrës" dhe Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).

- Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

Debitohet llogaria 4342, "Operacione me shtetin (të drejta)", Kreditohet llogaria 7206, "Financim i pritshëm nga buxheti".

U konstatua se, në mbyllje të bilancit ushtrimor më datë 31.12.2025, përmbledhësja e llogarive 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe llog e klasës 4-rt, janë në vlerën 28,001,087 lekë:

- △ Llog. 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 5,727,093 lekë
- △ Llog. 42 "Detyrime nd. aj personelit" në vlerën 15,958,329 lekë;

- Llog. 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taks në vlerën 1,037,209 lekë;
- Llog. 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,638,703 lekë;
- Llog.436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 639,753 lekë;

Shuma 28,001,087 lekë

U shqyrtua rakordimi dhe regjistrimi i llogarive kundraparti për llog.4342 dhe nga auditimi u konstatua se llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 28,001,087 lekë, kuadron me shumën e vlerës së llogarive të detyrimeve për detyrimet e konstatuara dhe të rezultuara në fund të vitit prej 28,001,087 lekë, si vijon:

Llog.	*Emërtimi*	*2025*	*2024*
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	28,001,087	20,817,138

mirëpor, llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 28,001,087 lekë, ***nuk kuadron me*** llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit”, në Pasqyrën F2 të Pozicionet Financiar të kësaj Bashkie Fushë Arrëz për vitin 2025, ndonëse për vitin 2024 teprica e llogarisë 4342 *“Operacione me shtetin (Të drejta)”* dhe 7206 paraqiten me teprica të njëjta e të kuadruara, si në tabelë:

Llog.	*Emërtimi*	*2025*	*2024*
7206	Financim I pritshëm nga buxheti	0	20,817,138

Sa më sipër, nuk ka një pozicionim të drejtë të llogarisë sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në fund të vitit 2025 të kësaj llogarie, në përputhje me trajtimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, paragrafi 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)” si dhe paragrafi “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin”, si dhe Aneksi 1.

<u>Konstatim</u>: Nga auditimi u konstatua se llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” e cila më dt 31.12.2025 është 28,001,087 lekë, nuk kuadron në fund të vitit 2025 me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, e cila në fund të vitit 2025 është regjistruar me tepricë 0 lekë. Sa më sipër, moskuadrimi i këtyre dy llogarive është në shumën **prej 28,001,087 lekë,** duke mos mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206, “*Financim i pritshëm nga buxheti*”), të cilat evidentojnë të drejta të njësive të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (*llogaria 4342*, “*Operacione me shtetin (të drejta)”.*
Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare është paraqitje jo e drejtë e pozicionit financiar. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 *“Paraqitja e Pasqyrave Financiare”*, paragrafi 27 i SNKSP 1 *“Paraqitja e Pasqyrave Financiare”*.
Sa më sipër, nuk ka një pozicionim të drejtë të llogarisë sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në fund të vitit 2025, në mos përputhje me trajtimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, paragrafi 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)” si dhe paragrafi “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin”, si dhe Aneksi 1 dhe me pikën 8, paragrafi 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i

Llogarive të të tretëve (klasa 4)" (Aneksi 1), të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", dhe pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"; nënpika 28, 29 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar:

"Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet me vete), para evidentimit të dhënave ne pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore".

***

Referuar përcaktimeve të Kreut III, nënkreu 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)", pika 8/l, të UMF nr.8, datë 09.03.2018, Llogaria ***4341, "Operacione me shtetin (detyrime)"*** është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit *për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme*.

Konkretisht, trajtimi kontabël është si më poshtë: Debitohet llogaria 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes (buxhet apo institucion) dhe Kreditohen llogaritë respektive të klasës 7 për të ardhurën e konstatuar.

E ardhura që në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të u konstatua detyrimi: Debitohet llogaria 8424, "Transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm", Kreditohet llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)".

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llog.	*Emërtimi*	*2025*	*2024*
4341	Operacione me shtetin (Detyrime)	0	0

f

Teprica e llogarisë 4341 "Operacion me shtetin (detyrime)" sipas PFV të depozituara në Degën e Thesarit Pukë për vitin 2025, paraqitet në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar në fund të v.2025 në shumën 0 lekë (rreshti 83 në pasivet e bilancit, grupi i Pasiveve Afatshkurtra). Më datën 01.01.2025 në vlerën 0 lekë.

Nga ana tjetër, shuma e llogarive 411,423-429,468 me datën 31.12.2024 paraqitet me tepricë kreditore prej 298,885,945 lekë dhe me datën 31.12.2025 për shumën, 302,275,408 lekë, ku përfshihet vetëm vlerat e llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm".*

Nr.llog	*Emërtimi*	*2025*	*2024*
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	302,275,408	298,885,945

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" e cila më dt 31.12.2024 dhe dt 31.12.2025 është 0 lekë, ndërsa kundërpartitë respektive (llogaritë 411, 468, etj.), fund të vitit 2024 dhe 2025 kanë regjistruar tepricat debitore përkatëse prej 298,885,945 lekë në fund të v.2024 dhe 302,275,408 lekë në fund të v.2025. Sa më sipër, rezultojnë mospërputhje dhe nuk ka një pozicionim të drejtë të llogarisë 4341 sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin me një moskuadrim prej 298,885,945 lekë në fund të v.2024 dhe

302,275,408 lekë në fund të v.2025. Veprimet e mosveprime në kundërshtim me trajtimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 48 dhe Kreu III, paragrafi 32; me pikën 8, paragrafi 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i Llogarive të të tretëve (klasa 4)" (Aneksi 1), të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022 "*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", dhe pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"; nënpika 28, 29 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar:

"Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet me vete), para evidentimit të dhënave ne pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore".

- Teprica debitore e **Llog.486 "Shpenzimet e periudhave te ardhshme"**, sipas PFV të Bashkisë Fushë Arrëz për vitin 2024 dhe 2025 janë evidentuar në vlerën zero lekë. Llogaria 486 përfshihet në grupin e llogarive rregulluese dhe përfaqëson shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm *(shpenzime të parapaguara). Sa më sipër, janë zbatuar përcaktimet* e paragrafit 15, pika 3.1, Kreu III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të Udhëzimit Nr.5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e veprimeve kontabile në lidhje me *llogarinë nr. 4864, "Shpenzime të periudhave të ardhshme", (mbi ndryshimin e paragrafit 42, pika 3.1, Kreu III" Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme").*

II. AKTIVET AFAT GJATA

Në formatin nr. 1 "Pasqyra e Pozicionit Financiar" të v.2025, grupi *"Aktivet Afatgjata"* në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,336,202,656 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,202,421,044 lekë, me një pakësim prej -133,781,612 ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)"* zëri AAGJ, *(AAGJ gjithsej – AF – Investime),* paraqitet në mbyllje të vitit 2024 me tepricën prej 1,130,002,413 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,147,261,788 lekë, pasqyruar në vijim sipas llogarive analitike.

Tabela nr 24 :Teprica e llogarive të klasës 20 "*Aktive afatgjata jo materiale*", 21 "*Aktive afatgjata materiale*", 25-26 "*Aktive afatgjata financiare*" dhe 23 *"Investime në proces*":

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
	II. Aktive Afatgjata	**1,202,421,044**	**1,336,202,656**	**-133,781,612**
20	**1. Aktive Afatgjata jo materiale**	**16,212,910**	**14,406,521**	**1,806,389**
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave			
202	Studime dhe kërkime	16,212,910	14,406,521	
203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme			
21	**2. Aktive Afatgjata materiale**	**1,131,048,878**	**1,115,595,892**	**15,452,986**
210	Toka, Troje, Terrene			
211	Pyje, Plantacione	5,088,456	5,088,456	
212	Ndërtesa e konstruksione	477,729,426	451,528,656	

213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	591,027,569	620,250,284	
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	18,632,054	10,513,212	
215	Mjete transporti	11,505,217	6,649,390	
216	Rezerva shtetërore			
217	Kafshë pune e prodhimi			
218	Inventar ekonomik	27,066,156	21,565,894	
24	Aktive afatgjata të dëmtuara			
28	Caktime të aktiveve afatgjata			
25-26	**3. Aktive Afatgjata Financiare**	**332,648**	**122,100,000**	**-121,767,352**
25	Huadhënie e nën huadhënie			
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	332,648	122,100,000	
	4. Investime	**54,826,608**	**84,100,243**	**-29,273,635**
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	4,451,590		
231	Për Aktive Afatgjata materiale	50,375,018	84,100,243	

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz.

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

Klasa 20 "Aktive Afatgjata jo materiale" që përbëhet nga *gjendja e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime"* në aktiv të bilancit, e cila paraqitet në vlerën neto 14,406,521lekë, ndërsa në fund të vitit 2025 rezultoi në vlerën 16,212,910 lekë. Kjo shumë rakordon me inventarin sipas kartelave të personave që kanë në ngarkim dhe me tepricën në pasqyrën 7/b të Bilancit Vjetor.

.

- **Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"** më datë 01.01.2025, ka qenë sipas kostos historike në vlerën 24,214,287 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 3,967,368 lekë Amortizim të akumuluar në vlerën 11,968,745 lekë, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 16,212,910 lekë, vlerë e cila shpreh gjendjen e mbetur progresive duke zbritur dhe amortizimin sipas normave ndër vite. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	**Nr.**	**Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"**	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	24,214,287
	2	Amortizim i akumuluar	9807766
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**14,406,521**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	3967368
	5	Amortizim i shtesës	
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	
	7	Amortizim nga pakësimet	
	4	Kosto historike	28181655
	5	Amortizim i akumuluar	11968745
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**16,212,910**

Tabela nr 25, Lista e studimeve dhe projektimeve Bashkia Fushë Arrëz, sipas kostos historike, 31.12.2025 në lekë

Studime-Projektime (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Projekt I rikonstruksionit te ujësjellësit Micoj, Kaptazhi + Linja Kryesore	165,000			390,000
Sistemim asfaltim rruga Mzi Njësia Administrative Fierze	2,845,620			165,000
Sistemim asfaltim rruga Gjinaj Njësia Administrative Q-Mali	412,562			2,845,620
Sistemim asfaltim rruga Nushaj Fushe Arrez	335,502			412,562
Shndërrimi i godinës se tregut për Bashkinë e re	1,184,054			335,502
Ndërtim i merkatës së re të qytetit Fushe Arrëz	312,452			1,184,054
Rikonstruksion i fasadave ne rrugën Rinia	1,364,862			312,452
Rikonstruksion I kanalit ujitës Micoj, Dedaj, Marinaj	1,108,280			1,364,862
Njësia Qafe Mali	1,597,100			1,108,280
Njësia Fierze	1,098,000			1,597,100
Njësia Iballe	1,448,800			1,098,000
Njësia Blerim	360,000			1,448,800
Projektim i objektit Sistemim asfaltim ndriçim dhe rikualifikim I hapësirave te gjelbra ne rrugën Rinia qytet Fushe Arrëz	560,000			360,000
Projektim i objektit Ndërtim i rrjetit të plotë te ujësjellësit të ri ne Fshatin Kryezi	3,588,000			560,000
Projektim i objektit sistemim rrethim gjelbërim i varrezave publike ne Qytetin Fushe Arrëz	350,000			3,588,000
Projekt për Shkollën 9-vjeçare Blerim	745,000			350,000

Studime-Projektime (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Projekt për hapje rruge auto rurale Fshat Aprripe Guri, Njësia Fierzë	1,827,000			745,000
Projekte teknike te kaldajave	499,200			1,827,000
Plan Menaxhimi pyjore Kryezi	4,022,855			499,200
Projekte teknike për Ish Fabrika e Fibrës	165,000			4,022,855
Projekt I rikonstruksionit te ujësjellësit Micoj, Kaptazhi + Linja Kryesore		3,967,368		3,967,368
Totali	24,214,287	3,967,368		28,181,655

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz

2. Aktivet Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 "Toka, troje, terrene"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë.

Konstatim: -Nga analiza në lidhje me të dhënat në pasqyrën më sipër, rezultoi se në këtë llogari është evidentuar për 0 zëra /objekte në vlerën 0 lekë. -Kjo llogari nuk ka përfshirë në asnjë rast vlerën e truallit (VKM nr. 89, datë 3.2.2016,"Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë") prej 1620 lekë, që përfshin shpronësimet për interes publik, e pa analizuar sipas sipërfaqeve të tyre dhe llojit të shpronësimit.

-Nga auditimi dhe analiza e gjendjes së Llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", u konstatua se nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, **nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit** asnjë prej vlerave të;

a) trojeve nën objekt për ndërtesat e shkollave që ka në administrim, **ndërtesat e shkollave, kopshteve, qendrave shëndetësore, maternitetit, shkollave, çerdheve, shtëpive të kulturës si dhe të zyrave të Nj.A-ve**, etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione";


b) trojeve të godinave të bashkisë dhe NJ=-ve,regjistruar në llog 212 të Bashkisë;

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe nuk ishte kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.


Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë (210) "Toka, troje terrene" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të.

Mungesa e informacionit kontabël për këtë llogari ndikon në informacionin që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, me efekt në procesin e inventarizimit fizik të tyre.

-Bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016,"Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Fushë Arrëzit , (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet duke filluar nga çmimi **1620 lekë/m2 për zonën kadastrale** të përfshira në juridiksionin e Bashkisë Fushë Arrëz, si në figurë:



Për zonat e tjera kadastrale duke filluar nga çmimi **100 lekë/m2** për këtë zonë kadastrale ku shtrihen fshatrat e kësaj Bashkie si Armiraj, Berishë e Sipërme, Iballë, Fushë Arrëz Fshat, Lajthizë 2, Lumbardh etj. bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016,"Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 8950 e në vijim:



Burimi: Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 950,, Bashkia Fushë Arrëz.

Nga ana e Drejtorit të Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatime Taksave me shkresën nr. 380/1, datë 10.02.2026 i është kërkuar zyrtarisht Zyrës së Menaxhimit të Territorit, si dhe Administrimit të Pyjeve me objekt "*Kërkesë për dërgim vlere troje dhe sipërfaqe pyjore*", por nuk ka asnjë veprim për sa më sipër nga këto struktura të Bashkisë Fushë Arrëz.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e:

- VKM nr. 89, datë 3.2.2016,"Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë",
- Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30;
- Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

Sa më sipër, vepruar jo në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e llogarive, në mospërputhje me përcaktimet e paragrafit 62, pika 3.3,"Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), Kreu III, të

Udhëzimit Nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe "Udhëzuesi për menaxhimin e aseteve në nivel vendor", hartuar nga USAID, Shtator 2010, faqe 24:

- **Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione"**, në fillim të vitit 2025, paraqitet në vlerën 5,948,353 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime dhe gjendja kontabël e kësaj llogarie më datë 31.12.2025, paraqitet në të njëjtën vlerë dhe sipas kostos historike dhe sipas vlerës neto, prej 5,948,353 lekë, detajuar sipas NJ-ve të Bashkisë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Pyje, kullota, plantacione (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Pyllëzim me arre dhe gështenjë	2,083,440			2,083,440
Njësia Qafe Mali	1,767,047			1,767,047
Njësia Iballe	454,800			454,800
Njësia Blerim	1,235,412			1,235,412
Pyllëzime me drurë frutor Fierze	407,654			407,654
Totali	**5,948,353**			**5,948,353**

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz.

Tabela nr 26; Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Amort.Prog.	2025	Amort Total	Vlera neto	Viti
1	Pyllëzim me arre dhe gështenjë	Cope	1	2083440	2,083,440	143,757		143,757	1,939,683	2015
2	Njësia Qafe Mali	Cope	1	1767047	1,767,047	371,079		371,079	1,395,968	
3	Njësia Fierze	Cope	1		0	0		0	0	
4	Njësia Iballe	Cope	1	454800	454,800	95,508		95,508	359,292	
5	Njësia Blerim	Cope	1	1235412	1,235,412	249,553		249,553	985,859	
6	Pyllëzime me drurë frutor Fierze	Cope	1	407654	407,654				407,654	2015
TOTALI:					**5,948,353**	**859,897**	**0**	**859,897**	**5,088,456**	

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

N R.	**Llog.**	**Analiza**	**Emërtimi i aseteve**	**Njësia**	**Sipas te dhënave kontabel**			**Sipas te dhënave inventarizimit**		
					Sasia	**Çmimi**	**Vlera**	**Sasia**	**Çmimi**	**Vlera**
1	211	211.3100	Pyllëzim me arre dhe gështenjë	cope	1	2083440	2,083,440	1	2,083,440	2,083,440
2	211	211.1000	Njësia Qafe Mali	cope	1	1767047	1,767,047	1	1,767,047	1,767,047
3	211	211.1000	Njësia Fierzë	cope	1	0	-	1	-	-
4	211	211.1000	Njësia Iballë	cope	1	454800	454,800	1	454,800	454,800
5	211	211.1000	Njësia Blerim	cope	1	1235412	1,235,412	1	1,235,412	1,235,412
6	211	211.3100	Pyllëzime me drurë frutor Fierzë	cope	1	407654	407,654	1	407,654	407,654
	Total llog.211					5,948,353	5,948,353	6	5,948,353	5,948,353

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Konstatim: Llogaria 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2025 paraqitet në fillim të vitit ushtrimore me gjendje në vlerën me vlerë neto 5,948,353 lekë e cila nuk paraqet ndryshime gjatë vitit. Nga të dhënat e audituara sa më sipër, rezultoi se amortizimi progresiv i përllogaritur për llogarinë 211 është 859,897 lekë dhe vlera e mbetur 5,088,456 lekë, si vijon:

INVENTARI KONTABEL Date 31.12.2025
MJETET KRYESORE TE TRUPEZUARA (Pyje,Plantacione dhe Kullota) llogaria 211

Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera	Amort.Prog.	2025	Amort Total	Vlera neto	Viti
Pyllezim me arre dhe geshtenje	cope	1	2083440	2,083,440	143,757		143,757	1,939,683	2015
Njesia Qafe Mali	cope	1	1767047	1,767,047	371,079		371,079	1,395,968	
Njesia Fierze	cope	1		0	0		0	0	
Njesia Iballe	cope	1	454800	454,800	95,508		95,508	359,292	
Njesia Blerim	cope	1	1235412	1,235,412	249,553		249,553	985,859	
Pyllzime me drurë frutor Fierze	cope	1	407654	407,654				407,654	2015
				0				0	
				0				0	
TOTALI:				5,948,353	859,897	0	859,897	5,088,456	

Nga ana tjetër, ***u konstatua se , referuar pasqyrave të përllogaritjes së amortizimit për llogarinë 211, në shumën 859,897 lekë, i cili nuk gjen pasqyrim tek Formati 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (me vlerën neto)", të PFV 2025 të kësaj Bashkie:***

GJENDJA DHE NDRYSHIMET E AKTIVEVE AFATGJATA(VLERA NETO)

Viti 2025

Formati nr.7/b

NE / LEKE

Nr. Reference Llogarije	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	24,214,287	9,807,766	14,406,521	3,967,368	2,160,979	0	0	28,181,655	11,968,745	16,212,9
201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	
202	Studime dhe kerkime	24,214,287	9,807,766	14,406,521	3,967,368	2,160,979			28,181,655	11,968,745	16,212,9
203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	0		0					0	0	
21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	1,581,686,937	466,091,045	1,115,595,892	73,537,642	58,144,656	0	0	1,655,284,579	524,235,701	1,131,048,87
210	Toka,troje,Terene			0					0	0	
211	Pyje,Kullota Plantacione	5,948,353	0	5,948,353					5,948,353	0	5,948,3
212	Ndertime e Konstruksione	659,552,334	208,883,575	450,668,759	49,731,142	23,530,372			709,283,476	232,413,947	476,869,5
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	846,150,982	225,900,698	620,250,284	1,884,000	31,106,715			848,034,982	257,007,413	591,027,5
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	15,408,456	4,895,244	10,513,212	8,657,960	539,118			24,066,416	5,434,362	18,632,0
215	Mjete transporti	19,250,835	12,601,445	6,649,390	6,185,000	1,323,173			25,435,835	13,930,618	11,505,2
216	Rezerva shtetrore	0		0					0	0	
217	Kafshe pune e prodhimi	0		0					0	0	
218	Inventar ekonomik	35,375,977	13,810,083	21,565,894	7,139,540	1,639,278			42,515,517	15,449,361	27,066,1
24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	0		0					0	0	
28	Caktime	0		0					0	0	

Burimi: Fragment i Pasqyrës Nr.7/b, PFV 2025, Bashkia Fushë Arrëz

Nga ana e Drejtorit të Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatime Taksave me shkresën nr. 380/1, datë 10.02.2026 i është kërkuar zyrtarisht Zyrës së Menaxhimit të Territorit, si dhe Administrimit të Pyjeve me objekt "*Kërkesë për dërgim vlere troje dhe sipërfaqe pyjore",* por nuk ka asnjë veprim për sa më sipër nga këto struktura të Bashkisë Fushë Arrëz.

Nga analiza audituese, pyjet janë aktive biologjike dhe referuar përcaktimeve të Paragrafit 7, të SKK 13 dhe SNK 41 dhe duhen trajtuar sipas SKK *"Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare" – (Përditësuar 2023*), që ka përcaktuar se : "Një njësi ekonomike duhet të njohë një aktiv biologjik ose një produkt bujqësor vetëm kur: (a) njësia ekonomike kontrollon aktivin biologjik / produktin bujqësor si rezultat i ngjarjeve të kaluara; (b) është e mundshme që në njësinë ekonomike të hynë përfitime ekonomike të ardhshme të lidhura me aktivin biologjik/ produktin bujqësor; dhe (c) vlera e drejtë ose kosto e aktivit biologjik / produktit bujqësor mund të matet në mënyrë të besueshme pa kosto ose përpjekje të tepërta.
- Aktivi biologjik është një kafshë e gjallë ose bimë. - Transformimi biologjik përfshin proceset e rritjes, shndërrimit, prodhimit dhe mbarështimit që sjellin ndryshime cilësore e sasiore në aktivin biologjik. Pyjet e destinuara për prerje *(timber forests)* nuk amortizohen në kuptimin klasik. Ato konsiderohen aktive biologjike dhe trajtohen sipas IAS 41 (SNK 41), ku maten sipas vlerës së drejtë *(fair value)* minus kostot e shitjes, ose sipas rregullave përkatëse kur vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme. Ndryshimet në vlerë njihen në rezultat, jo përmes amortizimit".

b. ***Nga auditimi u konstatua se,*** sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 Bashkisë Fushë Arrëz i kanë kaluar **3,571 zëra të listës së inventarit të pronave "Pyje dhe kullota" që transferohen për Bashkinë Fushë Arrëz**, të cilat nuk janë inventarizuar dhe kontabilizuar në librat e kontabilitetit të kësaj Bashkie. Si rrjedhojë, kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara me VKM nr. 433, dt. 08.06.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive*", pika 3, shtojca me nr.1, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Fushë Arëz

Për këto prona nuk ishte kryer verifikim fizik në lidhje me gjendjen e tyre për vitin 2025. Veprime këto në kundërshtim me, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

Nga auditimi është kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në këtë Bashki dhe rezultoi se pronat e kaluara me VKM nuk janë të regjistruara në ASHK dhe paraqitet situata si më poshtë: Kërkesat e bëra nga Bashkia Fushë Arëz janë të shumta drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër-Tiranë për regjistrim të pasurive të përfituara më VKM-të përkatëse:

***<u>Për pasuritë Pyje dhe Kullota</u>*:** Bashkia Fushë-Arrëz administron fondin pyjor dhe kullosor në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016, *"Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive"*, i ndryshuar me VKM nr. 134, datë 03.03.2021.

Në zbatim të këtyre akteve, u konstatua se janë kryer procedurat për regjistrimin e pasurive të transferuara në pronësi të Bashkisë Fushë-Arrëz nga Ministria e Mjedisit pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Si rezultat, janë çelur kartelat e pasurive të paluajtshme për **3,217 pasuri pyje dhe kullota**, të regjistruara në emër të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Megjithatë, ***Bashkia Fushë-Arrëz nuk disponon certifikatat e pronësisë, kopjet e kartelave dhe hartat treguese për këto pasuri, pasi tërheqja e tyre nga ASHK kryhet kundrejt pagesës së tarifave përkatëse***. Për shkak të kostove të konsiderueshme financiare[6] dhe kufizimeve buxhetore, Bashkia Fushë-Arrëz është shprehur se e ka objektivisht të pamundur të sigurojë dokumentacionin e plotë të pronësisë për të gjitha pasuritë e regjistruara, megjithëse ato rezultojnë të regjistruara në emër të saj në regjistrat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

<u>Konstatim:</u> Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se Bashkia Fushë Arrëz nuk disponon një regjistër të konsoliduar të aseteve për pronat publike, *<u>përfshirë kullotat, pyjet dhe sipërfaqet e tjera, si dhe nuk ka kryer vlerësimin dhe inventarizimin e tyre</u>*.

[6] - Tarifa për një pasuri është 6,000 lekë, e përbërë nga:
Certifikatë pronësie – 3,000 lekë;
Kopje e fragmentit të hartës kadastrale (hartë treguese) – 1,500 lekë;
Kopje e kartelës së pasurisë – 1,500 lekë.
Për 3,217 pasuri të regjistruara, kostoja totale për pajisjen me këtë dokumentacion arrin në 19,302,000 (nëntëmbëdhjetë milionë e treqind e dy mijë) lekë.

Rezultojnë 3,217 pasuri pyje dhe kullota, të regjistruara në emër të Bashkisë Fushë-Arrëz, por nuk disponohen certifikatat e pronësisë, kopjet e kartelave dhe hartat treguese për këto pasuri, pasi tërheqja e tyre nga ASHK kryhet kundrejt pagesës së tarifave përkatëse. Mungesa e certifikatave të pronësisë ka penguar pasqyrimin kontabël të aktiveve, duke ndikuar në saktësinë e bilancit dhe në aftësinë e njësisë për të menaxhuar pasurinë publike në mënyrë të plotë.
Këto veprime bien në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, me pikën 1 dhe 2, Kreu VI, të VKM nr. 510, datë 14.08.2001*"Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme"* dhe Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, *"Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"*. Për këto prona nuk ishte kryer verifikim fizik në lidhje me gjendjen e tyre për vitin 2025. Veprime këto në kundërshtim me, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

- **Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione"** më datë 01.01.2025, referuar të dhënave në pasqyron 7/a të Bilancit Vjetor, ka qenë me kosto historike në vlerën 659,552,334 lekë, kurse pas zbritjes së amortizimit të akumuluar, me dt 1.1.2025 teprica neto e llog.212 është 450,668,759 lekë (kolona nr.3 e formatit 7/b). Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 49,731,142 lekë, pakësime në vlerën 0 lekë. Amortizimi i akumuluar në fund të periudhës ushtrimore vlerësohet 232,413,947 lekë. Gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën neto 476,869,529 lekë.

212	Ndërtesa e Konstruksione	477,729,426	451,528,656

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz

Konstatim: Nga verifikimi i të dhënave rezultoi se gjendja e llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione", e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (Formati F1) më datë 31.12.2025, është në vlerën neto 477,729,426 lekë**,** e njëjtë me tepricën e kësaj llogarie në Pasqyrën "Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata Gjithsej me vlerën neto" (Formati F7/b), e
Ndërkohë, sipas të dhënave të Regjistrit të Aktiveve dhe normave të amortizimit, e njëjta llogari paraqitet në vlerën neto 476,869,529 lekë duke rezultuar një diferencë (mosrakordim) prej **859,897 lekë** midis dy pasqyrave financiare. Diferenca prej 859,897 lekë përkon me vlerën e amortizimit të zbritur nga llogaria 211 "Pyje dhe kullota", çka tregon se kjo shumë është reflektuar në mënyrë të gabuar në rakordimin e llogarisë 212, duke sjellë moskuadrim ndërmjet Formateve F1 dhe F7/b.
Më hollësisht,
-Gjendja e Llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* më datë 31.12.2025 në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (Formati F1) paraqitet në vlerën neto 477,729,426 lekë,

203	Koncesione,Patenta,Licenca e të ngjashme		
21	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**1,131,048,878**	**1,115,595,892**
210	Toka, T,roje, Terene		
211	Pyje, Plantacione	5,088,456	5,088,456
212	Ndertesa e Konstruksione	477,729,426	451,528,656

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz, Regjistri i aktiveve dhe normave te amortizimit

-Nga auditimi i Pasqyrës së "Gjendjes dhe ndryshimeve të AAGJ me vlerën neto" (Formati F7/b), me datë 31.12.2025, teprica e llog 212 paraqitet në vlerën neto 476,869,529 lekë, me një diferencë dhe moskuadrim për shumën 859,897 lekë (e njëjtë me amortizimin e hequr nga llogaria 211 për pyjet e kullotat)..

ËKONOMIKE

Pasqyre Anekse Statistikore

GJENDJA DHE NDRYSHIMET E AKTIVEVE AFATGJATA(VLERA NETO)

Formati nr.7/b

Viti 2025

NE / LEKE

Nr. Reference Llogarije	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	24,214,287	9,807,766	14,406,521	3,967,368	2,160,979	0	0	28,181,655	11,968,745	16,212,910
201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	0
202	Studime dhe kerkime	24,214,287	9,807,766	14,406,521	3,967,368	2,160,979			28,181,655	11,968,745	16,212,910
203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	0		0					0	0	0
21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	1,581,686,937	466,091,045	1,115,595,892	73,537,642	58,144,656	0	0	1,655,284,579	524,235,701	1,131,048,878
210	Toka,troje,Terene			0					0	0	0
211	Pyje,Kullota Plantacione	5,948,353	0	5,948,353					5,948,353	0	5,948,353
212	Ndertime e Konstruksione	659,552,334	208,883,575	450,668,759	49,731,142	23,530,372			709,283,476	232,413,947	476,869,529

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz, PFV 2025, F7/b

Analiza e detajuar e shtesave të llogarisë 212 paraqitet në pasqyrën si më poshtë: (në lekë)

Emërtimi	Shuma
Rikonstruksion i Kopshtit qytet Fushe Arrëz	47583780
Rrethim varreza fshati Cebik	1164000
Rrethim varreza Qafe Mali, Lumbardhe	983362
Totali:	**49,731,142**

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz

-Nga auditimi i llogarisë 212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione*" gjatë vitit 2024 dhe 2025 rezultoi se janë kontabilizuar dhe kapitalizuar në këtë llogari shpenzimet për investime të realizuara nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz në shumën 8,439,052 lekë, për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilat nëpërmjet programeve të ndryshme janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie. Më hollësisht, referuar të dhënave të disponuara mbi procesin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit, u konstatua se janë kryer shpenzime me bashkëfinancim (me burim transferta e pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe të ardhurat e veta), për projektin "Rikonstruksion çati pallatesh":

Tabela nr 10, Lista e investimeve te veta (Transferta e pakushtëzuar + Të ardhura) në lekë

Lista e investimeve te veta (Transferta e kushtëzuar)

2	***Rikonstruksion çati pallatesh M100399***	3,538,800	3,538,800

Burimi: Përgjigjet e Bashkisë për pyetësorin e buxhetit

Lista e investimeve te veta (Transferta e pakushtëzuar + Të ardhura) në lekë


Nr.	Objekti	Plan	Fakt
3	***Bashkëfinancimi me projekte me donatore***	3,522,000	3,521,409

Burimi: Përgjigjet e Bashkisë për pyetësorin e buxhetit

Nr.	Objekti	Plan	Fakt
4	***Rikonstruksion fasadash Rruga "Rinia" celur nga v.2024***		1,364,054

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz.

Nga auditimi rezultoi se janë kryer kontabilizmet e projekteve të investimeve në favor te tretëe për objektin: "*Rikonstruksion çati pallatesh",* kodi M100399 duke prekur llogarinë 212 në shumën 8,493,052 lekë, si më poshtë vijon:



Debi		Kredi	
520	8,493,052	105	8,493,052
231.2102	8,493,052	404	8,493,052
404	8,493,052	520	8,493,052
212.0102	8,493,052	231.2102	8,493,052
145	8,493,052	212.0102	8,493,052
105	8,493,052	145	8,493,052
Shuma :	50,958,312	Shuma :	50,958,312

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave.

Gjithashtu, rezultoi të jenë kryer "*Shpenzime të investimeve për rikonstruksionin e fasadave të pallateve, Rruga "Rinia"",* të cilat janë financuar nga FZHSH dhe deri në momentin e kryerjes së auditimit në këtë bashki nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Fushë Arrëz.

Konstatim: Gjithash*tu janë kontabilizuar në llogarinë 212 "Ndërtime e rikonstruksione", disa zëra punimesh që janë regjistruar në aktive, të pa adresuara në zëra aktivi konkret në llogarinë 212, në kundërshtim me parimet dhe standardet kontabël, si vijon*

2120103	Punime me fadrome	copë	1	121500

Aktive te pa bashkuara shpenzimet e rikonstruksionit apo shtesat e kryera për obkektin e bashkisë, si vijon:

2120103	Ndërtesë Bashkie	Copë	1	2953812
2120107	Rikonstruksion Ndërtesa Bashkisë	Copë	1	1382381
2120103	Shtesë Godina e Bashkisë	Copë	1	8061854

Kësaj Bashkie:

Investime për mullinjtë e fshatrave, qe janë pronë e bashkisë Fushë Arrëz dhe që janë nënshkruar si inventarë nga Kryepleqtë e fshatrave të

2120103	Mulliri Fshatit Micoj	copë	1	120000
2120104	Mulliri fshat Lumardh	copë	1	60300

Konstatim: - Në llogarinë 212 "*Ndërtime e konstruksione*", Bashkia Fushë Arrëz/ Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave janë kryer kontabilizimet për investimet në zërin*"*Riparim i pjesshëm i pallatit *79*" për 827,780 lekë [7]dhe "Efiçenca e energjisë në pallatin 5-katësh në bashkëpronësi" në vleren 5,514,070 lekë për pjesën e projektit me bashkëfinancim të mbuluar nga të ardhurat e veta , transferta e pakushtëzuar dhe e kushtëzuar" në shumën gjithsej prej **6,341,850 lekë**. *Shpenzimet për investime të kryera për a*ktivet e mësipërme të kontabilizuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", nuk u përkasin aktiveve në posedim të Bashkisë Fushë Arrëz.

Aktive për komunitetin, për aktive qe nuk janë pronë e Bashkisë Fushë Arrëz:

2120115	Riparim i pjesshëm i pallatit 79 (A. shpk), kod projekti 1550087, fatura nr. 9, date 2.11.2021.	Copë	1	827,280
2120103	Efiçenca e energjisë në pallatin 5-katësh në bashkëpronësi	Copë	1	5,514,070

[7] -referuar të dhënave të derguara me observacionin mbi PRA nr 2614 dt .8.2026, prot KLSH mr nr 733/5 dt 13.08.2026

				6,341,850 lekë.

Këto zëra shpenzimesh janë kryer për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilët nëpërmjet programeve/projekteve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie, ndaj rezultoi mbivlerësim i kësaj llogarie <u>për shumën 6,341,850 lekë</u>.
Këto regjistrime nuk plotësojnë kërkesat e pikës 7, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.5 (SKK5) "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale", i përmirësuar, *"Aktivet afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që: (a) përdoren nga njësia ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për t"ua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, dhe (b) priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël".*
Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me paragrafin 7, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.5 (SKK5) i përmirësuar dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.

- Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" më datën 01.01.2025, janë kontabilizuar në vlerën neto 620,250,284 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,884,000 lekë, pakësime 0 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 257,007,413 lekë. Më datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën neto 591,027,569 lekë.

Rrugë, rrjete, vepra ujore	591,027,569	620,250,284

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	846,150,982
	2	Amortizim i akumuluar	225,900,698
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	620,250,284
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	1,884,000
	5	Amortizim i shtesës	
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	
	7	Amortizim nga pakësimet	
	4	Kosto historike	848,034,982
	5	Amortizim i akumuluar	257,007,413
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	591,027,569

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz

Konstatim: ***Aktivet e ujësjellës kanalizimeve, të kontabilizuara në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, ujësjellësa", rezultojnë të pa transferuara tek Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz***
Nga auditimi i regjistrit të aktiveve për llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, ujësjellës", rezultoi së nuk janë transferuar për llogari të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime (SHRUK) Shkodër nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz, mbi **10 zëra aktivesh**, që i përkasin SHRUK Qarku Shkodër sha me koston historike prej **129,509,818** me dt 31.12.2025, që janë pjesë e llogarisë 213, për zërat si më poshtë:

Tabela nr.27, Aktive të pa transferuara për SHRUK Shkodër *(në lekë)*

Llog.	Analiza	EMERTIMI I ASETEVE	Njësia	Sipas të dhënave kontabël			Sipas të dhënave inventarizimit		
				Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Çmimi	Vlera
213	2133100	Rrjeti Brendshëm Ujësjellësi	cope	1	4,747,730	4,747,730	1	4,747,730	4,747,730

213	2133100	Ujësjellësi Shpoz	cope	1	200,000	200,000	1	200,000	200,000
213	2133100	Riparim Ujësjellësi F-Arrëz	cope	1	3,848,897	3,848,897	1	3,848,897	3,848,897
213	2133100	Investim. Rrjeti Ujësjellësit	cope	1	38,222,429	38,222,429	1	38,222,429	38,222,429
213	2133100	Rikonstruksion Linja Ujësjellësit Q.	cope	1	1,000,000	1,000,000	1	1,000,000	1,000,000
213	2133100	Ujësjellësi Morinaj Fushagji	cope	1	19,100	19,100	1	19,100	19,100
213	2133100	Ujësjellësi Fshat Fushe-Arrëz	cope	1	1,058,626	1,058,626	1	1,058,626	1,058,626
213	2133100	Nd. ujësjellësi Palaj,Nushaj	cope	1	1,530,241	1,530,241	1	1,530,241	1,530,241
213	2134100	Ndërtim i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit dhe depove ekzistuese UB 5811	cope	1	74,251,945	74,251,945	1	74,251,945	74,251,945
213	2134100	Investim Ujësjellës lagje Gere Iballe UB6226	cope	1	4,630,850	4,630,850	1	4,630,850	4,630,850
		0	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI PER 213						848,034,982			**848,034,982**

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz

Në inventarin e llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezultojnë **gjithë lisat e** objekteve në vlerën sipas kostos historike 129,509,818 lekë, të cilat janë asete të SHRUK Qarku Shkodër. Nga ana e Drejtorisë se Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në "SHRUKQ Shkodër Sha", në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimi e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" Kreu II, pika 14; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, dhe VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" kreu II pika 14,

14. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat, me vullnet të lirë, lidhin marrëveshje bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, sipas pikës 1, të këtij vendimi, marrin ***masa për transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike të shoqërive aksionare ekzistuese te SKP-ja e krijuar me marrëveshje, në përputhje me legjislacionin në fuqi*** *për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe planin kombëtar të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve për riorganizimin e shoqërive ujësjellës kanalizime. Transferimi i veprimtarisë së parashikuar në këtë pikë bëhet me akt noterial, sipas formatit të parashikuar në lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i cili, pas nënshkrimit nga shoqëritë përkatëse,* ***bëhet pjesë e pasqyrave financiare dhe mbahet nga pala që i ka kaluar transferimi****.*

dhe lidhjes nr.3, të këtij vendimi, që parashikon "Objektin e kontratës"

- **Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"**, në pasqyrat e pozicionit financiar në çelje të vitit 2025 paraqitet në vlerën neto 10,513,212 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 8,657,960 lekë, pakësime në vlerën 0 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 5,434,362 lekë. Llogaria 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune*", më datë 31.12.2025, paraqitet sipas kostos historike në vlerën 24,066,416 lekë dhe në vlerën neto 18,632,054 lekë.

- **Llogaria 215 "Mjete transporti"** në pasqyrat e pozicionit financiar në çelje të vitit 2025 paraqitet në vlerën neto 6,649,390 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 6,185,000 lekë, pakësime në vlerën 0 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 13,930,618 lekë. Më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën neto prej 11,505,217 lekë.

Sipas kostos historike, gjendja e llogarisë 215*"Mjete transporti"* në fillim të vitit 2025 paraqitet me shumën 19,250,835 lekë, gjatë vitit 2025 ka patur ndryshime dhe në fund të periudhës paraqitet në vlerën prej 25,435,835 lekë. Kjo shumë rakordon me inventarin e mjete transporti që disponon Bashkia Fushë Arrëz dhe Regjistrin e Aktiveve ku është e analizuar për çdo mjet. Rezuton se janë kontabilizuar investimet e vitit për këtë kategori aktivesh të cilat janë marrë në dorëzim, si në tabelën e mëposhtme:

Objekti	**Vlera**
Fuoristrade Land Rover Discovery-SALRR2RK3JA064048	3690000
Kamion me vinç Iveco 130 E 23 nr ZCFA1GG0002247791	2495000
Totali:	**6,185,000**

Tabela nr. 28. Analiza e detajuar e llog 215:

Mjete transporti (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Njësia Qafe Mali	980,000			980,000
Njësia Fierze	1,577,000			1,577,000
Njësia Iballe	1,167,285			1,167,285
Njësia Blerim	1,191,475			1,191,475
Njësia Blerim	3,525			3,525
Zjarrfikës Mercedes Benz 2000 litërshe	3,999,990			3,999,990
Furistrade Range Rover	2,520,000			2,520,000
Fouristrade Nisan	960,000			960,000
Blerje Kamioni O. shpk , UB6180	2,988,000			2,988,000
Autobot uji për shërbimin zjarrfikëses	3,863,560			3,863,560
Fuoristrade Land Rover Discovery-SALRR2RK3JA064048		3,690,000		3,690,000
Kamion me vinç Iveco 130 E 23 nr ZCFA1GG0002247791		2,495,000		2,495,000
Totali	19,250,835	6,185,000	0	25,435,835

Burimi i të dhënave: Bashkia Fushë Arrëz

- **Llogaria 218 "Inventar ekonomik" Llogaria 218 "Inventar ekonomik"** në pasqyrat e pozicionit financiar në çelje të vitit 2025 paraqitet në vlerën neto 21,565,894 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 gjendet në vlerën 42,515,517 lekë, vlerë e cila shpreh gjendjen e mbetur pas amortizimit. Analizuar sipas kostos historike, gjendja e llogarisë 218 *"Inventar ekonomik"* ne fillim të vitit 2025 është në shumën 35,375,977 lekë, dhe në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën 42,515,517 lekë, ku shtesat gjatë vitit në këtë llogari janë 7,139,540 lekë. Teprica e llog.218 në fund të vitit është 42,515,517 lekë. Kjo shumë rakordon me inventarin ekonomik që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara.

	Nga Qeveri të Huaja		
	Nga Organizata Ndërkombëtare		

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz PFV, Formati F2.

Në mbështetje të Ligjit nr. 115/2014 "*Për ndarjen administrativo-territoriale të Njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar; Ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore "*, neni 18, 34, 40,41, neni 54/dh, neni 55/ pika 3, neni 64/ germa c, Ligjit 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore",* neni 4, neni 5/ germat a dhe ç, neni 6/germa d, etj; Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, "*Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjit 10296, datë 08/07/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* Udhëzimit të MF nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, i ndryshuar; Ligjit Për buxhetin vjetor, si dhe Akt-rakordimit ndërmjet Bashkisë Fushë Arrëz dhe Degës së Thesarit Pukë për transfertat dhe të ardhurat e trashëguara gjatë vitit 2025 janë krijuar të ardhura dhe janë përdorur gjatë vitit 2025, ku evidentohet dhe pjesa e atyre të ardhurave që trashëgohen për vitin 2026, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i Veprimeve	Shuma në lekë
1	Grante të trashëguara nga 2024 (Kapitull 1)	94,683,190
2	Të ardhura të trashëguara nga 2024 (Kapitull 5)	40,733,417.50
3	Grant i Akorduar për vitin 2025	137,190,608
3/1	Shtesë Granti për 2025	6,607,254.79
3/2	Investime që trashëgohen nga transferta specifike	
4	Te ardhurat e vitit 2025	57,473,856.9
5	Transferta specifike për vitin 2025	125,429,703
5/1	Shtesë Transferta specifike për vitin 2025	3,534,001
	Zbriten:	
-	Shpenzimet faktike Grante (Kapitull 1)	165,005,042
-	Shpenzimet faktike Të ardhura (Kapitull 5)	18,632,845
-	Shpenzimet faktike projekti I UNDP	1,746,500
-	Shpenzimet faktike Transferta specifike	130,897,911
Mbetën për përdorim në vitet pasardhëse		**149,369,733**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, përpunuar nga grupi i KLSH-së.

Sipas tabelës së mësipërme **149,369,733 lekë** do të përdoren gjatë vitit 2026 me vendim përkatës të Këshillit të Bashkisë Fushë Arrëz.

4. Të ardhura të tjera:

- **Të ardhura të tjera** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 0. lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë e pa ndryshuar.

Analiza inventariale e llogarisë 115 "Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime".

Pasqyra e Performancës Financiare (f2), datë 31.12.2025

		31.12.2025	31.12.2024
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	417,146	382,155

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, DZHEFTT

Shpenzimet

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

- **Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve"** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 166,776,161 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është 214,567,812 lekë ose me një rritje në vlerën 47,791,651 lekë.

- Llogaria 601 "Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 28,067,061 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet për 35,863,108 lekë ose me një rritje në vlerën 7,796,047 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Pukë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
600	***Pagat dhe përfitimet e punonjësve***	***214,567,812***	***166,776,161***
6001	Paga, personel i përhershëm	214,167,692	166,654,281
6002	Paga personel i përkohshëm	400,120	121,880
6003	Shpërblime		0
6009	Shpenzime të tjera të personelit		
601	***Kontribute te sigurimeve***	***35,863,108***	***28,067,061***
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	32,182,713	25,222,433
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	3,680,395	2,844,628
Totali			

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, DZHEFTT

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- Llogaria 602 "Blerje mallra dhe shërbime", në datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën 44,836,875 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 46,090,092lekë ose me një rritje në vlerën 1,253,217 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Pukë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 35

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
602	**III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME**	**46,090,092**	**44,836,875**
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	1,305,156	1,335,847
6021	Materiale dhe shërbime speciale	1,881,654	1,955,354
6022	Shërbime nga të tretë	7,209,644	6,373,625
6023	Shpenzime transporti	12,931,556	12,793,070
6024	Shpenzime udhëtimi	2,077,000	2,475,000
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	5,821,760	6,427,815
6026	Shpenzime për qiramarrje		116,000
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale		6,149,464
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua		
6029	Shpenzime të tjera operative	14,863,322	7,210,700

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, DZHEFTT

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Fushë Arrëz nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 "Transferime të brendshme"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 2,992,920 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 88,543,241 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Tabela nr 36.Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
	V. TRANSFERIME KORENTE		
604	**1. Transferime korente të brendshme**	**2,992,920**	**1,240**
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	2,255,520	1,240
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	737,400	
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore		
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse		
606	**3. Transferime për buxhetet familjare e individë**	**88,543,241**	**94,037,081**
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	6,385,236	4,826,196
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendore	82,158,005	89,210,885

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, DZHEFTT

Tabela nr.37 Llogaritë e shpenzimeve Bashkia Fushë Arrëz , në lekë

Njësia	Bashkia + Ndërmarrjet/institucionet e vartësisë Viti 2025							
Art.	Emërtimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	6/5*100
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2024	PBA Plan Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2025	Fakti i 12-mujorit 2025	Diferenca F-P	% e realizimit
600	Paga	166,776	253,124	253,124	255826	213712	42114	83.54
601	Sigurime Shoqërore	28,067	42,505	42,505	43483	35701	7782	82.10
600+60	Paga +Sigurime	194,843	295,629	295,629	299,309	249,413	49,896	83.33
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	44,837	55,437	55,437	70690	46079	24611	65.18
603	Subvencione	0					0	
604	Transferta Korente të Brendshm	723			3122	2691	431	86.19
605	Transferta Korente të Huaja	0					0	
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	93,315	114,827	114,827	99166	88411	10755	89.15
602-606	Shpenzime operative	138,875	170,264	170,264	172,978	137,181	35,797	79.31
Shpenzime Korrente		333,718	402,343	465,893	472,287	386,594	85,693	81.86
230	Kapitale të Patrupëzuara	4,023	3,700	3,700	18999	8419	10580	44.31
231	Kapitale të Trupëzuara	104,961	11,670	11,670	53478	33178	20300	62.04
Totali	**Shpenzime Kapitale**	108,984	15,370	15,370	72,477	41,597	30,880	57.39
Totali (korrente + kapitale)		442,703	481,263	481,263	544,764	428,191	116,573	78.60

Analizuar dipas artikujve të shpenzimeve:

Analiza e realizimit të shpenzimeve sipas artikujve ekonomikë dhe burimeve të financimit:

- **Artikulli 600 "Paga"** është planifikuar në vlerën 255,826 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 213,712 mijë lekë, ose në masën 84%, me një diferencë prej **42,114 mijë lekë** më pak se plani.. Këto shpenzime janë mbuluar nga burimi i financimit I përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 12,155 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 120,640 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 120,004 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 3,027 mijë lekë.
- **Artikulli 601 "Sigurime shoqërore"** është planifikuar në vlerën 43,483 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 35,701 mijë lekë, ose në masën 82%, me një diferencë prej 7,782 mijë lekë më pak se plani. Këto shpenzime janë mbuluar nga burimi i financimit i përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 1,941 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 20,715 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 20,318 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 509 mijë lekë.

- **Artikulli 602 "Mallra dhe shërbime të tjera",** përfshirë fondin rezervë, është planifikuar në vlerën 72,690 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 46,079 mijë lekë ose në masën 63%. Këto shpenzime janë mbuluar nga burimi i financimit i përbërë nga e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 28,112 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 30,448 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 12,347 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 1,784 mijë lekë.
- **Artikulli 603 "Subvencione"** nuk është planifikuar dhe nuk është realizuar gjatë vitit buxhetor.
- **Artikulli 604 "Transferta korente të brendshme"** është planifikuar në vlerën 3,123 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 2,691 mijë lekë, ose në masën 86%, me një diferencë prej 431 mijë lekë më pak se plani. Këto shpenzime janë mbuluar nga burimi i financimit i përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 20 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 320 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 2,783 mijë lekë.
- **Artikulli 606 "Ndihma ekonomike dhe pagesa për invalidët"** është planifikuar në vlerën 97,166 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 88,411 mijë lekë, ose në masën 91% me një diferencë prej 10,755 mijë lekë më pak se plani. Këto shpenzime janë mbuluar nga burimi i financimit i përbërë nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 8,348 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 47 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 88,772 mijë lekë.
- **Artikujt 230–231 "Shpenzime kapitale (investime)"** janë planifikuar në vlerën 72,477 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 41,597 mijë lekë, ose në masën 57%, me një diferencë prej 30,880 mijë lekë më pak se plani. Këto shpenzime janë mbuluar nga burimi i financimit i përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 24,305 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 24,117 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për investimet në vlerën 24,055 mijë lekë.
- **Në total,** shpenzimet e Bashkisë janë planifikuar në vlerën 544,764 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 428,191 mijë lekë, ose në **masën 79%.** Këto shpenzime janë mbuluar nga burimi i financimit i përbërë nga të të ardhurat e veta në vlerën 66,532 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 204,588 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 152,716 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 96,874 mijë lekë; si dhe nga transferta e kushtëzuar për investimet në vlerën 24,055 mijë lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9 pika 1.3 gërma "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore"; UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe VKB përkatëse.

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.
Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Nga verifikimi i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore u konstatua se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje u konstatua se veprimet ishin kontabilizuar saktë.
- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por *nuk është mbajtur një libër si pjesë e dokumentacionit kontabël të mirëfilltë me të gjitha të dhënat historike të aktiveve afatgjata materiale, sipas modelit klasik të trajtuar më lartë,* domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 30.
- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

<u>Mbajtja e regjistrit të aktiveve.</u>

U auditua evidenca kontabël dhe mbajtja e të dhënave lidhur me aktivet afatgjata materiale e jo materiale, si dhe ato afatshkurtra rezultoi se, nga ana e Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatime Taksave ishte hartuar dhe depozituar në dosjen e PFV të v.2025. Në këtë dokument janë regjistruar të dhënat mbi emërtimin e aktivit, njësinë, sasinë, çmimin, vlerën, amortizimin progresiv, amortizimin e vitit 2025, vitin e hyrjes së aktivit, koston fillestare dhe amortizimin

vjetor e progresiv, vlerën e mbetur neto të aktivit me dt. 31.12.2025, si në këtë *screenshot:*

VENTARI KONTABEL Date 31.12.2025
IETET KRYESORE TE TRUPEZUARA (Studime kerkime) Ilogaria 202

r.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera	Amort.Prog.	2025	Amort Total	Vlera neto	Viti
16	Projektim I objektit sistemit	cope	1	350000	350,000	172,988	26,552	199,539	150,461	2020
17	Projekt për Shkollën 9-vjeç	cope	1	745000	745,000	368,216	56,518	424,734	320,266	2020
18	Projekt per hapje rruge aut	cope	1	1827000	1,827,000	902,994	138,601	1,041,595	785,405	2020
19	Projekte tekinike te kaldaja	cope	4	124800	499,200	74,880	63,648	138,528	360,672	2023
20	Plan Menaxhimi pyjore Kry	Cope	1	4022855	4,022,855	0	603,429	603,429	3,419,426	2024
	Projekte tenkike per Ish Fabrika e Fib		1	3967368	3,967,368		0	0	3,967,368	2025
					0		0	0	0	
	TOTALI				28,181,655	9,807,766	2,160,979	11,968,745	16,212,910	

Konstatim:

1*.Regjistri i aktiveve* ***nuk ka*** *përfshirë të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe afatshkurtra (****vlerën e*** **plotë të tokës, pyjeve dhe kullotave, apo llogaritë e pjesëmarrjes në kapital)** dhe *nuk është i plotësuar me sipas kërkesave të Paragrafit nr.30, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:*

Paragrafi 30

"*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia*.

Paragrafi 109

Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/ mbeturina/ materiale të ricikluesshme, *hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë* (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur.

2*.Në regjistrin e aktiveve mungojnë të dhënat mbi vlerën fillestare të aktivit në momentin e blerjes, data e hyrjes në përdorim,*(në disa raste vendosur shënimi vitit 2014 dhe një pjesë nga viti 2016 e 2018, ende të pa kaluara në aktivet afatgjata materiale), si p.sh për zërin nr.2, *"****Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi****",* si më poshtë:

Nr.	Emertimi Objektit	Kod projekti	Garanci 400	Vlera	Nenllog.	Viti
1	Ndërtim I rrjetit të ujësjellësit Krrab-Fushë Arrëz		293,122			
2	Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Mzi	M112613	725,669		2120103	2014
3	Rikonstruksion ujësjellsi Buxhon	M063696	100			

3.Nga kryqëzimi i të dhënave dhe verifikimi i analizave të llog 231 në F1 dhe në Regjistrin e Aktiveve, në fund të v.2025 paraqitet përkatësisht në shumën 50,375,018 lekë dhe 54,826,608 lekë, me një moskuardim prej **-4,451,590 lekë.**

Nr.llog	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
231	Për Aktive Afatgjata materiale	**50,375,018**	84,100,243

INVENTARI KONTABEL Date 31.12.2025
"LISTA E INVESTIMEVE NE PROCES (231)"

Emertimi i objektit	Kod projekti	Garanci 466	Vlera	Nenllog.	Viti
Rikonstruksion cati pallatesh M100399	M100399	176,941.00		2312102	2025
Devijim rruge auto fshati Dardhe, Njesia Blerim	91707AG	49,200.00		604 0009	2025
Ndertim muri mbajtes rruga auto, lagje Shpoz, Degezimi Djathtas	91707AG	24,925.00		604 0009	2025
Ndertim muri mbajtes rruga auto, lagje Shpoz, Degezimi Djathtas	9999999	20,075.00		602 9099	2025
TOTALI:		**12,728,020**	**54,826,608**		

Pra rezultoi një mungesë rakordimi midis llog. 231 "Shpenzime për investimet e AAGJM" në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) dhe Regjistrit të Aktiveve të kësaj Bashkie.

4.Nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin e ***Strategjisë së menaxhimit të pronave publike vendore***, si një dokument që miratohet nga Këshilli i Bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore për një periudhë afatmesme, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr 10296, datë 2010 i ndryshuar; Udhëzimit nr. 30, datë2011, si dhe Kreut II, pika 20, të Udhëzimit të MF nr.35, datë 29.12.2023 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare të NJQV-të"*

<u>Inventarizimi i pronës shtetërore</u>

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, neni 74, parashikojnë se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.
Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet e evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, "*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)"*, Pasqyrën nr. 7/b, "*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)",* kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit dhe kartelat për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.,
Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz z. H.C, me nr.625, datë 28.05.2025, është ngritur komisioni i inventarizimit të vlerave materiale" për vitin 2025, me këtë përbërje:

- Komisioni i Inventarizimit të Bashkisë: zj.D.Gj-kryetar, J.M, A.L, P.M, D.P, A.V dhe D.T, anëtarë
- Afati i kryerjes së procesit të inventarizimit është caktuar 01/06.2026 deri 01.08.2026.

Procesi inventarizimit fizik të aktiveve, ka evidentuar disa mangësi në zbatimin e procedurave të inventarizimit të pasurisë, lidhur me saktësinë dhe rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm.

-Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Arkiv Protokollit nuk disponon të dhëna mbi kryerjen e inventarizimit fizik për Aktivet Afatgjata Materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për: Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar. Nuk i janë nënshtruar inventarizimit zërat "*Ndërtesa" dhe "Rrugë, rrjete e ujësjellës"*, por vetëm janë përfshirë si një zë i vetëm në përmbledhësen e inventarëve të vitit 2025, duke u mjaftuar me nënshkrimet e Kryepleqve të NJA-ve. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se nuk ishte kryer inventarizimi i Aktiveve Afatgjata Jomateriale, *(llogaria 202 "studime e projektime")*, që paraqitet në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare me vlerën 14,406,521 lekë në fillim të vitit 2025 dhe vlere neto 16,212,910 lekë në fund të kësaj periudhe. Nuk është hartuar dhe miratuar urdhri i titullarit të Bashkisë për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Jomateriale.

-Nuk ishte kryer vlerësimi i aktiveve dhe nuk janë vijuar procedurat për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të dëmtuara dhe jashtë funksionit, në kundërshtim me paragrafin 96, të UMF nr 30/2011 i ndryshuar: "*Proçesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Komisioni i vlerësimit ngrihet me miratim të Titullarit. Nëpunësi Autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të proçesit."*

- *Përbërja e komisioneve është e pa ndryshuar nga viti* 2024, veprime këto në kundërshtim me *paragrafin* nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar:

Përbërja e komisioneve të inventarizimit në dy vitet pa ndryshuar, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kapitulli IV, paragrafi 84:

Urdhri nr.169, datë 08.04.2025	***Urdhri nr. 625, datë 28.05.2026***
zj.D.G-kryetar, J.M, A.L, P.M, D.P, A.V dhe D.T, anëtarë	zj.D.G-kryetar, J.M, A.L, P.M, D.P, A.V dhe D.T, anëtarë

- Komisioni i inventarizimit fizik dhe i vlerësimit paraprak të aktiveve ***nuk ka përpiluar proces verbalet për çdo njësi të strukturës e përfshirë në procesin e inventarizimit***, në kundërshtim me pikën 85/a të Udhëzimit nr. 30/2011, por ka hartuar vetëm Relacionin përmbledhës mbështetur mbi shënimet tek kartela kontabël e vënë në dispozicion nga zyra e financës.

Komisioni i inventarizimit ***nuk ishte hartuar raportin përmbledhës***, ne kundërshtim me përcaktimet e paragrafit nr.85/c të UMF nr. 30/2011*: "Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues".*

5.Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të jenë finalizuar me një raport përmbledhës që bëhet objekt miratimi (paragrafi 85/c) dhe ***nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit të lartë (Kryetari i Bashkisë apo Këshilli Bashkiak) mbi rezultatet e inventarizimit.*** *Sa më sipër,* nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 54/e "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" dhe neni 64 "Për detyrat dhe kompetencat e Kryetarit të Bashkisë"; ligjin nr. 68, dt.27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Kreu X, neni 52,

pika nr.2; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 9, dhe neni 11, pika 4", neni 12 pika 3, dhe *paragrafi* nr. 120, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

-Nuk janë përfshirë në regjistrin e aktiveve, ***aktivet të cilat gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital***, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualit MFK*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *"Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike",* Kreu III, paragrafi 28;dhe Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 4/c:

-***Nuk është miratuar "Rregullore për menaxhimin e aktiveve" dhe Strategjia për mbrojtjen dhe menaxhimin e aktiveve"*** në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar
c) miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit; ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave neni 8, "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 8/ç; Manualit të MFK-së*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *"Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike",* Kreu II, pika 17-25; dhe pika 119:Kreu I, Pika 16 "Përgjegjësite e Grupit të Menaxhimit Strategjik".
- Nuk janë kërkuar dhe administruar të dhënat brenda muajit Qershor të vitit 2025, nga shoqëritë tregtare në të cilat Bashkia zotëron kuota apo të drejta si dhe nga shoqëritë koncesionare me të cilat ka kontrata koncesioni, kopje të pasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës si dhe të vendimit të asamblesë se përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare, rezultatit vjetor dhe destinacionin e fitimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualit MFK*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu III, pika 32 dhe 33:
Konkluzion: Gjatë procesit të inventarizimit janë evidentuar aktive afatgjata materiale gjendje faktike, por nuk është vijuar me procedurat përkatëse të vlerësimit dhe trajtimit të mëtejshëm të tyre, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 74. Gjithashtu, procesi i inventarizimit nuk ka përfshirë të gjitha aktivet që përbëjnë pasuri të Bashkisë, duke cenuar integritetin dhe plotësinë e të dhënave kontabël dhe pasurore të institucionit dhe nuk ka vijuar me procedurat e mëtejshme të vlerësimit e të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve. Në kundërshtim me *Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 74 "Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacioni mbështetës".*

Përfundime:

Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin e përgjithshëm të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në Bashkinë Fushë Arrëz sipas kërkesave të legjislacionit mbi menaxhimin e sistemit buxhetor dhe atij financiar e të kontrollit dhe kontabilitetit, etj. ka rezultuar se përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në këtë njësi shpenzuese buxhetore, është realizuar në mbështetje të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara edhe shoqërohen me relacion shpjegues. (*pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës,*

pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare).
Nga auditimi rezultoi se krahas punës së bërë janë konstatuar disa mangësi e parregullsi, të identifikuara në aktin e konstatimit, në lidhje me mos kontabilizimin e detyrimeve të debitorëve familjarë për taksa e tatime vendore, moskontabilizimin e detyrimeve të subjekteve të pajisura me autorizim për tregtim të hidrokarbureve, mungesë e evidentimit të vlerës së truallit, mungesë e rajordimit të disa llogarive me kundrapartitë respektive, risku i parashkrimit të të drejtave për arkëtim nga debitorët; mangësi në hartimin e regjistrit të aktiveve apo procedurave të inventarizimit të pasurisë, etj., që duhet të jenë në vëmendjen e strukturave menaxheriale të institucionit për përmirësimet e nevojshme në të ardhmen.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z.H.C. Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z.D.L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatime-Taksave në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, rezultoi se në Bashkinë Fushë Arrëz sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit vlerësohet ***pjesërisht efektiv***, për shkak të mangësive të konstatuara në dokumentimin, formalizimin dhe zbatimin e plotë të kërkesave të kuadrit rregullator për MFK-në. Më konkretisht:
- Nuk ishte hartuar dhe miratuar Plani i Përgjithshëm Strategjik i Zhvillimit me afat 5-vjeçar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 32 të Ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, si dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.4.1, pika 2.3 dhe Kreu IV, Aneksi 1.
- Nuk ishte ngritur Grupin e Menaxhimit të Risqeve. Gjithashtu, megjithëse ishte hartuar dhe miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut dhe Regjistri i Riskut, këto dokumente nuk rezultojnë të protokolluara, duke cenuar gjurmën administrative dhe dokumentimin zyrtar të procesit të menaxhimit të riskut në institucion, veprime në kundërshtim me nenin 16, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, si dhe kërkesat e UFM nr. 16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike*".
- Nuk ishte hartuar dhe miratuar rregullorja e brendshme për procedurën e shqyrtimit dhe hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, veprime në kundërshtim me nenin 13, pika 10, të Ligjit nr. 60/2016 "*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*", me kërkesat e nenit 8, pika 8, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, dhe Kreut 3.3 "Aktivitetet e Kontrollit", pika 3.3.1, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
-Në Bashkinë Fushë-Arrëz, për mbajtjen dhe administrimin e të dhënave kontabël, përdoret programi Microsoft Excel dhe jo një sistem i dedikuar kontabiliteti. Sektori i Taksave dhe Tatimeve Vendore nuk disponon një sistem informatik të posaçëm për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por kryen regjistrimin dhe përpunimin e të dhënave në Microsoft Excel. Mungesa e sistemeve të përshtatshme të informatizuara dhe përdorimi i procedurave manuale rrit riskun e gabimeve në regjistrimin dhe përpunimin e të dhënave, si dhe riskun e ndryshimit ose manipulimit të paautorizuar të informacionit. Gjithashtu, nuk rezultoi të jetë ngritur një sistem i

përshtatshëm IT për ruajtjen dhe rikuperimin e të dhënave, përfshirë procedurat e dokumentuara për kryerjen e kopjeve rezervë *(back-up).* Mungojnë rregullat dhe procedurat e brendshme të shkruara për sigurinë e sistemeve IT dhe mbrojtjen e të dhënave, si dhe nuk disponohet një manual i miratuar për sigurinë e teknologjisë së informacionit. Këto mangësi dobësojnë mjedisin e kontrollit mbi sistemet e informacionit dhe rrisin riskun e humbjes, dëmtimit ose aksesimit të paautorizuar të të dhënave.

- Nga auditimi i dosjeve të personelit rezultoi se, gjatë vitit 2025, nuk ishin kryer në afatet e përcaktuara vlerësimet periodike 6-mujore të nëpunësve, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit për nëpunësin civil. Gjithashtu, dosjet e personelit paraqesin mangësi në dokumentacionin përbërës, pasi nuk përmbajnë dokumente të detyrueshme, si fleta prezantuese, fleta e inventarit të dosjes dhe libreza e punës.

Sa më sipër, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 16, datë 31.12.2024 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimit të MFK dhe funksionimin e GMR në njësitë publike*"; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 4, datë 26.1.2024; UMF nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu 2.2 pika nr. 6, Kreu I dhe 28 dhe Kreu III; Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, "*Për vlerësimin e rezultateve në punë*", si dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe Lidhjen 1 të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit". (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqe 14-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për përmirësimin e funksionimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nëpërmjet:

- hartimit dhe miratimit të Planit të Përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit me afat 5-vjeçar;
- ngritjes dhe funksionimit të Grupit të Menaxhimit të Risqeve, si dhe formalizimit dhe protokollimit të dokumentacionit të menaxhimit të riskut;
- hartimit dhe miratimit të rregullores së brendshme për procedurën e shqyrtimit dhe hetimit administrativ të sinjalizimeve dhe mbrojtjen e konfidencialitetit;
- përmirësimit të sistemeve të informatizuara për administrimin e të dhënave kontabël, taksave dhe tarifave vendore, si dhe vendosjes së procedurave të dokumentuara për sigurinë e informacionit, ruajtjen dhe rikuperimin e të dhënave dhe kryerjen e kopjeve rezervë;
- sigurimit të kryerjes në afat të vlerësimeve periodike të punonjësve dhe plotësimit e administrimit të dosjeve të personelit sipas kërkesave ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Fushë Arrëz u konstatua se:

-Nuk janë përfshirë në veprimtarinë e auditimit të brendshëm fushat dhe nënsistemet e vlerësuara me nivel të lartë risku, konkretisht "Prokurimet Publike", "Procedurat për dhënien e lejeve të zhvillimit, ndërtimit dhe përdorimit", si dhe "Përputhshmëria ligjore në planifikimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit", ndonëse këto fusha bëjnë pjesë në universin e auditimit të brendshëm, në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit III, pikat 3.1.2 dhe 3.1.3, të Manualit të Auditimit të

Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, *(i shfuqizuar, në fuqi në periudhën objekt auditimi).*
- Audituesit e brendshëm nuk kishin përditësuar dosjet e përhershme të auditimit, në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VI, pika 6.3, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016.
-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me nenin 12, pika b, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar dhe VKM nr. 160, datë 02.03.2016, "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike", kreu I.
- Audituesit e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë nuk kanë përmbushur, për vitet 2024–2025, detyrimin për zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme profesionale në masën 80 orë në dy vjet, në kundërshtim me nenin 20 pika 2, të Ligjit nr. 114/2015, *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",* i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqe 14-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, në bashkëpunim me drejtuesin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit; plotësimin e kërkesave të trajnimit profesional të audituesve; hartimin dhe realizimin e planeve vjetore mbi bazën e riskut dhe kapaciteteve reale, duke siguruar mbulimin e fushave me risk të lartë; si dhe ngritjen e një sistemi të dokumentuar për monitorimin dhe raportimin periodik të zbatimit të rekomandimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se buxheti vjetor fillestar për vitin 2025, i miratuar nga Këshilli Bashkiak, në vlerën 481,263 mijë lekë, u rishikua gjatë vitit në shumën 544,764 mijë lekë, me një rritje prej 63,501 mijë lekë, ose rreth 13.2%, krahasuar me planin fillestar. Në fund të vitit 2025, realizimi faktik i buxhetit rezultoi në vlerën 428,191 mijë lekë. Nga sa më sipër, u evidentuan diferenca të konsiderueshme ndërmjet planifikimit fillestar, buxhetit të rishikuar dhe realizimit faktik. Niveli i realizimit të buxhetit rezultoi 88% ndaj planit fillestar dhe 79% ndaj buxhetit të rishikuar, duke sjellë mosrealizim në vlerën 53,072 mijë lekë kundrejt planit fillestar dhe 116,573 mijë lekë kundrejt buxhetit të rishikuar.
Gjithashtu, nga analiza e realizimit të shpenzimeve sipas zërave buxhetorë, bazuar në të dhënat mbi realizimin e shpenzimeve për vitin 2025, rezultoi se realizimi i përgjithshëm prej rreth 79% nuk pasqyron diferencat e konsiderueshme ndërmjet kategorive të shpenzimeve.
Në mënyrë të veçantë, rezultoi se:
- shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 41,597 mijë lekë nga 72,477 mijë lekë, ose rreth 57%;
- mallrat dhe shërbimet janë realizuar në masën 46,079 mijë lekë nga 70,690 mijë lekë, ose rreth 65%;
- pagat dhe sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 249,413 mijë lekë nga 299,309 mijë lekë, ose rreth 83%;
Niveli i ulët i realizimit të shpenzimeve kapitale lidhet me mosrealizimin e plotë të programit të investimeve, për shkak të vonesave në procedurat e prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratave, si dhe në disa raste të mosplotësimit në kohë të kushteve teknike dhe administrative për realizimin e investimeve. Ndërkohë, realizimi i ulët i mallrave dhe shërbimeve tregon për mosshfrytëzim të plotë të fondeve të planifikuara për shërbimet dhe funksionimin e njësisë vendore.

Këto mangësi kanë ndikuar në shtyrjen ose mosrealizimin në kohë të investimeve të planifikuara, në përmirësimin e infrastrukturës dhe aseteve publike, si dhe në ofrimin e shërbimeve publike në nivelin dhe afatin e planifikuar, duke ulur efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore.
Këto rezultate evidentojnë mangësi në procesin e planifikimit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9936/2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nenet 15, 19, 23 dhe 32-33; Ligjit nr. 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 9; Ligjit nr. 68/2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", nenet 2 dhe 3; si dhe me përcaktimet e UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar (nenet 79-81); Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "*Për monitorimin e buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore",* si dhe akteve përkatëse të Këshillit Bashkiak.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 27-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për financat dhe buxhetin, të marrë masa për përmirësimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit të realizimit të buxhetit, duke analizuar periodikisht shkaqet e mosrealizimit të shpenzimeve sipas zërave, veçanërisht të shpenzimeve kapitale dhe të mallrave e shërbimeve. Strukturat përgjegjëse të përcaktojnë masa dhe afate konkrete për përshpejtimin e procedurave të prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratave, si dhe për përmbushjen në kohë të kërkesave teknike dhe administrative, me qëllim realizimin e investimeve dhe shpenzimeve të planifikuara dhe përmirësimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike dhe të ofrimit të shërbimeve ndaj komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave për vitin 2025 u konstatua se planifikimi nuk është bazuar në kapacitetet reale të gjenerimit të të ardhurave, si dhe mungojnë dokumentet e analizat që argumentojnë metodologjinë dhe bazën e përllogaritjes së parashikimeve për secilën taksë dhe tarifë vendore.

- *Për vitin 2024,* planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 28,555 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 45,553 mijë lekë referuar Akt-Rakordimit me Degën e Thesarit ose në masën 159.5%, me një mbirealizim ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 16,998 mije lekë.
- *Për vitin 2025,* planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 28,555 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 57,474 mijë lekë referuar Akt-Rakordimit me Degën e Thesarit ose në masën 201%, me një mbirealizim ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 28,919 mije lekë.

Në këtë mënyrë, ***planifikimi i të ardhurave për vitin 2025 është bazuar në të njëjtën vlerë me atë të vitit 2024,*** pavarësisht se gjatë vitit 2024 realizimi i të ardhurave është me tejkalim kundrejt planit me 16,998 mijë lekë**.** Sa më sipër, në hartimin e buxhetit për vitin 2025 nuk ishin marrë në konsideratë rezultatet faktike të vitit paraardhës dhe as trendi i arkëtimeve, duke sjellë një planifikim jo real dhe jo të bazuar në kapacitetet reale të gjenerimit të të ardhurave për secilin zë të tyre, ku u konstatua se një pjesë e tyre ishin realizuar ndjeshëm mbi plan, ndërsa një pjesë tjetër kishin rezultuar me mosrealizim të konsiderueshëm.
Për rrjedhojë, planifikimi i të ardhurave nuk është mbështetur në analiza të mirëfillta të performancës historike dhe potencialit real të arkëtimit për secilin zë fiskal, e cila reflektohet në diferenca të konsiderueshme ndërmjet planifikimit dhe realizimit, si në drejtim të mbirealizimit, ashtu edhe të mosrealizimit të disa zërave të të ardhurave. Veprimet e mësipërme janë në

kundërshtim me n**enin 4, shkronja "a", dhe nenin 24,** të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave*" Kreu IV, pika 200. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave dhe Sektori i Tatim Taksave, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë Fushë Arrëz, të marrë masa që planifikimi i të ardhurave vendore të bazohet në analiza të dokumentuara të potencialit fiskal, realizimit historik, ndryshimeve në bazën tatimore dhe faktorëve që ndikojnë në arkëtim. Për çdo zë të ardhurash të kryhen parashikime të argumentuara, duke marrë në konsideratë realizimin e vitit paraardhës dhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura, me qëllim rritjen e saktësisë së planifikimit dhe paraqitjen reale të performancës së të ardhurave.

Menjëherë dhe në vijim

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave rezultoi se, gjatë vitit 2025, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Taksave, Sektori i Taksave, i Bashkisë Fushë-Arrëz, si dhe agjentët tatimorë (DRT, DSHTRR, ASHK dhe Dogana), nuk kanë kryer akt-rakordime mujore për verifikimin dhe rakordimin e të ardhurave të administruara dhe të arkëtuara. Përjashtim nga sa më sipër përbën vetëm akt-rakordimi i mbajtur me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, lidhur me të ardhurat nga renta minerare, në fund të vitit 2025, sipas shkresës nr. 3790 prot., datë 02.12.2025.

Për sa i takon të ardhurave nga taksat dhe tarifat tatimore të arkëtuara nëpërmjet agjentëve tatimorë, Bashkia Fushë-Arrëz u referohet vetëm vlerave të arkëtuara nga agjentët tatimorë, të evidentuara nga Dega e Thesarit. Nga auditimi rezultoi se Bashkia nuk disponon një bazë të dhënash që të evidentojë detyrimin total për t'u arkëtuar nga secili agjent tatimor, vlerat e arkëtuara dhe detyrimet e paarkëtuara. Gjithashtu, nuk janë evidentuar në mënyrë të përmbledhur diferencat e paarkëtuara sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë. Në kushtet e mësipërme, Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka zbatuar procedurat përkatëse për marrjen e masave ndaj agjentëve tatimorë për mosrealizimin e detyrimeve të arkëtueshme, përfshirë aplikimin e gjobës në masën 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura ose të shmangura, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 7 dhe 117, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, *"Për taksat kombëtare". (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 37-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave dhe Sektori i Tatim Taksave të Bashkisë Fushë-Arrëz të marrin masa për kryerjen dhe dokumentimin e rakordimeve periodike dhe vjetore me agjentët tatimorë, sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, me qëllim evidentimin e saktë të detyrimeve dhe sigurimin e arkëtimit të plotë të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Në vijim, të evidentohen dhe analizohen diferencat sipas llojit të taksës/tarifës, të përcaktohen detyrimet e paarkëtuara që përbëjnë mungesë të të ardhurave për buxhetin e Bashkisë dhe, sipas rastit, të ndërmerren masat administrative ndaj agjentëve tatimorë përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Tatim-Taksave në Bashkinë Fushë-Arrëz, u konstatua se ***nuk administron regjistra fizikë për abonentët familjarë***, si rrjedhojë nuk disponohet informacion i plotë dhe i dokumentuar mbi ngarkesat fiskale, pagesat e kryera dhe periudhat të cilave u përkasin këto pagesa. Gjithashtu, për këtë kategori abonentësh nuk janë caktuar agjentë tatimorë për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, duke ndikuar negativisht në administrimin, monitorimin dhe ndjekjen e detyrimeve fiskale.

Në kushtet e mungesës së informacionit mbi detyrimet e përllogaritura sipas tarifave të miratuara në paketën fiskale për vitin 2025, për kategorinë e abonentëve familjarë, nuk është e mundur të përcaktohet vlera e saktë e detyrimeve progresive të kësaj kategorie në fund të vitit 2025.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 4, pika 7, si dhe nenin 5, shkronja "ç", nënndarjet "ii" dhe "iv", nenet 20-22; dhe Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 15; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore". *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqe 37-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave, si dhe me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës me qëllim evidentimin dhe identifikimin e plotë të abonentëve familjarë subjekt i detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore. Gjithashtu, të merren masa për krijimin dhe administrimin e një regjistri të plotë e të përditësuar për këtë kategori abonentësh, i cili të shërbejë si bazë për përcaktimin e saktë të detyrimeve fiskale dhe hartimin e parashikimeve të qëndrueshme e të arsyetuara të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

Menjëherë

6.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz të marrë masa për lidhjen e aktmarrëveshjes me agjentin për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të abonentëve familjarë, në përputhje me vendimin e Këshillit Bashkiak dhe kërkesat e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) rezultoi se gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" është rritur nga 298,885,945 lekë në fillim të vitit, në 302,275,408 lekë në fund të vitit 2025, duke shënuar një rritje prej 3,389,463 lekë, ose 1.13%. Gjatë vitit ushtrimor 2025 janë regjistruar shtesa në llogari në shumën 5,283,711 lekë, ndërsa pakësimet (arkëtimet dhe sistemimet kontabël) janë 1,894,248 lekë, duke evidentuar një nivel të ulët arkëtimi të të drejtave të konstatuara dhe nivele të larta të debitorëve në fund të vitit, ku peshën kryesore e zënë detyrimet tatimore dhe ato nga rezultatet e auditimeve të mëparshme.

Në datën 31.12.2025, debitorët paraqiten në vlerën 302,275,408 lekë, duke përbërë **59.96%** të aktiveve afatshkurtra dhe **17.71**% të totalit të aktiveve të Bashkisë. Ky problem mbi nivelin e lartë të detyrimeve debitorë *(të drejtat për arkëtim)* është trajtuar edhe në raportet e mëparshëm të auditimit të KLSH-së, ku është rekomanduar për gjetjen e origjinës nga ka lindur detyrimi, arkëtimin e këtyre vlerave, deri në ngritjen e padive gjyqësore, por mungojnë veprimet korrigjuese për sa më sipër. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 12, të **Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar**; neni 42 pika 1-5 të Ligjit nr.67/2017, datë 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, etj. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3, faqe 41-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave dhe strukturave përgjegjëse për administrimin e të ardhurave vendore, të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e një plani veprimi për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve debitore të trashëguara dhe të krijuara rishtazi, duke i analizuar debitorët e regjistruar në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* sipas origjinës, vjetërsisë dhe natyrës së detyrimit, si dhe duke përcaktuar përgjegjësitë dhe afatet për arkëtimin e tyre. Për detyrimet e paarkëtuara brenda afateve të përcaktuara, të ndërmerren procedurat administrative dhe ligjore përkatëse, përfshirë ndjekjen gjyqësore, kur është e nevojshme, dhe të sigurohet përditësimi e sistemimi periodik i të dhënave kontabël, me synim reduktimin e stokut të debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për përgatitjen dhe paraqitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2025, rezultoi se gjatë vitit shpenzimet janë regjistruar në klasën 6, në kundërparti me llogaritë e detyrimeve. Në mbyllje të vitit ushtrimor, teprica debitore e ***llogarisë 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"*** nuk është transferuar në llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti", sipas skemës përkatëse të kontabilizimit. Në këto kushte, në datën 31.12.2025, llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" paraqitet me tepricë debitore në shumën 28,001,087 lekë, ndërsa llogaria 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" paraqitet me tepricë zero. Për rrjedhojë, gjendjet e këtyre llogarive, në fund të periudhës ushtrimore, nuk janë rakorduar sipas skemës përkatëse të kontabilizimit, duke mos reflektuar në mënyrë të plotë lidhjen kontabël ndërmjet të drejtave të konstatuara të Bashkisë ndaj shtetit dhe financimit të pritshëm nga buxheti. *Sa më sipër,* veprimet kontabël nuk janë në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu III, pika 3.1, paragrafët 32 dhe 59, si dhe Aneksi nr. 1, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d" të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022.

- Nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2025 dhe i regjistrimeve kontabël rezultoi se ***llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"*** paraqitet në datën 31.12.2025 me tepricë 0 lekë, e njëjtë me vitin 2024, ndërkohë që llogaritë 411 dhe 468 paraqesin vlera të konsiderueshme të të drejtave për arkëtim, përkatësisht 298,885,945 lekë në fund të vitit 2024 dhe **302,275,408 lekë** në fund të vitit 2025. Këto vlera përfshijnë, ndër të tjera, detyrime të karakterit tatimor dhe shuma të evidentuara si rezultat i rekomandimeve të auditimeve të mëparshme. Për rrjedhojë, nuk është siguruar evidentimi dhe rakordimi i pjesës së detyrimeve ndaj shtetit që rrjedhin nga të ardhurat e konstatuara dhe të paarkëtuara, sipas natyrës dhe pjesës përkatëse që i takon buxhetit. *Sa më sipër,* nuk është siguruar pasqyrimi dhe rakordimi i saktë i marrëdhënieve me shtetin në llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)", në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu I, pika 48, lidhur me rakordimin e llogarive përpara përgatitjes së pasqyrave financiare, si dhe Kreu III, pika 3.2 dhe Aneksi nr. 1, lidhur me funksionimin e llogarisë 4341.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3, faqe 41-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave të marrë masa që të kryejë analizimin, sistemimin dhe rakordimin e tepricave të llogarive 4341 "Operacione me shtetin (Detyrime)" dhe 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)", me qëllim eliminimin e mospërputhjeve ndërmjet të dhënave të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare, si dhe sigurimin e klasifikimit dhe paraqitjes së tyre në përputhje me kërkesat e kuadrit normativ në fuqi.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* rezultoi se, gjendja kontabël në datën 01.01.2025 është 5,948,353 lekë, gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime dhe gjendja kontabël e kësaj llogarie më datë 31.12.2025, paraqitet në të njëjtën vlerë, detajuar sipas NJ-ve të Bashkisë.
Nga auditimi u konstatua se, sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 Bashkisë Fushë Arrëz i kanë kaluar 3,571 zëra të listës së inventarit të pronave "*Pyje dhe kullota*" që transferohen për Bashkinë Fushë Arrëz, të cilat nuk janë inventarizuar dhe kontabilizuar në librat e kontabilitetit të kësaj Bashkie. Si rrjedhojë, kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara me VKM nr. 433, dt. 08.06.2016, pika 3, shtojca nr.1, e cila përmban listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz.
Në zbatim të këtyre akteve, u konstatua se janë kryer procedurat për regjistrimin e pasurive të transferuara në pronësi të Bashkisë Fushë-Arrëz nga Ministria e Mjedisit pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Si rezultat, janë çelur kartelat e pasurive të paluajtshme për **3,217** pasuri pyje dhe kullota, të regjistruara në emër të Bashkisë Fushë-Arrëz.
Megjithatë, Bashkia Fushë-Arrëz nuk disponon certifikatat e pronësisë, kopjet e kartelave dhe hartat treguese për këto pasuri, pasi tërheqja e tyre nga ASHK kryhet kundrejt pagesës së tarifave përkatëse. Për shkak të kostove të konsiderueshme financiare dhe kufizimeve buxhetore, Bashkia Fushë-Arrëz është shprehur se e ka objektivisht të pamundur të sigurojë dokumentacionin e plotë të pronësisë për të gjitha pasuritë e regjistruara, megjithëse ato rezultojnë të regjistruara në emër të saj në regjistrat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
- *Sa më sipër,* kjo llogari nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara në pronësi të kësaj Bashkie sipas VKM-ve respektive, transferuar në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz.
Këto veprime janë në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, me pikën 1 dhe 2, kreu VI të VKM nr. 510, datë 14.08.2001, *"Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme"*, Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001,*"Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"*, si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i* ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3, faqe 41-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për administrimin e pronave dhe menaxhimin e fondit pyjor e kullosor, të marrë masa për evidentimin, inventarizimin, vlerësimin dhe pasqyrimin e plotë e të saktë në llogarinë 211 "*Pyje, kullota, plantacione*" të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të transferuara në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz, mbi bazën e dokumentacionit dhe të dhënave të disponueshme. Për pasuritë e regjistruara pranë ASHK-së, për të cilat Bashkia nuk disponon dokumentacionin përkatës për shkak të kostove të tërheqjes së tij, të planifikohet sigurimi gradual i këtij dokumentacioni, në varësi të mundësive financiare të Bashkisë.

Menjëherë e në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" rezultoi se Bashkia Fushë-Arrëz ka regjistruar gjatë vitit 2025 shumën **6,341,850 lekë**, që përfaqëson pjesën

e financuar prej saj për punimet "*Riparim i pjesshëm i pallatit 79"* dhe *"Efiçenca e energjisë në pallatin 5-katësh në bashkëpronësi".*
Sipas dokumentacionit të verifikuar, ndërtesat ku janë kryer punimet nuk janë aktive në pronësi ose nën kontrollin e Bashkisë. Bashkëfinancimi i këtyre punimeve nuk i ka krijuar Bashkisë një aktiv që plotëson kushtet për t'u njohur në llogarinë 212. Për rrjedhojë, shtesat e regjistruara në këtë llogari janë mbivlerësuar me 6,341,850 lekë.
Veprimet janë në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, kreu II, pika 5 dhe kreu III, pikat 30 dhe 36, si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3, faqe 41-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave e Bashkisë Fushë-Arrëz të marrë masa për rishikimin e trajtimit kontabël të aktiveve të regjistruara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", të cilat nuk janë në pronësi apo posedim të Bashkisë, por përfaqësojnë investime në favor të komunitetit. Për këtë qëllim, të kryhet çregjistrimi i shumës **6,341,850 lekë** nga llogaria 212 dhe sistemimi i saj sipas trajtimit kontabël për grantet kapitale për pjesëmarrje në investime për të tretë, në përputhje me kuadrin nënligjor të kontabilitetit të sektorit publik.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

10.2. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave e Bashkisë Fushë Arrëz, për projektet që do të zbatohen në kuadër të programeve sociale, të sigurojë klasifikimin e drejtë të shpenzimeve në përputhje me natyrën e tyre ekonomike, duke i njohur ato si shpenzime/ transferta dhe jo si aktive afatgjata, kjo në koordinim me Ministrinë përgjegjëse për financat. Ky trajtim kontabël synon të garantojë paraqitjen e drejtë dhe të besueshme të pasqyrave financiare, të shmangë mbivlerësimin e aktiveve dhe të sigurojë përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezultoi se në fund të vitit 2025 vijojnë të jenë të regjistruara në kontabilitetin e Bashkisë Fushë-Arrëz mbi 10 zëra aktivesh me kosto historike prej **129,509,818 lekë**, të cilat i përkasin Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime (SHRUK) Shkodër sh.a. dhe nuk janë transferuar në administrim të kësaj shoqërie. Sa më sipër, nuk është kryer transferimi i aktiveve sipas përcaktimeve të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "*Për politikat kombëtare për riorganizimi e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura"*, Kreu II, pika 14; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3, faqe 41-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.1.Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz në bashkëpunim me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sha, të marrin masa për transferimin në mënyrë të dokumentuar të aktiveve sipas vlerës kontabël, ku vlera e regjistruar është **129,509,818 lekë** dhe pasi Shoqëria Ujësjellës

Kanalizime Shkodër Sh.a të ketë marrë në dorëzim këto aktive, Bashkia Fushë Arrëz të pasqyrojë në kontabilitet efektet e këtij transferimi.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të llogarisë 466 "*Kreditorë për mjetet në ruajtje",* rezultoi se për 46 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Fushë Arrëz janë ngurtësuar fonde në vlerën në shumën 12,728,020 lekë. Deri në momentin e kryerjes së auditimit nuk është bërë çlirimi i garancive për 34 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Fushë Arrëz në vlerën **7,093,884 lekë** për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës**.** nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Pukë. Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatime Taksave, si dhe Drejtoria e Urbanistikës, Kontrollit të Territorit dhe Emergjencave, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me Subjektet Sipërmarrëse.
Këto veprime/mosveprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit",* i ndryshuar, Kapitulli II, pikat 6 dhe 10, si dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",* i ndryshuar, Kapitulli III, pika 3.3, pikat 29, 30, me kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në kontratat përkatëse, si dhe me rregullat e zbatueshme për marrjen në dorëzim të punimeve dhe periudhën e garancisë.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3, faqe 41-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatime Taksave, si dhe Drejtoria e Urbanistikës dhe Kontrollit të Territorit në koordinim me strukturat përgjegjëse në Bashkinë Fushë Arrëz të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme që për punimet e përfunduara dhe të marra në dorëzim konformë përcaktimeve në kontratës, të bëjnë njoftimet e subjekteve për tërheqjen e garancive të punimeve. Në rast mos plotësimi të kushteve ose refuzimit nga subjektet në zbatim të dispozitave ligjore të bashkëpunohet me Degën e Thesarit për kalimin e këtyre fondeve në favor të autoritetit kontraktor, si e ardhur për mospërmbushje të rregullt të kushteve të kontratës.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin dhe administrimin e evidencës kontabël të aktiveve rezultoi se Bashkia Fushë Arrëz nuk disponon një regjistër të konsoliduar të aktiveve, ndërsa Regjistri i Aktiveve për vitin 2025 nuk përfshin të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale, aktiveve afatgjata jomateriale, pjesëmarrjet në kapital dhe aktivet afatshkurtra. Regjistri elektronik i mbajtur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatime Taksave, nuk është i plotësuar me elementët e detyrueshëm të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, pasi mungojnë të dhëna mbi vlerën fillestare të aktivit, datën e hyrjes në përdorim, shpenzimet kapitale që rrisin vlerën e aktivit dhe datën e kryerjes së tyre, vendndodhjen, personin përgjegjës, datën e daljes nga përdorimi dhe elementë të tjerë identifikues.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: nenin 16, 19 dhe 22 të Ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar dhe Manualin e MFK-së, Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6, Kreu III, paragrafi 28, Kreu I, paragrafi

4/c, Kreun II, Paragrafi III, pika 26, 27, 28 dhe Paragrafi IV pika 81. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3, faqe 41-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të Bashkisë Fushë-Arrëz të marrin masa për përmirësimin dhe përditësimin e Regjistrit të Aktiveve, në formë analitike, duke siguruar evidentimin e plotë të të dhënave për çdo aktiv, përfshirë datën e hyrjes dhe daljes në përdorim, vlerën fillestare dhe shpenzimet kapitale, vendndodhjen, personin përgjegjës, amortizimin e akumuluar dhe informacionin mbi mirëmbajtjen. Regjistri të pasqyrojë aktivet afatgjata dhe afatshkurtra materiale e monetare, duke bërë dallimin ndërmjet aktiveve në pronësi, pjesëmarrje dhe atyre nën administrimin e Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për inventarizimin e pasurisë për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve si dhe përdorimin në mënyrën e duhur e më eficiencë të tyre, janë konstatuar disa mangësi në lidhje me zbatimin e proceseve dhe procedurave të inventarizimit të pasurisë, rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm. *Konkretisht,*

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatime Taksave nuk disponon të dhëna mbi kryerjen e inventarizimit fizik për Aktivet Afatgjata Materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për kategorinë: Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, rrugë, rrjete e vepra ujore, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se nuk është kryer inventarizimi i Aktiveve Afatgjata Jomateriale, *(llogaria 202 "studime e projektime"),* që paraqitet në kontabilitet me vlerën neto 16,212,910 lekë në fund të kësaj periudhe. Nuk është hartuar dhe miratuar urdhri i titullarit të Bashkisë për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Jomateriale.
- Nuk është kryer vlerësimi i aktiveve dhe nuk janë vijuar procedurat për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të dëmtuara dhe jashtë funksionit, në kundërshtim me paragrafin 96, të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.
- Përbërja e komisioneve është e pa ndryshuar nga viti 2024, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Kapitullin IV, paragrafi nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar:
- Komisioni i inventarizimit fizik dhe i vlerësimit paraprak të aktiveve nuk ka përpiluar proces verbalet për çdo njësi të strukturës e përfshirë në procesin e inventarizimit, në kundërshtim me pikën 85/a të Udhëzimit nr. 30/2011, i ndryshuar.
- Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të jenë finalizuar me një raport përmbledhës që bëhet objekt miratimi (në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar) dhe nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit të lartë (Kryetari i Bashkisë apo Këshilli Bashkiak) mbi rezultatet e inventarizimit.

Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Ligjit nr.139/2015, *"Për Vetëqeverisjen Vendore",* neni 54/e "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" dhe neni 64 "Për detyrat dhe kompetencat e Kryetarit të Bashkisë"; Ligjin nr. 68, dt.27.04.2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore",* Kreu X, neni 52, pika nr.2; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",* i ndryshuar, neni 9, dhe neni 11, pika 4", neni 12 pika 3, dhe *paragrafi* nr. 120, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3, faqe 41-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Materiale dhe Jomateriale, i cili të verifikojë dhe të rakordojë rezultatet e inventarizimit me llogaritë kontabël përkatëse për gjithë zërat e aktiveve dhe në përfundim të punës komisioni të hartojë raportin për drejtuesin e institucionit mbi rezultatet e inventarizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Pronave Publike Vendore dhe të Rregullores për Miradministrimin e Aktiveve, si një dokument që miratohet nga Këshilli i Bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore për një periudhë afatmesme, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika 8/ç; Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar; Kreun IV, të Manualit të MFK-së miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.4, datë 26.1.2024*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *dhe* Kreu II, pika 17-25. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3, faqe 41-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatime Taksave të marrë masat për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Pronave Publike Vendore dhe të Rregullores për Menaxhimin e Aktiveve, si dokumente bazë për administrimin, mbrojtjen, inventarizimin, vlerësimin dhe përdorimin me efektivitet të aktiveve publike të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Këto dokumente të miratohen nga Këshilli i Bashkisë Fushë Arrëz në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e nënligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin, me qëllim forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe garantimin e një menaxhimi efektiv, ekonomik dhe transparent të aktiveve vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se deri më 31.12.2024, detyrimet tatimore të papaguara për kategorinë e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe institucioneve shtetërore rezultojnë në vlerën 27,064,571 lekë.

Pagesat e kryera gjatë vitit 2025 për taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorive *"biznes i vogël", "biznes i madh" dhe "institucione shtetërore"*, rezultuan në shumën totale 1,111,731 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesave rezultoi se nuk u përcaktohet periudha tatimore së cilës i përkasin këto pagesa, duke mos mundësuar identifikimin dhe rakordimin e tyre sipas periudhës përkatëse.

Nga auditimi rezultoi se, në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2025, për kategoritë "biznes i vogël", "biznes i madh" dhe "institucione shtetërore" paraqiten në shumën **30,041,125 lekë**. Kjo shumë rezulton nga detyrimet e mbartura në datën 31.12.2024, në vlerën 27,064,571 lekë, të shtuara me debinë e krijuar gjatë vitit 2025, dhe të pakësuara me pagesat e kryera gjatë vitit, në shumën 1,111,731 lekë. Detyrimi tatimor i konstatuar është pasqyruar në kontabilitet.

- Nga verifikimi i të dhënave ndërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave dhe Sektorit të Taksave e Tatimeve Vendore rezultoi se detyrimet në shumën **3,950,000 lekë**, që lidhen kategorinë subjekte familjare në periudhën 2015–2024, **nuk janë evidentuar në kontabilitet**, kjo dhe për shkak të mungesës së rakordimeve periodike dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet strukturave përgjegjëse.
- Auditimi evidentoi se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Fushë-Arrëz për subjektet që vijojnë të mos shlyejnë detyrimet tatimore prej disa vitesh dhe në vlera të konsiderueshme, nuk rezultoi të jetë iniciuar procedura e parashikuar nga legjislacioni penal.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", nenet 88–96; Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9; Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 35; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"*, neni 3, pikat 9 dhe 10; Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, neni 181, nenin 12, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar; neni 42 pika 1-5 të ligjit nr.67/2017, datë 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2025 në vlerën progresive **30,041,125 lekë,** ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2. Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim-Taksave të marrë masa për pasqyrimin e plotë, të saktë dhe të dokumentuar të detyrimeve debitore në kontabilitet, përmes evidentimin analitik të çdo debitori të mbartur, regjistrimin e diferencave të konstatuara për **3,950,000 lekë,** si dhe zbatimin korrekt të skemës kontabël për llogaritë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" dhe 470 "*Llogari në pritje – të ardhura për t'u marrë",* në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se dy subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tregtimit me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz dhe njësive administrative vijojnë të kenë detyrime të prapambetura për tarifën e lejes së autorizimit për stacionet e shitjes së karburanteve. Gjendja e debisë progresive në fund të vitit 2025 rezultoi në vlerën totale prej **1,300,000 lekë.**

Konkretisht:

- ***Subjekti "K. O." Sh.p.k***. ka lidhur marrëveshje për likuidimin e detyrimit me këste dhe është pajisur me autorizim njëvjeçar për stacion shitjeje karburanti, sipas shkresës nr. 3783 prot., datë 02.12.2025. Subjekti ka detyrime të akumuluara për periudhën 2022–2025 në vlerën 600,000 lekë, nga të cilat ka shlyer 120,000 lekë, ndërsa detyrimi i pashlyer në datën 31.12.2025 rezultoi **480,000 lekë**.
- ***Subjekti "L." Sh.p.k***. ka lidhur marrëveshje për likuidimin e detyrimit me këste dhe është pajisur me autorizim njëvjeçar për stacion shitjeje karburanti, sipas shkresës nr. 4416 prot., datë

21.11.2024. Subjekti ka detyrime të akumuluara në vlerën 1,400,000 lekë, nga të cilat ka shlyer 580,000 lekë, ndërsa detyrimi i mbetur i pashlyer në datën 31.12.2025 rezultoi **820,000 lekë**.
Kjo shumë prej 1,300,000 lekë nuk përfshihet në kontabilitet në llogarinë 468.
Pavarësisht lidhjes së marrëveshjeve për shlyerjen me këste, në fund të vitit 2025 subjektet vijojnë të kenë detyrime të konsiderueshme të pashlyera ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, duke ndikuar negativisht në arkëtimin e të ardhurave vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar; neni 42 pika 1-5 të Ligjit nr.67/2017, datë 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar; Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, neni 4, neni 15 *dhe* neni 20, pika 2; VKM nr. 970, datë 02.12.2015. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, nëpërmjet Drejtorisë përgjegjëse për regjistrimin, administrimin dhe arkëtimin e të ardhurave vendore, të marrë masa për **kontabilizimin**, ndjekjen e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura me subjektet *"K. O." Sh.p.k.* dhe *"L." Sh.p.k.* për shlyerjen me këste të detyrimeve të prapambetura për tarifën e lejes së autorizimit për stacionet e shitjes së karburanteve, duke siguruar arkëtimin e plotë të detyrimeve të mbetura në vlerën **1,300,000 lekë**.
Në rast të mosrespektimit të kushteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjet e lidhura, të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin me forcë të detyrimeve dhe të mos procedohet me rinovimin e autorizimit për ushtrimin e aktivitetit pa përmbushjen e detyrimeve financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi.

C. MASA DISIPLINORE
Mbështetur në Nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz**, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes.

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT